VISSAR DODANI

# MEMORIET E MIJA

KUJTIME NGA SHVILLIMET E PARA E RILINDJES TE KOMBIT SHQIPETAR NDE BUKURESHT

Shtypëshkronja «ALBANIA»
Constantza — Roumanie
— 1930 —

BKSH

BKSH

VISSAR DODANI

# MEMORIET E MIJA

*KUJTIME NGA SHVILLIMET E PARA E RILINDJES TE KOMBIT SHQIPETAR NDE BUKURESHT*

BKSH

Shtypěshkronja „ALBANIA"
CONSTANTZA
— 1930 —

BKSH

*VISAR DODANI*

Falur Shkelqésise Tij Mid'hat Abdyl Frasherit
(LUMO SKENDO)

*I shkelqyér Zoteni,*

Mé qene dh'une nj'i vogel ushtar dhé bésnik i Parushtarvét qe rembyén per-se-pari ne Stamboll, flamurin é luftes se shèntè dh'é ngritne lart per ngjalljén é létratures s'one kombjaré si dhé per shpetimin é Atdhéjes se dashur nga sgjédha dyfishé é Turqvét dh'é Grékvét,

Mé qe desheronj te mos harrohèn mundimét dhé ndihmat é burravét qe muar pjése ne kete lufte te shénte, mé aqé sa munda t'i permend dhé sa munda t'i ruanj létrat é lépushkat, doreshkrimè origjinalé te bashkeluftarevé,

Dhé mé qene sé arriva tani ne pérendim te Djéllit, apo ne ngrysjé te jétes, **ngìza kete libre**, te cilen ja u dèdikonj mé ndèr Shkelqèsis S'uaj, si bashkeluftar ne lètrature dhé vllastar i Familjés se Madhè, è zonja, piksepari, te zgjonje ndjènjat kombjarè ne kombetaret è vertète qe fituan luften è shènte dhè perjètesuan émerin è familjés te Halit Frasherit

Lamtumire !

VISSAR DODANI

BKSH

BKSH

# PARETHENJE

„Kurre-kush mé ment é véht,  
Te mos mburrét sé diç gjét.  
Pa dashur i madhi Zot,  
Fléie péma s'leshon dot.“

Sí te mos í bíndémí kesaj thenjé ?

Míjera vjété kaluan qe kurse Kombí Shqíptar rron mbí faqén é dhéut. Nga te tera kombét sa jane nde Sínísíne te Ballkanít as nje nuk eshte m'í vjéter se ky komb. Edhé ne qofte sé ka njerí mé te dréjte te levdohét sé gjíndja é tíj eshte m'é vjéter, ay eshte vétem Shqípetarí.

Kete gje é vertétojne ístorí-shkronjesít édhé gllosolloget Evropjane mé fame. Míjera vjété jane qe kur mbajme gjuhen dhé vendín t'one mé deshíre dhé mé trímerí. Kémí patur Mbréterira, Mbréterira te medha mé fame, qe kurre-kush nga shkrímtaret te huaj nuku í mohon, per véç atyrévét qe duan te na mvjédhín lavden mé trímeríte t'ona. Po koha ardhí te kuptojme sé sot nuk arríkerka vétem trímería.

Dote qé míre te muntním te rroním dhé névé tok ne víséte t'ona, ne maléte t'ona, ne ére te paqme, ne mburímé te ftohta dhé nene híjén é shélgjévé te bukura, ku kémí shkuar djaleríne te pafajshmé, ne lírí te Atdhéjes s'one sé kíshím trímeríne, po ja qe s'qenkerka é mundur vétem mé trímerí ; duhéshé dhé dítuiría, pà fjale duhéshé,

Trímate t'ane stergjysher zaptuan afro tere kontínéntín, por guvérnohéshin mé gjuhe te huaj dhé bégatuan dhé perndane qytéterimín é huaj. Névé mbétme mé trímeríne, te mbajme dhè te sherbéjme te tjéret. Po te kíshím shkruar gjuhen dhé te dinim ístoríne t'one, sé cílet jémí né, nuku dote kthénéshím kaqé léhte dhé nuk do te armíqesohéshím vella mé vellane. Qéne per te héqur gjíthe keto, sé ashtu kish dashur í Madhí Zot.

Lígjét é natures dashkan te trazohémí mé te tjere, qe te mundím te rojme, dhé duhéshé te véme ne dhê te huaj; per shume shkaké u détyruam te largohémí na vendí t'one. Shqípería mbétí pà burra; me njane í hengri *kurbeti*, me tjatre ane luftrat per te huajte. Tjatre gje s'kíshím pervéç dy zgjédha tíraníké, te grékevét dhé te turqvét, qe mbanín kombín ne érresíre duké mbjélle gríndjé mídís vellazeríse. Pra, kishím mbétur posí évgjitrít, pa díturí, pa lítérature, sé s'kísh dashur í Madhí Zot.

Tepke posí Météoret, Ullíbéte, Kométat mé bísht, qe çfaqén ne orizont ralle—hére, ashtu kémí hasur ketu–ketjé nga nonje shkrímtar sí Buden é Pétro Bogdane (pé 250 vjét vívlla kíshetare shqip shtypur ne Padove). Dora d'Istría (Eléna Gjíka), Kupítorí Idhríotí, Nastas Kullurioti ngaj Athina. Eftím Mítkua dhé me se fundi vellézerít shqiptare f'Italíse; po te gjíthe keta s'muntne te japin dukne, gjér za désh í *Madhi Zot* te zgjatín doren te dy vellézerít é asaj nené qe armiqte í kishín ndare per dobít' é tyré; édhé nísét nje jét' é ré ne Stamboll qe mbarohét ne Bukurésht é shtytur nga ndíhmat te pa-mase te guvérnes se Rumaníse. Sí dhé qysh rodhí ky shvíllím, do te shohím me pas.

*AUTORI*

***VISSAR DODANI***
***(Rivas Naiddo)***

BKSH

BKSH

# KUJTIMET E MIJA
## mbi Shvillimin e Rilindjés te Kombit Shqipetar ne Bukuresht

---

### KAPTINA I
### TE PARAT KUJTIME NGA KORÇA

#### PERSE MERGOHESHIN SHQIPETARET

Me 1878 mbarova dhé dolla nga shkollat gréqishtè te Korçes. N'ate kohe Korça nuku kish shkolla me te larta sé katre réshta Elinishtè dhé dy Gjimnazialé, sé as qe mbétéshin nxenes me tutjé ne shkollat per te bere réshta mâ te lartra, mé qene sé prindrit é tyré kishin névoje per djémte ne çéshtjé gjallnimit. Po édhé kaqé réshta sa thame ish nje théroresi per prindrit te léne femijen ne shkolla êlinishte mé nje sistéme te rende, te vjéter, te ndryshkur, ku djali humbistê 10 vjêt kohe ne mesimé, benéshé 18 vjéç, édhé kùr délté nga shkolla kish aqé dituri sa ka ketu nje djale mé katre réshta te fillorés.

Kur eshte fjala per te ngrene nje buke dyké punuar prapa pas dhjéte vjét mesimi, ahéré dhé ata véhte grékrit jane te padréjtesuar é te genjyêr mé sistémét é tyré. Po, ç'te thomi né ahéré qe s'dime greqishtén ?! Ne kombét é tjéra mé sistémét é tyré, djali a çupa qe beri 10 vjét shkolle, s'ka névoje te punoje hamallek; ay munt te jéte nje mesonjes, nje mjék, nj'avukat, nje ingjinér, spicér étj. Né rim' é humbasim kohen kot dyké mesuar régullat gramatikalé dhè

sindaksé qe te mundim, si shqiptare, te shpiêgojme ç'ka dashur te thote Thuqidhidhi a Platoni, Pausani a Stravoni étj.

Koha humbîsté per kombin shqiptar faré kote. Pa dituri, pamjèshteri, pa siguri te jétes, pa udhe, i'vobékte dhé duké héqur nga tirania é qévérise njérkê; ishim shtrenguar te kerkojme buken gjétke, te marim mergimin nde Vllahi, Misir, Stamboll, Bullgari dh'Amérike, te kerkojme pune, pune te rende, hamallek, mé gjithe qe beme dhjéte vjété shkollé gerqishté.

Kesish dhé une kisha qellim te dal ne kurbèt è te vé té ne Vllahi, ne Bukurésht, si gjithekush pas s'émtit te tij; kisha atjé t'im ungj. Po n'ate kohe, pas turbullsiravét qe la lufta Ruso-Turké, vendét t'ona ishin te pa-kujdésura, ne pakréjimé te plote; malét, fushat, ne vèri è ne juge, ishin plot mé kusare, andarte, brigande trazuar mé shqiptare é vlléh. Mbanj ment qe kish ardhur nje hajdut i vjétre qe quhéshé Béktashi dhé Néxhip Kostivishti mé 300 shpirt te armatosur mé dyfégjé dhé sopata mu nde Korçe dhé kish qendruar ne varét é turqvét, perdréjt gurit Sallatashit; déshnin ta bejne plaçke Korçen. Filli ndau te benéshé é kéqja, po te mos harinté Alo-béu Dishnica, nje béj mé fame, i cili mbanté qindra trima ne obor te tij, dhé i cili rronté vellazerisht mé paresine kristiané. Ky zoteni kish pikasur mê pare ca dit per shkéljén é Béktashit dh'é shtrengon Pashan é Korçes te kerkoje ndihme nga Valiu i Manastirit, i cili qe te nésermén, kur posa kishin rjédhur kusaret ne varét é turqvét, dhé Alo-béu po i mbanté mé fjale, kish derguar ushtare, te cilet haritne ne çast ne Çèzm' é Zonjes dhé zune te kendojne mè turumbètat. Dhé keshtu shpetoj Korça nga réziku.

Ne kete hop kohé, qe kur dolla nga shkolla dhé gjér sa ardha ketu me te hyret é vitit 1880, ne Korçe méresha mé nje trégeti me kembe: blinja fasulé dhé mblithnja lekure dhénjsh te cilat i-a dergonja, Mihal Gaqo Lakos ne Sélénik èdhé i shisté per llogari t'émé. Po kisha gjétur dhé nje libre shqip, q'ish shtypur ne Aléksandrie (Egjypte) shkruar nga Efthim Mitkua me 1878. Efthim Mitkua kish bere pak istori te *Dora d'Istrias*, *Pugare* (anékdoté) *Fjale te moçmé. Te thena, Pershendoshjé, Emera, Kenge te vjétera,*

*Kenge dasmoré, Jaranishté, Gégenishté, Trimerishté, Perralla ètj.* Kete bible Mitkua é quajti «*Mbléta Shqipetaré*" édhé é kish shkruar mê shkronja gerqishté dhé mbushur mé shkronja latinishté, ato q'i mungojne alfabétit grék.

ENDERA DJALERIJÈ

Bibl' é Mitkos, bible per te paren hére shqip, me shtiu te madhé ênde dhé deshire per te shkruar é per te kenduar libra shqip, ashtu qe njétash kisha nisur te shkruaj disa vjérsha kryéngritjè t'asaj kohé dhé t'asaj versté, kur djaleria desheron trimerin' é lìresine dhé merzit zgjédhen é tiranise.

Mbaj ment sé kisha shkruar nje vjérshe mé disa fjale nga kenga greqishté kuntra Othonit mé ate mélodhi:

*„Po gjér kur ca haldupe te huaj? po gjér kur nje*
*Sulltan, nje barbar*
*„Te na vras' é t'na prés' e t'na shuaj, dhé te gjalle*
*t'na kllase ne varr?*
*«Por gjér kur nene Tyrqit do rime? Dardha, Dardha*
*u mbush me Elina*
*«Ngrìhi shoke! therésin t'u vime, me «tugra» me fishék*
*é martina etj.*

Me 1882 ardhi Spiro Markua nga Korça dhé m'a sjéll ate vjérshe dyké me qertuar mjaft: „Ç'kè bere mor t'u mbyllte déra?! Po te na shkélté policia dhé na gjénin kesyrésh maresilleké na mvarnin"!... Kisha shkruar édhé nje vjérshe të dale nga koka é Hasanit Zyko Kambérit, i cili é kish vjérsheruar ìstorin e Abraamit mé Agare é mé Saren; Agar nga é cila duall Ismailitet. Kjo vjérshe eshte shkruar kaqë mire sa nuku benét tjétre. Nga ky vjèrshetor kam patur dhé disa te tjéra, qe m'i kish dhene Lipja i Tasi Jorgaqit (Filip Mano) t'i pershkruanj nga ato vjérsha q'i-a dha t'ét Baba Shéhu i Korçes. Kur u mbajtme nga Korca ne Bukurésht mé tere familinè, shtepia mbéti ne kujdés te t'ìm kusheriri Rafail Hr. Avramit; pra do te jéte nje fatmiresi per létraturen t'one ne u gjéçin vjérshat è ketij vjérshetori kombjar si dhé te Nézim Bératasit. Sa ndihme, sa dobi dhé sa sherbimé te medha na sjéllin dy bibla kishetaré, qe u gjénden njera é shkruar nga Pétro Buda, gége gunebardhas, tani é treqint vjét dhé tjétra nga Pétro Bogdani prift katolik gège, tani é dyqint é pésedhjéte vjet perpara.

## KAPTINA II

# TE PARAT LEVISJE NE RUMANI

### NE BUKURÈSHT

Me 4 Mars 1880, pas 17 dit udhe kaluar ardha ne Bukurèsht per pune dhé gjéta ketu shoket é djalerise te Korçes, qe kishin ardhur me pare sé mua, si Thimi Markon, qe rrinté mé trégetine ne strada Stavropoléos, Gjorgji Vangjo Géçon, qe rrinté ne strada Lipskani, Gabril Pémen qe rrinté ne Caléa Vakarésht ardhur né Kostaq Guguçi, Pandéli Evangjélé qe rrinté ne Buciuméni rotull Bukurèshtit ardhur né Konstandin Eftimiu étj. Une rinja ne strada Smèrdan ardhur ne t'im ungjer, Terpo dhé isha né imvella Pando Dodani.

Strada Smèrdan, Stavropoléos dhé Lipskani jane afer njera pas tjatres keshtu qe pîqéshim fort déndur njeri mé tjatrin, po me shume mblidhéshim né Gjorgji Géçua, s'è kish magézéne me te madhé.

N'ate kohe vlléht' é *Arnautllìkut* si i quanté Turqia, dométhene aroménet é Maqédhonise, Shqiperise dhè Thésalise kishin nisur te zgjohéshin ne ndjénja kombjaré, mé qene sé shume nga ata kishin ardhur ne Rumani te mbarojne mesimét te nisura neper shkollat é vendit, qe ishin tere gréqishté si dhé djém aroméne lindur ketu ne Rumani ; ashtu qe, pa fjale, duhéshé qe te zgjohéshin dhé te perkujdéséshin per atdhétaret é tyré te Ballkanit.

Keshtu pra, disa nga aromenet njètash te mesuar é te ndrituar, kombetare si : profésor Karajani, Apostol Margarit étj. organizuan mire çéshtjén kombjaré ; zgjédhin disa visé ku duhéshin hapur shkolla Rumanishté ne Shqiperi pas sistémit è méthudhes é shkollavé te ketushmé dhé hyne ne pune dh'u be nje buj' è madhé ne grékèt, te cilet ndiqnin nje politike mé ane te shkollavè te tyré te gréqizojne tere Ordhodokset é Oriéntit.

Po, èdhé burrat aroméne te qytéteruar ndiqnin nje politike te zgjojne ndjénjat kombjaré t'atdhétarevé te tyre, njétash te humbura. per dy ngaja : njera sé veshtronin sé gjéndja é tyré u trét ne gréqizm. dhé pastaj sé ishin shtrenguar te mprojne Thésaline, qe Europa shortoj t'ja marin Turqise dhé t'i-a japin Gréqise.

Ku esht' ajo Vallahia é madhé ? Ku jane „ta Saranda Horja" qe ishin thjésht vlléh dhé sot s'kane mbètur vétem pés' a gjashte fshatra ?

## VLLÈH DHE SHQIPETARE

Per çéshtjén é Thésalise Karajani dhé Apostol Margariti ishin mare vésh mé Sami-Frasherin dhé po benin nje propagande mjaft te-madhé vlléh é shqipetare bashke, qe te ngrihéshin kundra grékevé dhé te mos i lène ushterite grékè te hyjne ne Thésali, te cilen Europa, pa te-dréjte i-a dha Gréqise, kur ajo hengri te rahura nga shapkebardhet. Per kete shkak i ndrituari I. Karajani me 1880, Nentor, u ngrit é vajti ne Itali ne Rome dh'u trégon vétavé politiçiane dhé zhurnalistevét qéllimét persé kish vatur, dhè déshirat é popullit shqipetaro-vllah te Shqiperis dhé Thêsalise, dhé qahét per padréjtesiren qe ben Europa. Pastaj Karajani mé ane te Konsullit è Romanise beri te-njohur mé shume zyrtare te medhénj, te cilevét gjith' ashtu, u qahét dhé u lutet te mos behét kejo padréjtesi, qe te mos dérdhét gjak kote, sé lidhja midis shqipetarevét dhé romunevét njétash u be per te goditur gréket kur te hyjne ne Thésali. Karajani pastaj piqét mé Françésko Krishpin dhè i-a trègon te gjitha keto, ne te cilat Krishpi i pergjigjèt, qe ka shume simpathi per shqiptaret, sé eshte nga gjaku é nga zémra shqiptar, édhé qe fa-

milia é tij flasin ne shtepi édhé sot shqip; pastaj é truhu né i nipi Anton Krishpi, i cili i foli shqip dhe é pyéti per fare-faresh punera, ne te cilat dhé Karajani i-u pergjigj si ay dhé me mire, pune q'è gezojti shume Anton Krishpin. Dua te thom sè asi kohé dhé aroménet leftonin dore per doré nene dhè mé béjlèret shqipetare te Konstantinopojes, prandaj dhé Sami-Frasheri mbanté létre-kembimé mé Karajane dhé i perkrahèshin çéshtjés Maqèdho-romené, dyké truhur neper béjlèret è Shqiperise miqt' é tyré.

Thom ketu vétem per Sami Frasherin, sé Abdul béu gjéndeshé mbyllur ne burg ne Prizréu mé ngajén é „Ligea Prizrénit" qe é kish ngjizur ay véhte mé léjen é marevésh-jén è Sulltanit. Per kete çéshtjé s'flas as per Naim Frashe-rin sé dhé ky gjéndeshé ne Janine i mbyllur, jo ne burg, po s'kish lèje te dale jashte qytètit.

## LIGA È PRISDRÊNIT

Ketu dua te kallezonj per ata qe s'è dine ç'eshte „Lig' è Prizrènit".

Me 1879 si u mbarua lufta Ruso-Turké, Europa è tere é gjéti mé udhe te behét nje Mblédhjé ne Bérlin ku duhéshé te bisédohéshin détyra luftarakè é Turqise se mundur, dhé te tjéra denimé vendèsh, qe Turqia duhéshé t'i leshonje.

Midis tyré duhéshé leshuar nje fashe nga Malesija é Shqi-perise s'épermé mé nje sere qytété si: Pllava, Gusina, Mati, étj. qe t'i mare Maleziu. Kjo gje na sillté nje dem te math per Shqiperine po njétash ne Bérlin ish neneshkruar. Shqi-petaret keshillonjes rotull Sulltanit midis te cilvé Abdyl Fra-sheri i vellaj i Naimit, i Samiut dhé i nje tjatrit qe s'é kujtonj dot émrin, (po qe é pashe ne Bukurésht né im ungj V. Terpua) mé léjén é Sulltanit vété ne Shqiperi dhé beri „*Ligen è Prizrenit*". Mé ndihmen e Etenvét Béktashinj (Shéhlére) dyké truhur fshat me fshat dhé qytét me qytét ne Toskeri dhè ne Gégeri, ariu te mblèdhe tere Shqipetaret mè nje lèhtesire ne kete „Lige" dhè u muar vèsh, qe shqi-petaret nuk japin malesine nè Maleziu dhè perseri do te dèrdhèt gjak; po ne vend te atyrè japin Ulqine dhé Tivare.

## ABDYL HALIT FRASHERI

Abdyl Frasheri ish i bir' i Halit-bèut, lindur nde Frasher me 1839 Gusht 17. Shpirt ndrituri, qe ne te rit' è ti ish falur nde çeshtjèn è madhè te perlindjès se Shqiperise.

Ne kohen kur grèkrit dèshnin te shtonin kufin' è tyrè nga kurizi i Shqiperise, Abdyl Frasheri qè i pari qe u perpoq dhé mundi te shpetonje Janinen. Edhé kur kongrési i Berlinit shartoj t'i jépét Maleziut Pllava, Mati, Gusina étj. Abdyl Frasheri eshte ay qe bariti dére me dére ne tere Shqiperine édhé lidhi te fameshmén «Ligen é Prizrénit» rotull se ciles u mbloth gjithe trimeria shqipetaré dhé mundi te mos jape vendét qe Turqia mé aqe léhtesire neneshkroj t'i ndanje ne kongrés te Bérlinit me 1878, pas urdherit é se padréjtes Europe, dhé ju dha Maleziut Tivari dhé Ulqini jashte Shqiperise. Dhé kur qévéria njérke é prishi «Ligen» mé pabési shpirtndrituri Abdyl i Shqiperise s'kish préhe ne shpirtin é ti pa shpetuar Shqiperine nga zgjédh' é Halldupevét, dhé desheronté nje lidhjé mé Moréne nje Elino-Albanié, per te cilen dergon Nasif-béjne ne Gréqi te kupetohén mé kondita te lèhta per Grèqine; po Grèket mè qellimè te keqia per Shqiperine, ja zbythne proponimin dhè ja kallezuan Portes Larter deshiren è Abdyl bèut, te cilin è burgosin ne ushtariane te Prizrènit, dhè Nasif-bèjne è derguan nde Rodho per disa vjèt, Abdyl Frasherin è derguan ne dbonje nde Fèzan syrgjyn ku ndenj 7 vjèt dhè mè qe ish semure nga èthèt è suall ne Stamboll ku ka vdèkur nga rendesirat q'i solli syrgjyni. Abdyl-bèu vdiq, po deshir' è ti qendroj persiper dhè ngjalli zèmerat è gjithe shqipetarevèt te paqme. *Kujtimi i émerit te ti mbétét i pa haruar per jéte.*

BKSH



POLO MEKSI

Polo Méksi i nipi i Nastas Zapas (Xhapes) vellaj i Kapitan-Vangjèlit Zapes banues nde Stamboll me 1881 udhetonté déndur Stamboll-Bukurèsht te mblèdhe lajmé ne çeshtjèn é gjese dhè plengut te Kapidan Vangjélit zaptuar nga i kusheriri i pare i tij Konstantin Zapa, gjoja mè ane te nje dhiaté é cila ra poshte mé ane te gjyqit qe mbajti tridhjét vjét ne Bukurésht nisur se pari nga Polo Mèksi bir' i bijes Nastas Zapes.

Mè kete ngaje te udhetimèvét Polo Méksi silltè qe nga Stambolli koréspondénca nde Bukurésht nè z. Bélimaci, i cili mbanté réstaurant ne magazin te Gjorgjit Vangjo-Géços ne strada Lipscan dhè i cili mbanté lètrekembim mé Apostol Margaritin ne K-poje dhè mé profésor Karajanin nde Iaşi, te cilet bashke mè Naim dhé Sami béjne losnin nje politike te Aromunevèt te Maqédhonise per te shpetuar Thèsaline nga dor è grékevét qe Europa ja dha Gréqise.

Mè kete ngaje une, Gjorgji dhé Thimi Markua fjalosèmi mè Polo Méksin te na truhe mè béjléret, te cilet njétash kishin nisur te punojne létratúren kombjarè.

Polo Mèksi, djale i mesuar, ne llogjike ish i pari qe na nxori friken dhè medyjen qe kishim né kristianet nga Turqit (Musulmanet) dhé u siguruam qe ata jane vertèt shqipetare dhè punojne mé ate deshire si dhé névé dhé mé te drèjte esht njériu qe duhèt te mbahét mend si shkaketar i lirise kombit shqipetar. Qofte émeri i tij i paharuar.

BKSH

Kesish Europa, qe te mos dèrdhèt gjak persenjezaj i pajtoj punet èdhè mbéti siç è dime. Abdyl Frasheri, kur veshtroj sè sa lèhte mundi te binde Shqipetaret t'a ndjèkin è t'a degjojne, u mèndua sè eshte koha t'a shpetonje Shqiperine nga zgjèdha è Turqise—è cila ashtu si gjèndèshè s'isht' è zonja te hèdhe as nje plumb—e dergon nje nga bijt' é tij ne Grèqi te benje nje proponim per krijimin è nje Elino-Albaniè, mè kondita qe Grèqia te jape 40 mije ushtare ndihmes, po avant-gardat te jène shqiptare.

Se pari u prit proponimi mè shume gezim, po diten ê dyte, nje mjèk Dragumis mori fjalen kaqè kundra sa te gjithe u zbythen. Ay tha «*Gréqia ka nje milium é gjysme dhé Shqiperia tri miliuna, pastaj atjé jane turq é katolike, vétem nje te gjashten jane bésedréjte (Orthodokse). Shpetimi yne eshte Shqiperia te behét copra; te mare Serbia, Bullgaria dhé névé ëperen!*" Pastaj i-a dergojne Sulltanit kete fshèhje qe mèndonin ata te Liges se Prizrènit, dhè kesish Abdyl Frashèri u mbyll se pari ne ushteriane te Prizrènit, pastaj ne burg dhè mê pastaj u shpu nde Fèran, ku ndènji 7-8 vjèt dhè qe ku dolli plot èthè, nga te cilat i-u shkaketua dhè vdè[illegible]ja.

Dukè levduar Karajanin dhè Apostol Margaritin, dukè trazuar te ngjarat è „Liges se Prizrènit" dua te deftonj te ngjarat è asaj kohè, qe kane nje lidhjè mè qellimin qe ndjèk une per te shkruar *Kujtimet e mia*.

## POLO MEKSI DHE NEVE

Thashe me siper sè une, Thimi Markua, dhè Gjorgji Gèçua mblidhèshim dèndur ne straden Lipskani, dhè atjè mé 1881 vjèn nje shqipetar nga Stambolli mè nje lètre te Apostol Margaritit dhè i-a jèp Konstantin Bèlimaçit, i cili mbantè réstaurantin è G. Gèços.

Ky zoteni quhèshè *Polo Meksì* i cili menuar msuam sè kish vellèzer nje Janaq Méksi dhè nje Hristo Méksi.

Polo Mèksi kish ardhur ketu nga Stambolli qe te atakonje dhiaten è Kapitan Vangjèl Zappès, si nip nga è mbèsa, domèthene nga çupa è Anastas Zappès. i cili ish vella mè Kapitan Vangjèle dhè keshtu u nis ay i fameshmi gjyq,

i cili mbajti tridhjète vjèt. Do te ishnja i zoti te deftènj tere kete istori si ka rjèdhur ky gjyq, po tjatre eshte qellimi per te çilin benj kete permendjè, po kujtonj dhè fare faresh ngjarjèt qe kane lidhjè mè çèshtjèn.

Polo Mèksi kish nèvoje, per shkakèt qe thame, te mblèdhe lajmè, dhè vèt è vjèn disa hère ne Stamboll è Bukurèsht. Dhè mè qe godíti hèren è pare te hasèmi ne Bèlimaçi dhè te fjalosèmi gjer' è gjate per punera kombjarè, dhè ca me shume tani kur mesojme qe dhè aromenet (vllèhte) nje grusht njères, perkujdèsèn te bejne lètraturen è gjuhes se tyrè hyme ne sèndre dhè zgjatme miqesi mè kete zoteni, mè te cilin piqèshim nè Gjorgî Gèçua ne Bèlimaci.

Ketu ne Bukurèsht mè kete zoteni djale te zquar dhè qenduar shume, zume te çfaqèmi dhè te qajme fatin t'ene te ngrate, qe kèmi mbètur posi èvgjitrit, kur ketu ne kete shtét u gatuan Bullgaret dhè na duall perpara, tani dhè nje grusht vllèh po perpiqèn, nè shqipetaret persè te mos levizim? Ndodhèmi ne nje vend liridashes ne Rumani, qe ku muar shpirt bullgaret per te paren hère dhè u bene njères!

Tere keto bisedimè qe benim nèvè te trè perpara Polo Mèksit kallezohèn tè Sami Frasheri, i cili gezohèt dhè i kerkon adrèsat t'ona. Po mè qe nèvè kishim deftyère nè Polua dyshime, per musullmanet shqipetare, Sami Frasheri na dergon mè kete zoteni fare faresh lètra e vjèrsha te shkruara nga i vellaj Najim Frasheri te cilat na vertètojne sè ata s'jane turq po musullmane shqîpetare, atdhètarë te flakte dhé mè dituri te larter. Na trègon dhè adrèsen ku t'i dergojme lètra: *Monsieur Jules Marìe Poste Restante*, Postè Autrichièn.

Nje nga vjèrshat è Najimit qe na ngriti ç'do dyshim é frikë eshte kejo:

## SHQIPERIA

Bota qe kur eshte zene
Shqiperia gjall ka qene
Pèllazg' u thèshín me pare
me se fundi Shqipetare



NAIM FRASHERI

Naim Frasheri ish i bir' i Halit-béut, lindur ne Frasher me 1846 Mai 13. Naim Frasheri eshte ata i litèratures kombjarè. Ay é mbushi Shqiperine mè vivlia shqipè. Mé vjèrshat é tija istorikè dhè fjésht kombetaré bindi gjithe shqipetaret, qe ay ish i zgjédhuri bir i Shqiperise te therése è te mblèdhe gjithe Shqiperine ne fé te shqipetarismes.

Tere shqipetaret é Bukurèshtit ate njohne parushtar' é tyré, dhe nene fjamur é dishepujvét Naimit dhè Sami Frasherit s'u ndane gjér sa fituan luften shèntoré. Sot Shqiperia ka litératuren é saj.

Ate qe i vellaj i tyrè Abdyli beri mé trimeri, Najimi dhè Samiu bene mè pende.

Familia Halit Frasheri mbètèt shkaketarè è rilindjès te kombit shqipetar.

BKSH

Gjuh' qe kishin Pèllazgjite
Ate flisnin Pèrendite
Ate kane Shqipetaret
siç è kishin dhè te paret.
Gréqishtèn ajo è polli
Llatinishtja q'atjè dolli
Bijte t'ane jan' Elinet
Si-nde-kur èdhè Llatinet;
Edhè gjithe Evropjanet
qe kan' dale nga Romanet
Nèvè jèmi me te pare
ne Europe nga ç'do fare;
Gjithe bota vin qe moti
ne Tomor ku ishtè Zoti
Qe t'i falèn Pèrendise
Zotit math te Shqiperise.
Zeri flaka s'ishtè kot
q'i nxjèr Tomori dhè sot.
Ahèrè kish s'di sè cine
Tani ka Abas Aline.
Shqipetari trim mè flète
ka rojtur ne kete jète
Kèmi pasur mbrèterira
Edhè fort shume te mira;
Kèmi bere shume pune
po gjithe vane per lume;
Alèksandr' ish shqipetar
q'u tha i math kordhetar
Sèlèfket dhè Ptolèmènjte
èdhè gjithe te medhènjte
s'qène Grèke as Bullgare
ata ishin shqipetare.
Pirrua qe nga Shqiperia
qe po è levdon istoria
Skenderbègu Kastrioti
q'u deftyè aq' i zoti
Ishtè burr' i Shqiperise
q'i dha dermene Turqise.

Ç'burra ndron Shqipería
qe í shkruan Istoría
Bajraktar è Qyperlíne
Shkodran é Mèhmèt Alíne
Dzavèlla è Marko Sule
Bubulín' è Míjahule
q'í dhane dermen Turqíse
dh'í vune ndèr trímeríse
Sí keta é sí te tjère,
qe qène shume te ndjère,
po nga gjíthe trímería
nuk fítoj gje Shqípería!
Per kedo qe nè luftuam,
è mbajtme è í líruam,
te gjítha na u haruan,
dhè sot te lígen na è duan.
Me kaqè burra te vyer
Qysh u ndothme te genjyèr ?!
E ç'è dèsha trímeríne
Kur s'm'u ndoth per Shqiperíne ?
Mè ndèr tene roj Turqía,
Po aq vuan Shqípería;
Ka vuar èdhè po vuan
Turqít nèvè a na duan?
Nèvè è beme Grèqíne
E po Grèkrít na è díne?
S'duan farè te na shohín
Shqíperíne sot s'é njohín.
Shqíperia ron sí ropí
Mèndohèt per te Europí?
Mos dúrofsh í Madhí Zot
Te jète ne zgjèdhe sot!
Burr í math qe kè luftuar
èdhè boten kè líruar!
Ç'te na benje trímería,
sa mè qene gjall padíja?
Shqíperí! pse s'ísh' è zonja
te benjè trí kater shkronja?

BKSH

sè tí punet i mbarovè
po te tjèret i ndèrovê.
Síkur tè paskerkè shkruar
gjeséndi s'te ísh haruar.
Do te kíshime Pllatone.
Arístotèl' è Strabone,
Píndar' Omír dhè Esqílle,
Dant è Sènèk è Vírxhile
dote ísh sot Shqíperia
qe t'è mèr boten zília.
Po te shkuarat i lère,
dhè mso ment per tjater hère.
O vellèzer shqípetare!
Lérèní kohen è pare.
Eja-ní taní te msojme,
pas ketaj t'a trashegojme.
sè ne ndènjçím te pa-msuar
keshtu kèmi per te vuar.
Eshte turp per faren t'ene,
te mos nxjèrím farè zene,
po te ronje è pa ndjère
e shkrèt' è varfer è mjère!
Psè te mbètèt Shqíperia
t'è mbulonje babezía
duk m'è patur búrra tríma
t'umbase sí vètetíma?...
Ah! mos, Zotí mos è dhente!
Jakení te mblèdhím mente

## „DRITA" E STAMBOLLIT DHE DÈGA È SAJ NE BUKURÈSHT

Mé te mare né kete vjérshe mé kaqé hollesire histo-riké dhé mé kaqé zjar atdhétarié, na dolli frika dhé muarm kurajo te mbajme létrekembim mé te cilín vertètohémi qe dhé ata ne Stamboll kane filluar nje shoqeri préj nja téte vétash, po mé shume te drojtur nga ana é Guvérnes sé brènda ne keta kristíane ishté dhé Nahimí dhé Sami Frasherí, i vellaj, qe ishin dhé nepunes te Guvérnes Ottomané. Samí

Frasheri njétash kish shtypur dy a tri numura pé nje pé·riodiké mé émerin „DRITA" nene diréksi te nje kristiani Pandéli Sotiriu

Tani qe hapme koréspondènce mé Nahimin mesuam qe ay ka gati ne doreshkronjé Abétaré, Kendonjetoré dhé „Lulét é Véres" (vjérsha) édhé mundét te shtypén kurdohère, po mungojne te holla ; pastaj atjé ne Stamboll as qe mund te punohét as qe mund te nisét nje pun' é tille, é cila po q'u nis duhét mbaruar.

Tani mundohémi te bejme ketu nje shoqeri. Gjorgji Géçua kish t'atne Vangjo Géçon trégeţar te vjéter ne Bukurésht, i cili kish nxjere disa djéma korçare sherbetore, trégetare mé véhté, qe i thoshnin te gjithe *Usta Vangjeli* ; une kisha kater t'im' ungjer, vellazerine Tarpo, te cilet te ardhur ne Bukurèsht qe me 1863, pas Vangjo Géços, gjithashtu dh'ata kishin nxjere mé vêhté mjaft trégetare dhé puna i-u vinté mire, pastaj kishin gjérinj dhé miq shume, gjithashtu dhé Thimi Markua mé miq shume dhé ndér, sé ishté dhé m'i mesuar sé névé ; po per t'im ungjer, te kater vellèzerit analfabéţe, une qéshe mjaft i degjuar dhé méndor ; kishim pastaj dhé Nastas Lakçén (Avramidhé) plakne milionar, i cili na dész shume dhé ish i pandare nga né te tré ; i-a u kallzojme qellimin ê shénteruar qe vazhdojme, i-u deftéjme dhe ç'kishim punuar me Sami Frasherin ne Stamboll mirefilli sa u dolli dhè atyré frika.

Keshtu therésim shqipetaret ne nje mblédhjé ne shtepi te Vasil Terpos, ne ţe cilen shţime thémélin é nje shoqerié te vogël per ţe shtypur libra ne gjuhen shqipé dhé i-a vume émerin «Dég' é shoqerise se Stambollit per vivlla shqipè" dhé mblothme n'ate shoqeri 1700 franga.

## JOVAN VRÉTUA NE MÉS T'ONE

Pasandaj shkruam ne Stamboll te na dergojne njérine qe na kishin prémtuar nga komitéti i tyré dhé na vjèn Jovan Vrétua Posténani mé nje Pandéli Sotiriu, nje çalaman, por, si njeri dhé tjatri, njères te urte.

Keta zoterinj i shpume dyke i ndjékur pas gjithe cile mé nga nje prèj nésh neper sémtin é tij qe benim propagande



SAMI HALIT FRASHERI

Eshte vella mé Abdyle é mé Najimin, lindur ne Frasher me 1 Qèrshor 1850. Ne kohen kur Bukuréshti nisi te kupetohèt mé vellèzerit Halit bé Frasheri, Samiu ish i pari qe mbajti lètre-kembim mè kombetaret nisjatore te Bukuréshtit. Samiu ka bere abèçédarèn è pare shqipé sé vellèzerit é ti Naimn' é kish mbyllur ne Janine dhé Abdyle ne Prizrèn. Samiu dinté dhé gjuhera te Europes dhé ka bere pjésen «Bèsa» qe refèn zakonét è lartra te shqipetarit.

Qoft' émer i tyré i kujtuar per jète.

BKSH

EFTIM V. MARKO

GJORGJI GJEÇUA VISSAR DODANI

NISJATORET

BKSH

BKSH

dhé ku keta defténin sé ne Stamboll behét nje shoperi shqipetaré per kete qellim dhé me te shumet jane muhamédane, Pashallare é Béjlére dhé q'atjé nuk mund te behét pun' é madhé si na duhét, sé s'lé Turqia te vellazerohén shqipetaret midis tyré dhé te tjéra fjale te propagandes.

Deshir' è shènte po perhapèt, disa grèkomane qe shtinin frike sè musullmanet è Stambollit jane spiune, te vene nga policia è Portes, mbyllc gojen, ca te bindur se vertètes, disa nga frika se mos i mare Rumania per grèke a fillogrèke, mè te cilet Guvèrna rumune nuk qè kaqè mire, dhè propaganda vintè perpara mjaft

Ne kete kohe disa trégetare te medhénj kishin vajtur né Konstandin Eftimiu qe mbanté kofetarié ne strada Karol perdreq trègut te lulévé, po ngaj i cili blinin spirto mé angro dh'i lutén te hynje dh' ay ne shoqerine shqipetarè pune qe é pranoj sa-kaq, sè qè dh' ay nga Drénova è Korçes, dhè ndofta dhè sè s'mundté te réfuzonje klièntet shqipetare.

## KRIJIMI I SHOQERISE „DRITA" NE BUKURÈSHT

Konstandin Eftimiu qè njèri i degjuar si trègetar i-math dhé si i njojtur ne njérzit é fuqise zyrtare, dh'i degjohéshé fjala kudo; kish dhé nje nip te msuar dhé avokat mé fame i cili quhéshè Spiro G. Eftimiu, i cili dhé ky pranoj te hynje ne shoqeri.

Keshtu qe shoqeria po forcohèt dita mé diten dhè po shtohét aqé me shume kur shikonin shqipetaret sé hyjne ketu njéres me rendesire.

Mbahèt pastaj nje mblèdhjè è shoqerise se vogel dhé pagezohét tani mé èmerin «Drita» 1884, dyke u-bere statuté te rèa nga Spiraq Eftimiu bashke mè né èdhé u zgjoth kryétar *Anàstas Avramidhi*, nenekryétar *Konstandin Eftimiu*, sekrétar *Gjorgjì Géçua*, arkëtar *Vasil Térpua*, Keshillonjes *Spiraq Eftimiu*, *Thanas Haritua*, *V. Dodani*, *André Jon*, *Eftim Markua*, *Vangjéli Ançé*, *Llazar Antoniu Karpaçi* dhé *Vasil Kanasi*.

Me kete rast u hap nje liste per te mblédhur fondin te pare dhé gjithe anetaret neneshkruan ne kete liste siç trègohét me poshte.

Emerat èdhè te hollat qe mblodhem ne shoqerí me 1884 qe morí èmerín „DRITA“ ketu ne Bukurèsht.

| | LEI |
|---|---|
| Anastas Ävramídhi | 2.000 |
| Vellazería Hr. Terpo | 300 |
| Vangjèl Gèço | 200 |
| Vellazería Vasíl Marko | 100 |
| Thoma Skundra | 50 |
| Vasil Hr. Kosma Barmashi | 100 |
| Pèríklí Vellko | 50 |
| Andrè Mborja | 50 |
| Vahit Abdulla | 20 |
| Anastas Raci | 150 |
| Vellazería Antoníu | 50 |
| Kostaqí Anastasíu Guguçi | 40 |
| Dhímitrí Níkullau Dadâ | 30 |
| Vasíl Kanasí | 30 |
| Vangjèlí dhè Spíro Ançè | 40 |
| Mihal Zurua | 5 |
| Vísar Tarapaqí | 10 |
| Spíro Gorguzí | 20 |
| Thèmístoklí Gjèçu | 100 |
| Gabríll V. Pèmma | 100 |
| Toma D. Kalo | 10 |
| Ilíè Nanto | 5 |
| Dhímitrí Dardha | 50 |
| Thèmèl Papagjorgjí | 10 |
| Anastas Hr. Pèrdo | 20 |
| Spíro Vellko | 20 |
| Gjorgjí A. Ançè | 20 |
| Jovan Papakrísto | 20 |
| Gjorgjí Vrèto | 20 |
| Grígor S. Dodaní | 10 |
| Koví Mería | 5 |
| Harallamb Hrísto Tarpaqí | 20 |
| Konstantín Vrèto | 20 |
| Thèodhor Eftímíu | 50 |
| Per te sjélle | 3725 |



ANASTAS AVRAMIDHI LAKÇJA (Korçar)

Mireberesi i Korçes Lakçè ishté i pari plak qe ínkurazhoj idèall' é **nisjatorevét** se çeshtjès shénjte. Mé bégatin é 'ti, ne te paren mblèdhjè te atdhètarevè per te ngjizur nje shoqeri lètraré kombjaré, Lakçéja ka ngritur shprèsat dhè kurajon è *nisjatorevét* dhè *popullit* ftuhar ne te paren mblèdhjé per fillimin è shoqerise lètraré dhé shpetimtarè, kesaj qe veshtrojme sot. Ay dergoj *Thimi Markon* nde Korçe mè prémtimé te gjèra qe te perhapnje idéjat é litératures kombjaré shqipè, dhè ne formimin é shoqerise se pare «*Dég' é Stambollit nde Bukurésht étj. 1881*» ish i pari kryés i shoqerise shqipetaré dhé qe dha haroma me shume. I pa ndare qendroj kryès i shoqerise «Drita» me 1884 dhé «Dituria» me 1886. kur i ligu hoqi te vrase nenkryésin' é shoqerise «Dituria» *Konstantin Efthimine* qe ish ngjitur.

Kur kembéu jèten déshir' é ti ish te mbulohét ne at dhèjen é ti, si kémi shkrojtur ne keto «Mèmorja».

Qofte i kujtuar èmer' i ti!

BKSH

BKSH



JEAN VRETO

Ky plak ishtè nje préj shoket é vjétre te vellazerise Najim dhé Sami Frasherit, kur u fillua nje shoqeri é vogle ne K-poje per te shkruar litératuren shqipé.

Pas te thenet é tij, ky ka kréjtur abécène shqip trazuar mé greqishté sllavishté dhé latinishté dhé t'atillen mé arsyé qe te pajtonje orthodhoksine.

Keshtu hyri ne létre kembimè mé disa shqipetare nga Korça qe rronin ne Egjipte édhé méréshin dyké shkruar gjuhen shqip mè létra grèqishté dhé mbushur mungèsat è abècése grékè mé shkronja latinishté. Kesish fare shkroj Eftim Mitkua, Vasil Bardhua, Kupitori, Kristoforidhi (bibla kishetaré) si dhè shume shkronjetoré nga shqipetaret vellèzer t'Italise si Darajt Krispèt, Dé-Radaj Kamardaj nga te cilet muar zjar ata te Egjyptes è te K-pojes.

J. Vrétua é shkruanté shqipén mire, po rokjét é fundit te vérbavét, me ç'do rast désh t'i shtonté mé zetorken é shurdher. J. Vrètua kurre nuku shkruantè : behèt, duhét, shkruhét pa thene : *behéte, duhéte, shkruhéte* mè qene qe dhè gréket gjignétae, dhèhètée, grafetae thone.

J. Vrétua grékomanismen é kish te renjosur ne zémere, siç dhè i thote Sami béu Frasheri ne nje letre qe i héq verréjtjén mè fjale te çkrépeta per korékturat te biblla vè qe i shtypnim névè ne Bukurésht ketu ku kish ardhur Vrétua te bentè korékturat é bibllavé shkollaré doreshkronja te béjvét Sami dhé Naim Frasheri.

Autoret è bibllavét shkruanin : *Babillonia Trasibuli, Kartadzena, Sicilia* étj. Vrétua ja u ndréqi ; Vavillonia, Thrasivuli, Karqidhonia, Siqelia étj. pune qe i zemeroj shume autoret è bibllavét dhé ja hoqne kete barre grékomanit dhé ja ngarkuan Eftim Mitkos èdhé mua. (Létra dukét ne faqén 34 te Biblles).

Qe ishté i atilli Vrétua kam ne dore nje biblle doreshhronje lene nga Vrétua mikut t'im Pandéli Evangjélit, kur iku ne Athine te vdése atjé ku vdiq, mé porosi qe te shtypét pas vdékjès se tij.

Ne kete libre mé 63 faqé kerkon te defténje si nje fjale qe z. Vrétua paskerka mbajtur me nje mblédhjé te shoqerise «Dituria» ne Bukurésht me 1896 Kallandor 14. Kejo fjale nuku eshte thene kurre ndonjére.

Kejo libre ju dha Pandéli Evangjélit mshéhur kur do te ikte si thashe. Pandéliu kur é kendoj nuku mundi te duronje kete hidherim shpirti kur shikon ç'fare njéri kémi yshqyér ne més t'one. M'a jép t'é kendonj po mé kondite te ri é t'a kendonj ne magazé te tij ; E kendova mire faré· dhé s'duronja dot. Me von kur veshtronj sé Vrétua levdon miresine qe kane punuar gréket per névé, dhé ariu gjér atjé sa te thote qe «gjuha shqipé do na prishnje bésen». Une kam bere nje mekat, nje paudhesi mikut t'im Pandéliut. Ja rrembéva kete doreshkronje te qélbur édhè é kam édhé sot qe t'a lé nde arhive te shtétit.

BKSH

| | |
|---|---|
| Te sjella | 3725 |
| Vasil Duro | 25 |
| T. Harito N. Evangjèli | 20 |
| Tanasè K. Konè | 10 |
| Haralamb Çapèrî | 10 |
| Thèohar Hrístu Karpaçí | 20 |
| Spíro Pandèlí Ilo | 20 |
| Dímo Dímiani Díbrani | 10 |
| Sotír D. Mano | 200 |
| Vellazeria Kolèci | 60 |
| Gjorgji Llazar | 20 |
| Hrísto C. Jakobi | 50 |
| Naum Tasi Meria | 10 |
| Vellazeria Topallí | 20 |
| Naum Anastas Kamènica | 20 |
| Grígor Palío | 10 |
| Vasîl Antoníadi | 10 |
| | 4.240 |

Joan Vrétua tani ja u shkruan ne Konstandinopoje shokevèt sa mire u prit ne Bukurésht nga atdhètaret èdhè rendesiren è madhé qe ka familja Géçio dhé Tarpo si dhé Konstandín Eftimiu dhè plaku milionar Anastas Avramidhi ètj, dhè qe ketu eshte shprès' è-madhe per t'u ndréqur short' é kombit t'one fatkéq, sè perjashta zjarit te djèlmurise, ç shtja ka ndihmen dhé miredashjèn è Guvèrnes Romené, pune qe ndihu shume te hyjne ne shoqeri trégetaret shqipetare te medhénj é te végjel pa frike, sa me nje mblédhjé te pare q'u mbajt ne shtepi te Vasil Terpos dh'u fillua shoqeri' é pare è u shkruan 4240 franga (lei) ato qe thame me siper.

## I. VRETUA SHKON NE MISIR

Shoqeria pastaj i dha 20 napoléona I. Vrètos qe vajti ne Misir qe te fillohèt dhé atje nje shoqeri per lètrature kombjaré dhé u mblodhe pak veta, po mé liste ne dore, dère me dére, u shkruan shume véta mé sumat qe dote shenojme me poshte, po te cilat nuku di ne u mblodhe te tera, sé shqiptaret è Misirit druhèshin èdhé nga musullmanet è

BKSH

atjéshmé édhé nga konsullozet greke, nene te cílet me te shumet ishin shkrojtur qe te gjénin perkrahjé é mprojtjé

Drasa è ndíhmetarevè te shoqerise shqíptare nde Egjypte.

| | Fr. |
|---|---|
| Dhímitri Çika — Korçar | 50 |
| Marígo Dh. Çika — Vlashova | 100 |
| Grísto Nuni „ | 100 |
| Themístoklí Nuni „ | 100 |
| Spíro H. Dinè — Korçar (Víthkuq) | 100 |
| Konstantín Ekonomí — Monastíras | 60 |
| Efthím Th. Kèj — Krushovas | 30 |
| Kosta Parthènèa — Korçar | 40 |
| Vasil A. Nuni — Vlashovas | 80 |
| Níkoll G. Hèqimí (Jatru) — Korçar | 40 |
| N. Vasíl Gjíka — Krushovas | 20 |
| Níkoll Caci — Karísovas | 25 |
| Thoma Gj. Hèqimí (Jatru) — Korçar | 40 |
| Harallamp Th. Koka — Korçar | 10 |
| Konstantín N. Prífti — Korçar | 25 |
| Dhíamandí N. Pèci - Monastíras | 10 |
| Dh. N. Çíka — Korçar | 50 |
| Dh. K. Guèro — Krushovas | 100 |
| N. Joan Svollí — Krushovas | 100 |
| Pètro Nuni — Vlashovas | 50 |
| Marko M. Marko — Korçar | 200 |
| Níkoll Naçi — Korçar | 200 |
| Anastas Kotadhí | 60 |
| Llazar Aspo — Korçar | 10 |
| Spíro Iftí — Korçar | 5 |
| Anastas Papakrísto — Mborjar | 25 |
| Vell. Gjorgulla Antoníadí — Korçar | 20 |
| Th. Gjorgulla Antoníadí — Korçar | 15 |
| Joan D. Turtullí — Korçar | 20 |
| Kostí Joanídhí — Bèratas | 5 |
| Antoni Daio — Korçar | 30 |
| Pandèl Çausholli — Korçar | 25 |
| Emín Aga Tahír — Díshnícas | 25 |
| Asllan Aga Kolonja — Sèlènícas | 25 |
| Shèríf Efèndi Kolonja — Taci | 25 |
| | 1820 |

| | |
|---|---|
| Te sjélla | 1820 |
| Harallambí Vitta—Sèpèrjot | 100 |
| Naum Anastas—Hocishtar | 50 |
| Dhimitri Joan dhè Koci Cícko | 50 |
| Eftîmí Mitkua—Korçar | 50 |
| Pètrè Konstantín Korçar | 60 |
| Pètrè Dhímitrí—Elèfshjot | 40 |
| Mihal Dhimitri - Korçar | 40 |
| Ntkollaq D. Tollku--Korçar | 10 |
| Hafes Efèndí Ahmèt—Fèlah | 10 |
| Harito Çakos—Sèpèrjot | 200 |
| Konstantín Pètro—Korçar | 50 |
| Níkol Hadzí-Stèfaní - Korçar | 50 |
| Gjorgji N. Koza—Korçar | 30 |
| Dhímitrí Haxhístèfaní Korçar | 30 |
| Thèodhos Gjorgjí—Oparí | 10 |
| Konstandín Plluska—Korçar | 50 |
| Spíro Stavrè Avllona—Korçar | 25 |
| Naum dhè Spíro Parthèní--Korçar | 20 |
| Pantèlí Plluska—Korçar | 25 |
| Jovan Mitkua—Korçar | 10 |
| Murat Sadík—Borshar | 200 |
| Harallamp Stavrídí - Líbovas | 50 |
| Níkolla Anastas Hoçishtar | 50 |
| Níkoll K. Taskos—Ogdhun | 100 |
| Grígorè Nukua - Korçar | 60 |
| Naum Avramushí—Korçar | 20 |
| Spíro I. Kotta- Korçar | 20 |
| Abídín-bèj Pírgu—Gorar | 60 |
| Mohamèt Hamdí-bèj—Pojaní | 120 |
| Ahmèt Ashat-bèj—Pojaní | 120 |
| Ksènofon N. Çílja—Krushovas | 20 |
| Namían-Aga—Qafezèzí | 100 |
| Ismaíl-Aga—Pízrèní | 40 |
| Apostol Papadhopol—Bènèot | 25 |
| Osman Eféndí - Monastíras | 25 |
| Mustafa Kapèdan—Ylçínas | 125 |
| Sotír Koka—Korçar | 400 |
| Per te sjélle | 4365 |

| | |
|---|---|
| Te sjélla | 4365 |
| Athanas Dakua—Korçar | 25 |
| Spíro Buzí—Korçar | 25 |
| Sotír Skendèrí—Korçar | 20 |
| Efthím Níkolla—Mèqadhèlfías | 25 |
| Hrísto Dakua—Korçar | 10 |
| Níkolla Hasopullos—Písodèras | 40 |
| Paskal Kryçí—Shkodran | 20 |
| Níkolla Babí—Shkodran | 20 |
| Ahmèt Aga—Shkodran | 5 |
| Tahír Arnautí—Shkodran | 10 |
| Gaspar Velltoko—Shkodran | 5 |
| Dhímítrí Kokí—Korçar | 20 |
| Naum Konstantín—Korçar | 5 |
| Hrísto Hasopullos—Písodèras | 10 |
| Andrèa Kura—Korçar | 10 |
| Vançí Bako—Korçar | 5 |
| Pètro Níkolla—Korçar | 5 |
| Skaíp Xh. Voskopí—Korçar | 50 |
| Konstantín Gjèrgj—Floqar | 25 |
| Vasíl Sotír—Paramíthas | 10 |
| Husèn Floqí | 25 |
| G. Dh. Kotroní—Nídhras | 20 |
| Théodhor Vasíl—Korçar | 5 |
| I. S. Çamí—Brègdètas | 75 |
| Ahídín Bèj—Kamèníca | 150 |
| Sèlím Efèndí—Bílíshtar | 10 |
| Alí Islam—Bílíshtar | 5 |
| | 4.900 |

Ne Egjypte nuk di nè u mblodhe keto sumera q'u shkruan, sè qène trazimè mè Arabi-Pashen. Nèvè ketu ne Bukurèsht nuk muarme asnje ndíhme si qè fjala, po punoním perpara mè zjar è flake.

## KONSTANTIN EFTIMIU DRÉNOVA KORÇA

Konstanttn Eftimiu eshte burri qe bégatoj shoqerine létraré kombiaré qe ne nisjé te saj. Mik i pa ndare mé Avramidhe Lakçén mé Vasil Terpon dhé Vangjo Gjéçon, nuku vétem pranoj te hynje midis nésh, po na solli dhé te nipne Spiraq Gjorgj Eftimiu nje i çkelqyér avokat ministériabil qe na dhiorganizoj shoqerine dhé statutét é saj. Konstantin Eftimiu ishté njériu i degjuar dh'i njohur ne paresine dhé nde politiçianet é Bukuréshtit, ish promotori i gjithe shqipetarevét Drénovare, qe mbétne bésnike ne idéalle é rilindjés se kombit shqipetar. Si kuntre dukét ne shtrat te fjales é te ngjaravèt mé gjakpiresin Naçon, Konstantin Eftimiu eshte njériu q'é shpetoj te mos bjére ne dore te guvérnit grék per krimen qe Naçua kish bere ne Mansure (Egjypte) dyké vrare konsolloze grék. Konstantini é truhu neper miqt é 'ti pa ditur faré q'ish kriminall, si nuku é dinin as ata qe ja shpune. Dhé kur u pikas i atilli, pa fjale, ata q'é truhne s'é nqasnin perpara déres, dh'aqé me shume Konst. Eftimiu qe mbét i-turperuar perpara njéresvé fuqimedhénj, qe ja u kish rékomandatur. Po, per kete gje Naçua ja hoqi Konstandinit t'é vrase ne sallen Pomu Vérdé si dukét me sipre. Konstandin Eftimiu ishté Nenekryétari i Shoqerise. Qofte i kujtuar émer' i ti per jéte.

BKSH

BKSH

## KAPTINA III

## N. NAÇUA DHÊ VÉPRAT Ê TIJ

### ARDHJA É N. NAÇOS NE BÛKURÉSHT

Ne kete hop, kur po gjèndèshim ne keto gezimè é siper, sè punerat vinin perpara dhè grèkomanisma u shua dhè kishim nisur te shtypim abètarèn dhè kengetorèn mè nje avlimènt (maqine) è mè shtypeshkronjen q'è kishim blère nga nje gazète, qe quhèshè «Trăznetul», na vjèn nga Misiri ne Bukurèsht, nje zoteni i cili quhèshe Nikolla Naçio èdhè pyèt per Vasilin è Risto Terpos. Nikola Naçio èdhê Vaske Terpua, pa ikur nga Korça, ishin shoke dhè kishin lojtur ne djaleri me nje méjdan; èdhè kur u poqne ne magazè te Vasil Terpos, ne rugen Karol No. 6, deftyèn nje nxèhtesire miqesijè sa une u stapita dhè pyèta cili qè. Mesova kush ish, dhè ritèsha gazit kur è degjonja qe flisté mè zjar atdhètarijè dhè na levdontè è na urontè per punen è shènteruar qe kishim nisur „kunder atyrè qènavèt greker—thoshtè - qe nè i shpetuam nga roberija dh'ata na duan humbjèn t'one dhè na leftojne mè ç'do menyre dhè na ndjèkin te na shuajne nga faqja è dhèut"

«Mua - thote—nga qe pikasne sé jam deshmimtar, i cilte per te shénten perlindjè te kombit, po me ndjékin te me zène po ika ne Turqi; atjé me ndoqne prape, mé qene sè kisha pashaport te grèkevèt, po m'i humpne gjyrmet, sè une ne

Turqi, ne Gégeri dhè ne Stamboll barita mé èmrin Elmas bèj dhé tashi ardha ketu ne més te atdhétarevét te punonj per kete çèshtjé bashke mé juvé; po jam sigur qe Guvérna Grèké do te me kerkonje nga polîcia dhé kam frike mos bjé ne dore te «*Grékavé*».

Vasil Terpua me thote: „—Aj t'a shpiém né Konstantin Efthimiu». ...Atjé Naçua ja deftéu te gjitha sa na kishté thene dhé névé. Konstantinit i beri nje pershtypjé te folurit dhê kurajua é Naços, dhé na thote vllashté: —«Deştept şi desgheţat bărbat este» (I squar dhé i çkrire burre eshte).

Dhé qe atjé me njembedhjéte ore para drékes véme; Konstantin Efthimiu, Vasil Terpo, Efthim Markua, une dhé Naçua, ne policié ku gjétme diréktore te policiés Llahovari, mé te ci'in u fjalos Konstantini dh'ay i tha qe gjér tan' s'é ka kerkuar njéri kete èmber édhé qe te mos jête i kujdésur per kete gj , kur qenka miku i ti édhé i propriétarit Terpos.

Me ora kater pas dréké, Konstantin Efthimiu mé Vasil Terpon dhé Naçon vane né Dhimitri Bratianu dhé i thone ç'duhéshé per Nik. Naçon; dhé atjé mér sigurimin Konstantini sé nuku do te jépét ne dore te grékervét, ndosé Dhim. Bratianu ndodhèshé kundershtar i te vellaj Ion Bratianu, qe ishté ne fuqi.

## Ç'KISH BERE NE MISSIR HAVAGA N. NAÇO

Si i hapi disa dyér Konstantin Efthimiu Naços, ky pastaj vinté véhte mé talanishtét é gerqishtèt é tija dhé dita per dita shtontè miq, sé shok nuk kishté nde kuximé. Pas dîsa muajsh, vjén nje «éfimeridhe» ne Bukurésht ngaj Athina «To Asty» dh'atjé kallezohét qysh po gjykohéj krim' é Mansurese (Egjypte).

Nikoll Naçua paskerké vrare konsullin grék per shkake trêgetijé te pambukevèt qe kishin midis atij, Horémit dhé Konsullit. Fajne pastaj é mori persiper i nipi, Vangjua i Mitke Naços, mè shprése se djaloshi ishté pa verste dhè *Havaga*. Nikoll Naçua mè qene jashte do t'é leshonje shpéjto. Naçua é mesoj djalin te thote sé é vrau nga qe i rembéu ndére.(??)

Po *Havaga* krisi mé nje pashaporte qe ja paragatoj

kavaz i konsullates se Turqise, dhé u be Elmas-béj: vajti ne Shqiperi—si thosh—pastaj ne Stamboll, tè béjléret t'ane, qe i dinté ngaj Spiro Dinua, i cili mbanté létrekembimé mé 'ta, mè ane te Iovan Vrétos, mikut te vjèter te Dinés dhé te Efthim Prandit, qe me 1878.

Qe nga Stambolli pra, N. Naçua na vjén ne Bukurésht si thame, *patriot i math*, po kur é pikasme per sé kish hikur nga Misiri, njèrezit miq, po mé ndér é mé rendesire, u zvordhe dhé Naçon me nuk' é aferonin, dhé me fort ay q'é kish truhur ne njérezit é fuqishme te vendit. Kejo ftohtesire beri qe Naçua te kerkonje shoke te tjére, qe s'ishin miq mè ata qe njétash è kishin larguar; dhè gjéti vellazerine Janaq Daja, qe rinin ne rugen Smârdan, çip mé rugen Shéllar. Keta i kishin mare dyqane V. Terpos, dyké shtuar qirane, dhe ay i fundit u mbajt perdréq ne «Konkordia».

Vellazeria Janaq Daja, trègetare te medhéj, mé miq dhè mé shoke mjaft, kishin mare dhé nje gjyq te nje turku qe gjykohéshé mé Shtétin é Ruman'se per Delten e Danubit te Dobroxhës; pune per disa miliona franga. E marin Naçon, qe ish armik i Terpo-vêt, te cilet tani s'é nqasnin perpara déres. Ay tani trazohét ne shoqerine t'one «Drita» dykè share è çndéruar shoket è shoqerise, te cilet u zvordh dita mé diten, dhé kerkojne t'a nxjérin jashte shoqerise, ku ay nuk iskté shkruar shok vertét, po as qe kish paguar makar nje te permuajshme, kurre!

## PER SHKAK TE NAÇOS «DRITA» BEHÉT «DITURIA»

Keshtu pra mblidhét shoqeria «Drita», me gjith' ate qe do te shkruajme me poshte, cilet jane dhé ç'do fare sumé qe darovitne ne kete shoqeri, dhe shartojne te ja kembéjne émerin è shoqerise „Drita" me èmerin „Dituria dyké bere statuta te tjèra mè nje nyje, qe te mos pranojne ç'fare do shok (dhè ne Stamboll revista «Drita» u kembyé mé èmerin «Dituria».) qe tani e tutjé, pervéç ata qe i njéh komitéti i shoqerise per njéres te urte dh'atdhétare te vertéte dhé jo ata qe paguajne muajn é pare vétem sa te hyjne hoke ne shoqeri, qe te mundin te na prishin pune. Keshtu

dhé u be shoqería «Dríta» mé kanonisme si thame.

Tashí shkruanj dhé shoket é shoq. «Dríta» mé sumen qe dhuroj sicilí.

Drasa é dhuronjesvè per te blère shtypshkronjen shqíp te shoqeríse «Dríta»

| | LEI |
|---|---|
| Anastas Avramídhí (Lakçè) | 2000 |
| Vellazería Hr. Tarpo | 1000 |
| Vellazería Ioaníd (Daja) | 500 |
| Vellazería E. Durro | 300 |
| Vellazería J. Gorguzí | 500 |
| Dhímítrí Tasovíçí | 500 |
| Níkolla Çakos | 200 |
| Vangjèl Gèço | 150 |
| Gjorgjí Gèço | 50 |
| Thèodor Níkollau | 150 |
| Vellazería A. Dodaní | 150 |
| Efthimí V. Marko | 500 |
| Konstantin Eftímíu | 150 |
| Thèohar Hrístu | 80 |
| Hrísto Karadza | 150 |
| Dhímítrí Níkollau Doda | 200 |
| Naqí Vaso Naça | 100 |
| Vellazería Vaske Çèvía | 100 |
| Spíraqè Eftímíu | 100 |
| Gjorgjí Thèodoru (Doka) | 200 |
| Dhímítrí Manushí Çíkerdhía | 100 |
| Níkollaq Eftímíu (Drènova) | 100 |
| Alèks Çíkozí | 100 |
| Naum A. Kamèníca | 50 |
| Dhímítrí Kolí Fècamí | 50 |
| Avram Ioanu (Papudzí) | 100 |
| Gjorgjí Vrètua | 50 |
| Spíro dhè Ioan Pandèlí Ilo | 50 |
| Vasíl Çaperí | 20 |
| Andrè Ioan Mboría | 100 |
| Naum Popa | 50 |

## THIMI VASIL MARKUA — KORÇA

Thimi V. Markua ishté nje nga te tri nisjatoret te levizjés kombjaré ne Bukurésht me 1881. Burre mé mesimé, mé urtesi te zgjédhur. mé deshire te shendéte, mé durim te math, mé kurajo, plot shprésa, i ndéruar dh'i dashur nga gjithe atdhètaret ketu dhè ne atdhéjen préj ata kombetaret te paqme, te pa intérésuarit, te pashiturit, te pafajshmit.

Si u dhiorganis shoqeria «Dég' é Stambollit» me 1881 dhé «Drita» me 1884 dh'u shtypne létrat shkollaré, u dergua ne Korçe ngaj Avramidhi Lakçia te perhapnje idéat kombjaré ; mé gjithe kundershtimét é grèkomanévét mundi te fitonje permbi 120 shtepi nacionalisté qe pranonin shkronjat kombjaré ne vent é atyré te huajavét, dhé do te kishin nje Llaso me te madhé sé ate te vjétren é pléqvé, te cilen shpirtkasmat é shitne, apo é shitne mé goje te ulkut, dyk' é quajtur «Llason Eliniqis qinotitos Koricas» ne vend «Llason Kristianiqis Orthodhoksu Koricas» (sé po kishin frike mos na é marin Muhamédanet). Po qé per te bere! Mireberesi Lakçé u trêmb nga lipesit è tradhetorevét mé profkat é tyré, dhé puna vonoj me shume ; po gjithe fitimtare duallme, mé gjithe dhélperite qe perdore grékomanet duké futur ne xhèp te Thimi Markos létra kryèngritjejè, qe te ndiqèt i ndyèri Thimi nga guvérna Tiranè. Esht è vertête qe hoqi te kèqia, po mbèti nje deshmor per idealèt shèntoré dhè i patrazuar ne istorine è perlindjès se kombit shqiptar.



THIMI VASIL MARKUA — KORÇA

Thimi V. Markua ishte një nga të tri misionarët të lëvizjes kombiare në Bukuresht më 1867. Burrë me besnimë, me urtësi të zgjedhur, me dëshirë të shëndoshë, me durim të madh, me kurajo, plot shpresa, i ndëruar dhe i dashur nga gjithë atdhetarët kelu dhe në atdhejeh, prej ata kombëtarët të paqme, të për interesuarit, të pashituri, të palajshmit.

Si u dhiorganis shoqëria «Dega e Stambollit» më 1881 dhe «Drita» mori 1884 dhe u shtypnë letrat shkollare, u dërgua në Korçë nga Avramidhi Lakçja të përhapnjë idéat kombiare, me gjithë kundështimit e grekomanëvet mundi të fitonjë përmbi 120 shtëpi nacionalistë që pranonin shkronjat kombiare në vënt të atyre të huajavet, dhe do të kishin një Klasë me të madhe se atë të vjetrën e plevë, të cilën shpirtkasmatë shume, apo e ishinë me gojë të ulkut, dyke e quajtur «Ljasori Ellinikis qinotitos Koriças» të vënd «Lason Kristianikis Orthodhoksu Koriças» (se po kishin frikë mos na e marnë Muhamedanët). Po që pas të bëret Mirebëresi Lakçe u trëmb nga fjesit e tradhëtorëvet me profkat e tyre, dhe puna vonoj me shumë; po gjithë fitimtarë duallme, me gjithë dhëmperitë që përdorë grekomanët dukë futur në xhep të Thimi Markos letra kryengritjeje, që të ndiqet i ndyerí Thimi nga guverna Turke. Lashtë vërtetë që hoqi të keqia, po mbeti një dashmor për idéat shëntore dhe i patrazuar në istorinë e përlindjes të kombit shqiptar.



GJORGJ VANGJÉL GJÉÇUA (Korçe)

Nje nga te tré NISJATORET per levizjén é shéntete te rilindjés se kombit shqiptar ish shpirt ndrituri Gjorgj Gjéçua. Fatmiresh ne istorin' é kombit shqipetar, sé ne magazé te keti goditi te gatuhét shpetim' i kombit per te paren hére, sikundre thame ne permendjat me sipre, sé qysh é solli shorta, apo kur «désh i Madhi Zot» qe te méndohémi dhé né per litératuren tene te haruare préj jétevé. Duhéshé te nisin aromenet tane te bejne litérature, qe te hyjme dhé né mé sénder dhé te bejme njoftim mè te zgjédhurit è Pérendise parushtare te Konstantinopojes vellazerit Halit Frasheri, Najim dhé Sami. Posa qe kembyém létra mé parushtaret dh'u vertétuam qe atjé s'mund te punohét dot,.dhé dote mbétét pamét puna si é Véqilarzhit, é Mitkos é Kupitorit, é Kulluriotit étj. shartuam te fillojme nje shoqeri litéraré, sé «désh i Madhi Zot» te kémi njérezine tane mé influénce neper atdhétaret é Bukuréshtit dhé pérsonal qe te tré Nisjatoret mé dy para grame dhé tri para besim. Kesish désh i Madhi Zot, punuam, u munduam dhé fituam. Gjorgji benté koréktu- rat me te shumat dhé perpiqéshé ne dergimét é libravé. Mos u harofshin mundimét é Gjorgj Gjéços ne istorin' é kombit!



## GJORGJ VANGJEL GJEÇUA (Korçe)

Një nga të tre NISJATORET për lëvizjen e shëndetshme të rilindjes së kombit shqiptar ish shpirt adhurues Gjorgj Gjeçua. Fatmiresh në istorin' e kombit shqipetar, se në magazë të kefi goditi të gatuhet shpetim' i kombit për të parën herë, sikundre thamë më përpara me sipre, se qysh e solli shorta, apo kur «desh i Madhi Zot» që të mëndohemi dhe në për literaturën tënë të harruarë prej jetëve. Duheshe të nisin aromënet tanë të bëjmë literaturë, që të hyjmë dhe në më sënder dhe të bëjmë njohjm me të zgjedhurit e Përëndisë paruslarë të Konstantinopojës vëllazërit Halil Frashëri, Naim dhe Sami. Posa që kembyem letra me paruashtaret dh'u vërtetuam që s'ngë s'mund të punohet dot, dhe doje mbetët pamet puna si e Vegjlarzhit, e Mitkos e Kupitorit, e Kulluriotit etj. shartuam të filloj me një shoqëri literarë, se «desh i Madhi Zot» të kemi njerëzime tanë me influence nëpër atdhetarët e Bukureshtit dhe personal që te të Nisjatoret me dy para grame dhe tri para besim. Kesish desh i Madhi Zot, punuam, u munduam dhe fituam. Gjorgji bënte korrektuar me të shumat dhe përpiqeshe në dergimet e librave. Mos u harrofshin mundimet e Gjorgj Gjeços në istori' e kombit.

BKSH



## VASIL TERPUA

Shpirtndrituri Vasil Terpua Korça ishtè diréku i çél-nikte dhé promotori i levizjès kombetaré per ngjalljèn é lètratures shqipetaré. Bashke mé kusburin' è ti Vangjo Gjèço-Terpon (Usta Vangjèle) qène te paret qe pranuan deshirat é Nisjatorevèt per rilindjèn é kombit shqipetar, dyké mblédhur gjithe shoket dhè gjèrinjte è tyré ne sallon te Vasil Terpos per te filluar te paren shoqeri shqipetaré per gramen kom-bjarè, è cila u émerua «Dég' é shoqerise Stambollit per grama shqipé.»

Nde kete mblédhjè mori pjèse dhé shpirt ndrituri mire-benjesi Anastas Avramidhi Lakçèa, dhé éntusiasmi ish ne kulmé, qe shoqria prèmtoj sé zuri renje te félla.

Vasil Terpua qe ate hère é gjèr sa mbylli syte qendroj shpirt i shoqerivèt mè te rèndura dhé mè te dhena per tere nèvojat é çèshtjés shenjtorè, pervèç atyrè qe ka dhene mè te shkruar.

Qofte i kujtuar èmer i ti per jète!

BKSH

BKSH

| | |
|---|---|
| Eftim Kolèci | 400 |
| Grigorè Paliu | 00 |
| Vellazeria Hr. Tarapaqi | 10 |
| Hristo Pandéli Ilo | 50 |
| Vangjèl Llazar Nija | 50 |
| Vellazeria Tasi Meria | 50 |
| Hèrakli Spiro Dèklèa | 50 |
| Konstatin Vèso Béllo | 50 |
| Naum Pètro Tarapaqi | 50 |
| Dhim. Th. Kalèmi | 40 |
| Dhim. Hr. Docka. | 50 |
| Vangjèl Koci Vellku | 50 |
| Kosmo Stèfan Evangjèlidi | 20 |
| Thanas Ciko Kone | 20 |
| Dhimitri D. Miçiaçio | 50 |
| Theodhor V. Emanoil | 50 |
| Than. Hristo dhè N. J. Evangjèli | 60 |
| Spiro Hr. Maçèdoniani | 50 |
| Anastas Raci | 50 |
| Tasi Topalli | 60 |
| Thoma Skundra | 30 |
| Thèodor J. Duro | 40 |
| Pa èmber | 50 |
| Spiro K. Veliko | 40 |
| Llazar Antoniu Kerpaçi | 50 |
| J. Pépino | 20 |
| Kost Kostaqi Dragashani | 20 |
| Pandèli Hrjsto | 30 |
| Pandèli Nare | 20 |
| Nikolla Emanoil | 20 |
| Dhim. Karabashi | 20 |
| Dhionis Mihail | 50 |
| Pa èmber | 200 |
| Agop Hadzi Adurèa | 10 |
| T. Ionèsku—Naè Ilièsku | 10 |
| I. Bèzjo,—R. Vintille | 10 |
| S. N. Keçulèsku | 5 |
| Pa èmber | 20 |

BKSH

| | |
|---|---|
| Lambi C. Çaperi | 40 |
| Grigor Çapéri | 40 |
| G. M. Stoiçèsku | 10 |
| C. Burbulèscu—G. Atan. | 10 |
| D. M. Ballmashi | 20 |
| G. Papadopullo | 10 |
| Efthim Marinka | 50 |
| Kostaq Duro | 20 |
| Ioan Dumitrèscu | 10 |
| Vèllazeria Kunésku | 40 |
| Marku Viktoroviç | 3 |
| Vell. Llasko Drènova (Dogani) | 40 |
| Zissu Vasiliu | 100 |
| Gjorgji Dhimitri Kalo | 50 |
| Ilié Fulluzi | 50 |
| Sotir Ion | 30 |
| Konst. Naumèsku (Raca) | 50 |
| Eftim Emanoil | 50 |
| Pètre Naum Bodo | 40 |
| Ziso Kosta | 10 |
| Hr, Vasiliu | 20 |
| Nik Hr. Tabaci | 80 |
| Naum Dimitriu (Mitaqi) | 50 |
| Naum Hr. Kasi | 40 |
| Vanglèl Ançè | 60 |
| Llazar Duro | 50 |
| Sotir Maçedoniani | 40 |
| | 10.828 |

Si u fillua shoqeria «*Dituria*» dh'u qerua nga disa shoke turbullonjes, perseri zu te lulezonje. Te permuajshét po mblidheshin, shtypeshkronja é porositur ne Viéne ardhi dhè librat, dorèshkronjat é Naimit dhé Samiut zune te shtypén dhè gezim' i shqipetarevèt ishtè ne kulme.

## NJE MBLÉDHJÉ MÉ KOBURÉ DHÉ KAMA

Atehèrè shoqeria «Dituria» ben mblèdhjén è permoteshmè te jape llogarite ne sallon te «Baraciès» qe quhèshè «Pomul Vèrdè», Te ftuarat è shokevét ne mblèdhjè ishin bere

BKSH

pas statutit: qe s'mund te hyjne brenda ne sallon pervèç ata qe jane shoke dhè qe kane paguar te permuajshmèt.

Ne diten è mblèdhjès kishim vene dhè dy ushtare, mare nga policia dhè nje kontrollor nga shoqeria dh'u mblodhe, afro, katerqint shoke; sè pervèç dhuratorevèt qe thame ardhe dhè te tjèret shoke qe ishin vètem mè te permuajshmèt. Dhè komitèti nisi te deftènje vèperat è motit, llogarite dhe librat qe kishin shtypur. Une isha shkronjes atehèrè dhè mè librat ne dore, qe ja u refènja shokevèt ne mblèdhjè Kur, degjohèt nje zallahi ne dèra è sallonit: Kishtè ardhur Naçua mè shoket è tia dhè mè nje shqipetar qe mbantè nje kafènè ne «Hotèll Patria» qe quhèshé Hristo Shulè, dhè kundershtohèshè mè policièn qe s'i lintê te hynin ne sallon brenda. N'ate kohe vjèn nje zoteni qe quhèshè Butkulèsku, dèputèt mè fame, te cilit Naçua i qè levduar qe perpiqèt per per atomenet è Pindit, èdhè beri qe Naçua mè Shulèn dhè tufen è tyrè té hyjne brenda ne sallon.

Ndement, u nis nje lufte mè stepinj midis shokevè te Naços dhè anetarevè te shoqerise, afer dèrès se sallonit, q'ishtè plot: u thyèn frona, kadra, polikandra, por Naçua mundi te harinje gjèr ne krye ku qendrontè komitèti, dhè nxjèr nje révolvèr, ja héq Konstantin Efthimiut dykè e sharet—„Bullgar èdhè grèk tradhetor!» Po rèvolvèri s'mori zjar, dhè kur dèsh te hiqtè persedyti, Thanas Harițua i-a zuri krahet qe prapa dhè Andrè Joan Mborja i a mori rèvolvère nga dora. Ahéré Naçua nxjèr nje kame dh'i bjé Thanas Haritos ne kellk, è çpoj q'i téptisi gjaku. Si shpetoj nga duart e Thanasit, i dèl perpara Avram Joan Papuxhiut, i a hèq dhe keti, po è zuri ne iliqke te robés, qe s'ishtè ngjitur pas trupit, dhé donté t'é hiqté kamen; po è mèr Tasi Topalli, që i-a dha komisarit, i cili kish ardhur ne kete hop, i thirur nga policia. E mèr Naçon dhè armet è tija, è shpijé ne policie dhe q'atjé ne burg «Vakarèsht».

Me tjatre ane, kémi vatur ne policie nè dirèktori Llahovari, mé Konstantin Efthimiun, i cili i deftèu ngjamen é Naços, qe kishté dhé nje shok si vétén é ti, te qojturin Hristo Shulé.

Policia dergon dy axhente ne kafèné te ti édhé è suall

BKSH

ashtu si ndodhèshê, é pyèti per ngjarjèn qe beri mè Naçon édhè ne eshte romen apo i huaj pune qe Konst. Eftimiu i a kishté thene me pare.

Edhè posa qe tha se ka pashaporte turku, as qe priti fjale me shume, po ardhi karoca é policièi edhè è mori ashtu si ndodhèshè dhè é shpuri ne gare, é perzuri nga Romania. Pas kohè mesuam sè kishtè vatur ne Egjypte.

N. Naçua ndenji pèse-gjashte muaj ne burg gjèr ardhi sera qe t'a gjykojne. Gjykatesit Bètonjes (Juratii), kur degjuan avokatet mbronjes te Naços, nje Palladi, nje Nikolla Ionèsku, profèsor e nje tjèter qe ish minister dhè Sènator, te cilet nxjèrin nga nje Naço, nje martir te romenizmitj édhè mè qe nuku ngjau vdèkjè, è gjètne ne udhe te leshohèt.

Kjo ngjarje so'li mjaft ftohtesire ne shoket è shoqerise «Dituria» dh'ata me pléqte na largonèshin. Po shtypeshkronja vintè perpara; vivllat shtypèshin pa rèshtur dhé vellazeria Tarpo, dhè me shume Vasil Terpua, mé harxhét è ti i dergontè ne Shqiperi, né Jovan Kosturi mè poste, nde Korçe, —i cili i perndantè neper shkollat q'ishin hapur édhè gjith, aqê neper popullin, qe i mbanin ne silahet, sa shetites europjane shkruanin: „nje popull qe meson karte pa shkolle".

Vivllat perndaheshin me te gjithe anet darovisht.

## SI É GJYKUAN PATRIOTET VÉPREN É N. NAÇOS

Me gjashte Mai 1886, Vrètua dergon lètre ne Konstantinopoje mé lajmòt te hidhura qe ngjane ne «Pomul vèrdè», nga gjakpiresi Naço, si thame me siper, èdhé me dhjéte Mai 1886, Sami Frasheri i shkruan pergjigjén è cila eshte.

*K-poje 10 Mars 1886*

*Vellaj im z. J. Vreto*

*Në Bukuresht*

U gëzuash qe jini mire nga shendéti, po u hèlmuash shume per te ngjarate qe kane ardhur ngaj i ligu, qe mos i qofte thene,

Thuaji shume te fala zotit Avramidhi èdhè zotit K. Eftimiut, te cileve è uronj qe shpetuan nga dor' e prodhotit te ndyre. Me èrdhi kèq per zotin Ath. Hariton, qe eshte plagosur; shkruajme si eshte. Bèsonj qe prodhoti te jète ne burg èdhè t'i-a kène prère per shtat' a tète vjèt, sè vèç qe dèsh te vristè, po édhè plagosi Ne eshte keshtu shpetuam mè kaqè nga ligesia è tij qe qenka m'è madhè sè è djallit; si ka èdhè turine. Nuk' è di sé a do t'u sjélle dem mblèdhjèvè te shoqerivè, si me shkruan q'u ka thene qytèteruajtesi, qe te mos mblidhi pasketaj ?

Mé kete ngaje i lutèm Vrètos te verrèaje mire ndrèqjèt (korèkturat) sé kane shume lajthimè vivllat è tyrè qe shtypén ketu dhè ndrèqjat te fundit duhèn derguar ne K-poje qe t'i bejne ata véhte....»

Pervéç ketyré Sami Frasheri me 1886 i shkruan njè létre Vretos mè me shume ngulm dyké thene:

«Nuk' é marim dot vésh psé te mos n'a dergohén nje hére ndertimét (korékturat)? Per sè kaqé nxitim? A po thoni qe te dale puna çpéjt ne shésh, qe te mos kéne ç'te thon te prapet? Po mua me dukét qe ate héré ata do te perpiqén me téper sé qellim' i tyré eshte te mos behét pune, dhé po te jéne vivllate plot mé lajthimé, ahêré do te gjéjne me téper ç'te thonë. Kendonjetorja eshte bere plot lajthimé, édhé shume gjerra é shume vendé jane bere me mire, po ç'do njéri do djalen é ti, pa lé-te jéte i shemtuar é i dobete, me mire sé sa doçne é se shoqése te bukure dhé te shendoshe. Po, qe ç'do vivlle dél mé émerit t'ati q'é ka shkrojtur, duhét te jéte pas sistémes te 'ti. Ne ka ndo nje te méte, ajo ndertohét po ndertohéte mé deshiren é 'ti, sé tjatri munt t'é quanje te mète dh'ato q'i zot' i vivlles i ka bere sistème, dukè dashure. Gjithe keto te pa udha mbétèshin me nj'ane po qe te na vinin ndertimèt è fundit ketu è t'i shikonim vète».

Pas ketaj pason nje lètre fort è çkrèpet, ne te cilen

vète Naimi dhè Samiu, i bièn undevèt! Vrètos, dykè çpallur qe nuku çkeput dot rrenjat, qe kane hèdhur ne zèmer qe ne foshnjeri nga grèqisma. Gjith ortografine te vivllavèt shkruar nga Bèjlèret, Vrètua ne ndertimèt (korèkturat) ja u kembèn. Ne vent *Thrasibuli*, Vrètua é ndroj *Thrasivuli, Babilonia—Vavilonia, Siçéle—Siqélia, Kartagjéne—Karqidhonia;* èdhè se-ketèjmi ardhi midis syrèsh nje fare ftohtesire, po mè pashnik (dullak). Pastaj bara è korèkturavèt me mbèti mua dhè kèshtu u nis midis nésh lètre-kembimi i dendur. Per keto kallezimè qe shkruanj kam te gjalla lètrat è tyrè, mè qe ngahèra kam qene trazuar ne keto kujdèsja; èdhè kam nèvoje me tutjè, kur do vinje sera, qe te kallezonj dhè une mendjèn qe kam patur bere per Vrèton, si kronikar i ndèrçme.

Me 10 Shkurt 1887, mar nje lètre nga Konstantinopoja.

## *Vellai yne Zoti V. A. Dodani ne Bukurésht*

Te fallèmi vellazerisht, muarme karten è zoterise s'atè te 26 muajit qe kaloj, èdhè u gezuame qe na ép te marrim vésh per ç'do pune. Sé psé Naçua beri nje shoqeri me vétehé s'ka gje, punen t'ene s'é prish. Kejo shoqeri é ré ne dashte te punoje drèjt per gjuhen è per kombin, po mire; jo ne mos dashte, po perpiqéte te te prishnje pune, ahèré bésojme èdhè shprésojme nga mendj' é nga dashuri é zotrise s'uaj qe kini per gjuhen é per memedhéne, qe do te mos t'i lini te bejne dot gje. Keta me nje gje vétem mundine te sjélline dem ne punet t'one: mé te mare shtypeshkronjen, é mé te humbur ate. Pandaj duhéte te perpiqi te mos u'a marine shtypetorène nga duarte tuaj, èdhé per kete duhète te perseritéte shoqeria juaj qe te mos ken' ata fjale ç'te thone.

Vivllate qe thoni sé na dergoj Gjéçoja mé posjet i muarme q'ate héré èdhê ja derguame ne Sallonik,

Pandeli Sotiriut, i cili u nis per ne Korçe te behéte mesonjetor. Po na i kishim shkruare z. Avramidhit te dergohéne disa jave nga njezét a tridhjéte vivlla gjér sa te behéne 100 prej sicilese-do; nuk' é dime persé s'na u derguan édhé te tjérate nga 20 a 30 per jave me postet. Po s'ka névoje te dergohène ketu; eshte me mire te dergohéne ne Salonik, n'émerin te z. Pandeli Sotiriut (poste-restante) édhé ay atjé ka lene njéri t'i marre é t'ja dergonje ne Korçe. Flalet q'jane thene *prézvit* Zija Bé, jane fort te mira. Né ate s'é njohime po ay munt te n'a njohe, édhe s'ka gje psé u-zu ngoje émeri yne, po vétem te mos è dije qe né perpiqemi per kete pune, é qe jane shkéluré vivllate tona, se pushtéta do qe te shkruajne é te kendojne shqip te krishteret, po nuku do qe te perzjéhene édhé musullmanet, te cilite i kane per tyrq e s'duane t'u ndahéne. Te lutémi t'i japesh karten qe te dergojme z. An. Avramidhit, t'i dergosh édhé z. J. Vrètos te tine, èdhè prapa te n'a shkruani.

Te perqafojme vellazerisht édhè vellaj yne te faléte.

Te fala gjithe shokevét é vellézervét.

*Sami Frasheri*
*Najim Frasheri*

## KAPTINA IV
# PROPAGANDA KOMBETARÈ NE KORÇE

## DY LÉTRA TE ÊFTHIM MARKOS

Mé qene qe nisèt sera é létrekembimévét, te cilate kane lidhjé mé perkujdésjat é çvilllimit ne perlindjé te létratures shqipé dhé ne shpetim te kombit t'one skllavosur nga dy-plla tiranijé, i-u benj vent lètravét qe kam mare nga gjithe atdhétaret qe kane leftuar bashke mé aqe sa munt ţ'i def-ténj dot mè lètrat é tyié origjinalé, te cîlat i ruanj è i kam kujdés t'ja dhuronj se arthmjés apo arqives shtèti t'one.

Kerkoj ndjése ngaj ata qe me kane shkruar nde kete çéshtjé dhè s'i kujtonj dot ketu. Ku é dinja un' ì gjori sé do te kémi kete fatmiresi te çperblehét mundim' i te gjithe-vét lufttarevé?!

Thame me siper sè qysh filluam shoqerin' é pare «dega é shoqerise Stambollit per vivlla shqípé».

Atjé n'ate mblèdhjé plaku Anastas Avramidhi Lakçé, per te paren hére shikon bashkatdhétare mblédhure tok per nje qellim te lartes é te shéntete, gjithe plot gezim é èntu-siazme, dykè pershendoshur ê uruar njeri-jatrin, é dyké sjélle ndéré te medha plakut milionar.

Plaku u éntuzias shume dhé n'a uron per nisjativen qe muarme dhé n'a dha shprésa é kurajo te medha. Goditi

qe atij kohé, nje shoku i ti korçar milionar gjithe ashtu i pa martuar, qe quhéshé Jovan Banka, gjithe pasurine é ti é kishtè dhuruar ne Gréqi, dhé kish mare nje fame. Tani, Lakçéja keshillonét mé né dhè prémton q'édh'ay te benje nje te mire per kombin é ti shqipetar.

Mé keto mèndimè vijonte jèten shpirt ndrituri Nastas Lakçèja gjér me 1884 kur u be è dyta mblédhj' é madhé q'u fillua shoqeria «Drita», si thame me pare. Plaku ahéré u çfaq mé zjar te math, qe ay t'è jfale gjithe gjene per ngjalljén é lètratures kombjaré shqipé.

Po, mé qe è dinté qe Korca ishté grékomané dhé nuku te nqase «llasua» é atij qytéti, gjuhen shqipè ne shkollat é atjéshmé, dukè ditur çèshtjèn è dhjates te Ligor Nuçes, cili vdip ne Kajro me 1883 kish lene 2500 napolona per kete qellim dhé „llasua" nuk ja nqasi.

Nastas Lakçéja, kur u lajmerua sè „Llasua» è Korçes ka nje kapital prèj 8—9 mije napolona dhè ky ka dy hère aqè, shartoj te benje nje «llaso» me vèhtè. Po dèsh se parj te dintè ne gjéndèn ne Korçe 30—40 shtepi kombetarê q'è duan shqipèn t'è mesojne,

Une dhè Gjorgji Géçua ishim te pa martuar. Efthim Markua ish I martuar dhè u shartua te vèje ne Korçe qe t'a proponje kete qellim dhè te mblédhe neneshkrimè sa gjéndén préj ata qe duan shkolle kombetaré. Kesish, ne kete kop kohé sa ndenj Efthim Markua ne Korçe vijonté dhé létdr-kembimi midis névé, te cilavè ju benj vend ketu pas origjinalévé, lètra qe mund t'i mbanj

*Korçe, 3 Shknrt 1887*

*Vellaj im Visar Dodani*

*nde Bukuresht*

Eshte vertèt qe une nuk t'u pergjigja ne karten t'endè te fundit; ngaja eshte sè une ketu gjèndèm ne shume brénga. E para eshte qe une nuk ri nat' e dite, dykè perkujdèsur per te shénteruaren pune te z. Avramidh, qe te vihèt ne udhe; è dyta jam ne pa-rèhat

sè grékomanet ketu me leftojne shume, dhè une dua t'u qendronj kunder gjèr sa t'u thyèt qafa; è trèta, kembènj kartra mè shume memedhètare te mire è te urte ne Egjipt, ne Stamboll, ne Manastir è ne Gjino-kastre, te cilet na lavdurojne dhè perpiqèn per t'u ngjallur è mjèra gjuhe shqip. Per keto ngaja te haronj ty dhè nuk te shkruanj. Ti, te lutèm te mos me harosh dhè te mos merzitesh po te me shkruash per te gjitha. Un' è di qe ato qe shkruanj nè z. Avramidhi dhè nè vellaj yne Gjorgji jane dhè per ty dhé i kendon dhe ti, ashtu dhè ato qe me shkruan ay jane dhè prèj téjè. Perpara me shkruantè Gjorgji, qe Visari i ka per te shkruar aqè per shoqerine te rè qe d bemjë sa dhè per shoqerine qe beri faqèziu Naçua; gjè sot nuk di gjekafsh; te lutèm te me shkruash gjer è gjate. Te me shkruash per vel'ane t'one Gabrillè Pèm-ma ne eshte vertéte qe u be shkronjes ne shoqeri te Naços, sé per te jam ne hidherim te math dhè ne se-mundjè.

Yt vella

*E. V. Marko*

Z-it Avramidhi i puth doren, thuaji qe djè è mbyila katastifne. U shkruan njeqint è tète dhjète me-medhètare. Javen qe vjèn kam per te bere mblèdhjén, qe te vème ndekembesine, dhè ahèrè i kam per te derguar *Praktikone* dhè i kam per te derguar gjer' è gjate.

*Prap ay*

*Korçë 24 Shkurt 1887*

*Visari im i dashur*

Mé te math gaz po pergjigièm sot ne lètren è Z-saté pé 11 te ketij muaji. Lètra joté, o vella, mbu-shi mè gaz zèmerat è ç'do shqipetari qe perpiqèt per te shènteruaren punen t'one. Ajo lètre jo vètem lètre gezimi eshte, por pembushi mè shpirt zèmerat è tè

gjithevè, qe faqèzinjte grèkomanèt nuk do te kène aqè tuqi qe te pçyjne ne te shènteruaren gjèllen t'one. O burrani, mos flisni, por perpiqi, sé sot hariti koha qe te dale è drèjta faqèza.

Msoni Visar, qe mè fuqi te Zotit, qe lavdi paste, gjèr sot deshira t'one u mbarua ; shkol'a shqipê u hap, druri qe vumè ne dhèt ketu dy vjèt, sot lulezoj dhè dha pème te èmbla. Gezoju sè djè u hap dhé u shkruan djèm mesonjetore 35. Zot' i jètes, o vella, é bèkofte dhè è shpente perpara per ndèr te te gjithevet. Mundimèt t'ona, Visar, dhè te luftuarit è faqèzinjvèt grèkomanè gjér sa mbaruam kete te shènteruare pune jane aqè shume sa nuk munt t'u-a shkruanj nde karte.

Me leftojne aqè sa nuk benèt me tèper ; por Zoti i jetes, lavdi paste, me ka dhene miq te shendoshe. te cilet me ruajne si driten è syrit tyré, èdhé nuk trémbèm kurre sè do pesonj gjekafshe nga grékomanet. E dini eili eshte Alo Béu, prandaj te jini rèhat per mua. Tashi vinj te te thèm, Visar, qe lipsèt te perkujdèsi qe te gjithe ; Terpo, Z. Dhiamandi, Thanasi, Harituà ètj. persa i shkruanj Gjorgjit qe te dalim faqébardhe perpara grèkomanevè, te cilet èdhè nuk pushojne se leftuari mè c'do fare maryfèti. Perkujdési te na dergoni sa me shpèjt nga 200 abétaré dhè kendonjetorè, per te cilat kèmi te madhé nèvoje, sè mesonjesi Pandèliu Sotiri nuk solli me shume sé 50 cope pè te trija sojèt. Nèvè qe djè na ardhe 35 mesonjetorè; shprèhim, qe per nje jave te kèmi me tèper sè 50, prandaj si é shihni eshte nèvoje te me dergoni qe te mos çalojme.

Tjater s'kam ç'te thom, sè nuk kam kohe. por tjater hére te kam per te shkruar gjer è gjate per te gjitha. Per punerat é z. Avramidhi shkrova me pare dhé po près te me vijne porosi nga z-tij qe t'i vè nde udhe. Kenduam dhé gazèten «Réforma» dh'u gezuam gjér ne shpirt ; u lumte dora ! I ndava dhè neper kafènè qe t'i kendojne dhè grèkomanet.

Yt vella *E. V. Markoja*

Z. Alo Bèu, Oran Bèu, Kapo Bèu, Rushit Bèu èdhè Jovani te falén mè ndèr. Jovani po djék mish : shpirt per te shénteruaren punen t'one é gjér tashi ka prishur shume para per dhaskajte dhè per shkollen. Lèvénxè dhè te shtruara u shpuri nga shtepia.

*Prap unë*

*Bukurésht 17 Mars 1897*

*Vllaj im Efthim Marko*

*nde Korçe*

Vètem nje Pèrendi è di sè qysh jam i gjalle, sé qysh i ngrys dhè i gdhinj ditet, sè si mar pènden te shkruanj kete lajmè te kéqé dhè te trégonj sé zoti Avramidhi na shkurtoj fjalen é na è préu shprèsen dhè hove, qe kishim mare pas fjalevé te tija.

Ay me deftèn nje lètre qe kishtè mare nga Kristaq Nikua dhè Llambroklí Tsalja, qe i shkruanin sé «vétem kur te vdèsim nèvè qe te dy kini per te arrire qellimèt è marezite qe ndiqni ju bashke mé turqit, qe te na kllisni gjuhen shqipé neper shkollat t'ona. Po, eshte turp per plèqerine te z-s'atè te te hèqin per undé disa çilimínj si Viska Dodani, si Thimiu Markua è Gjorgji Gèçua è tè jépni duart mé turqit è te na vini ne zjar mé shqipèn è te na ndani nga grèket. Sa per bègatine qe prèmton sédhenkè kater hére me shume sè ç'kémi né ne «Llason» é Korçes, te asigurojme qe nuku trèmbèt Korça plake, sa te jèmi néve gjalle, makar qe kinini zene shoke béjlèret; ato para kush è di si jane fituar, prandaj do te hyjne ne dore t'one, ja po do t'i mare «hèra è s'hèra». Tashi dua te m'a provojne bèjléret ç'fuqi kane mè te ketilla lètra, pastaj te jap une paraçkat t'imè. Dua te shkruash tashti nje lètre Alo-Bèut dhè Orhan Bèut, nga ana t'endé dhé t'u thuash qe Avramidhi me s'trazohèt me tutjè mé nèvè, dhé do t'i mare prape prèmtimèt, po te mos reféni z-juaj fuqine qe kini per keta grèkomane. Ay do qe te dèrdhèt gjak

sè eshte nga fisi i dashit, eshte «Rígas o Fèrèos»; tjèter soj ay s'jép paraçka».

Une, o vellaçko, po zjènja dhè nuk i pergjigjésha po è shikonja ne sy; me shtrengon te flas, ja po te mar kondile te shkruaj ç'kerkontè. Mèndohèsha te mos benj dhè une si beri Vrètua mé Konstantin Zhapen èdhè u beshe i urte. I flas méngadalè dhe i thom, qe une nuku munt te shkruanj kesi lètrè ne béjlèret sè kam turp te deftèhém kaqé i lèhte ne bèjlèret, qe díç na pandèhin, z. Nastas, po as qe te lè zoterinjotè plak njèri, *évérgjét*, mé nje fame te mire, te zbulohésh sé dashkerkè gjak?... Po ata béjlèret ç'do te thone valle?... Po ky kauri si na pandéu névé, qe vrakerkémi kur dashka Lakçéja? Po ja vrame keta dhè néser mér nje tjater léter préj 5—6 paresínj, qe i shkruajne ca me kéq é me rende, nèvé perseri duhét t'i vrasim?... Nuku te dukét qe turperohésh édhé qéshésh?... Dhé shtrigu me thote sé ay i-a tha keto Pandéliut édhè i ka bere kete pergjigjé, qe t'a perkthésh ti te paqmé dhé t'a neneshkruash;... ja sè ku u shkruaka é atille. Une i thashe qe ay dèsh te shpetontè nga z-joté, èdhé beri ç'i thè, po, pa i thuaj t'a shkruaje, ay do t'a neneshkruaje?...

Plaku zémerohét, dhé une gjithe mé butesire i thashé: «Kete s'é pandéhem kurre nga z-jotè! Na dhé kurajo, na dhé fjalen é ndérit, qe po t'a dish sigur sé Korça ka 20—30 shtepi qe duan shqipèn, z-juaj beni nje «llaso» mé véhté dhé hapni shkolla kombetaré. Dergové Thimi Markon ne Korçe dhè ay mblodhi 160 shtepi qe ju derguan neneshkrimét dhé mé ate gezim, mé kurajon é z-s'uaj mbajti siper é larter féne dhé kane harire shpirtrat midis atevét è bijvét, midis vellézervé é kusherinjvèt kaqé sa mént keputén dhé z joté tani é lé te bir' é botes mb'udhe? étj, étj."

Fundja ay te shkroj tyne ate létre te qélbur, pa zene ngoje béjlére é gjak, po t'a préu mé fjalen qe «Si me genjyhét ju genjèva, une mc s'nakatosém».

Ate lètre i-a dha z. Spir s, qe t'i-a shkruanje adrésen, édhé ay t'i vére plikon è postalèt èdhé te t'a dergoje ne Korçe.

Vellaj yt te nésermét m'a solli mua t'a kendonj; mua sikur me goditi dambllája, sé shume félle kishim hyre. Te nésermèt maçoku me vjèn ne dyqan édhé me gjén ku hanja darken è kerkova te me sjéllin nje *mishmash*; hop dhè shtrigu: «Dhé mua nje kupe vére te zéze».

Une bera sikur s'degjova. Posa mbarova buken, ay né dy pale syzé dhé do te me kendonje nje lètre qe ka bere gati, po une s'é lashe faré, i-a mora létren nga dora, i-a palosa dhé i-a ngula ne xhép duké thene: «Mjaft na genjévé, mjaft». Edhé hika ne birt dyké thirur: «Vine, vine»! dhé é lashe vétem ne tézgja gjér sa iku. Q'atjé vétè ne dyqan t'uaj i thote Spiros q'é dbova «qe ay tutkuni me beri per dy para dhé me tha: te kam ne xhép, mjaft na genjévé, dhè me la si karagjos».

Me s'me ardhi dy jave, ay qe dy hère ne dite qé mé mua, dhé né juvè per nate. Po, nje dite i thote Spiros: «Une s'ronj dot pa Visken, te me pajtosh!» Me thote Spirua dyké qéshur: «Oré, ay shtrigu keshtu me thote dhé eshte né Gorguzi po me prèt. Une do te vinj mè te, po shiko mbaju mos é turperosh». Me vijne te dy dhé qe jashte me therèt: «Vissar, mé gas te hynj?" O urdheroni, urdheroni! dhé ja hap déren perseri. Hopésh, hopèsh me thote qe i vjén kèq sé s'ben ate qe kish nderment, po nga shoqeria s'ndahét. Po do te kembéje dhiaten dyké bétuar è do te beje pas deshires s'one; te ngjalle 5-6 shtepi gjerinj-Shen Gjérgj Politèhnje e te tjera, vetem per Korçen. Esht i hidheruar nga letrat q'i kane derguar paresia dhè fjalen qe mbajti Heqim i Mançit ne mbledhje dyke thene: „O vellézer! Doni milionat e Nastas Lakçés qe te vême ne shkollat shqipén édhé te behémi turq, apo te jémi te krishtére e fukarènj si pleqte t'ane?» Keshtu qe une ne te pamét jam mire me Avramidhe èdhé ti, o vellaçko beju trim, dhé quajé çeshtjén è shtrigut si nje ender. Mjaft, sè kur na duhéshé rendesira è kishim; tani ndjénjat u hapne, lètra te flakta na vijne, vivlla na ker-

kojne dyke shtuar dita mé diten ; po beju burre dhe perpara, sé jona or jona ! Mos u deshpero, mos fole faré fare gje te plakut. Ti s'je si mua, ti jé i urte i dutuar, do te mundesh te durosh nga dalé, nga dalé sè jé Thimiu mè ment, mé grame shume dhè Shqiperia pati nje *kesmèt* qe te ndodhesh ti atjè dhe jo un' a Gjorgji.

Te puth mè mall si vella,

*Viska Dodani*

LÊTRA PRÊJ STAMBOLLI DHÈ PRÈJ KORÇÈ

*Konstantinopoje, 11 Prill 1881*

*Fort i ndérçem é i dashur z. Visar Dodani, te falèmi*

Muarme èdhé karten é 31 te Marsit te zoterise s'até édhè u gezuam fort nga ndèri qe na ben dykè na shkruar per hèra.

Vivllat qe derguat ne Korçe kane vajtur, edhè te tjérat kur t'u duhèn, na shkruani edhè dergohini dhê ato ne kete menyre: pandalja é tyré eshte kollaj, po s'ka édhé nèvoje, sé ajo pandaljé eshte mjaft per te gjitha.

Zotit Vrèto i kémi shkruar gjat' è gjere per ç'do pune. Perpiquni bashke te mbahèt é aty shoqeria èdhè shtypetorja tè jete gati.

Te perqafojme vellazerisht,

*Sami Frasheri*

*Naim Frasheri*

*Korçë 29 Prill 188.*

*Vellaj im i dashur Visar Dodani*

Karten t'endè pè 17 Marsit e mora dhè mesova mé hidherim shpirti te gjitha sa na shkruan. Nuku t'u pergjigja javen è pare sé mendja t'imé isht' è trumbulluare. Sot te pergjigjèm dhè te thom mè pak fjale qe

sjèllja é z. Avramidhi me hèlmoj shume, sa nuku benète me teper, per ngajat qe do shikosh nga kartà jimé mbi Gjorgjín. Por sì do qe ngjau kejo pune, fjalet te urta tendè me halladitin dhè me defréjne zémren t'ime ne kete te madhè turpjè qe m'u be. Lavdi paste Zoti i jètes qe me ç'do njeri ka dhene dhé miq te vertete. Eshte vertèt, Visar, qe puna e [shenteruar qe kémi nisur qe kohe, nuku shpièn vètem ne nje njèri, po per me me shume. te lavdurojme Zotne qe è pruri punen gjèr ketu per ndèrjén te te gjithevét dhé turpjen te trathetorevèt grékomanevèt. Ay Zot i vertète qe pruri punen gjèr ketu, ay, i qofshim fale, ndés zèmerat dite mè dite te shume shqipetarevèt mé ment dhè deshire per gjuhen dhé memedhéthin è tyré Zot i jètes, qe èmeri dhé fuqia é ti qofshin te medha ne gjithe botene sot hèth shkendia te pa-pamé me ç'do ane te Shqiperise. Sot nuk eshte vent i Shqiperise qe te mos ndodhèn burra shqipetare, ne fyèjt te te cilevèt te mos levrinje gjak shqipetari, dhe te cilet te mos perpiqèn per kete te shenteruar pune. Nga te gjithe anet é Shqiperise marime kartra hiri dhé gezimi per shkollene qe hapme. Z. Othan-béu me shume bèjlère te Shqiperise i shkruajne dhè i kerkojne vivlla Ky zoteri, qe Pérendia i dhente te gjitha te mirat, ka mendjé (mjèt) ne vère te dale ne gjithe Shqiperine per te ndèzur é gjithe bèjlèret dhé te mblèdhe ndihma. Por mé gjithe qe n'a derguate afro 600 cope vivlla, u lutèmi te na dergoni èdhè te tjéra, me shume abètarè èdhè kengetoré; per «Mirevètja» nuk eshte nèvoje; ne mès te tyrè vini dhè nga ca pè te gjitha sojet, sé ketu na vine pa ndonje ndaljè. Eshte nèvoje per ca pé ato.

Tjater nuk kam ç't'u shkruanj, pervèç te lutèm te perkujdèsèsh dhè ti per sa i shkruanj Gjorgjit te mos turperohémi. Mesoni dhè kete qe njendizaj muarme nje karte qe nga Llamia, nga Konst. Calèjo, i cili na uron per shkollen dhè na lutèt t'i dergojme nga nje vivlle pé te gjttha. Zjari hyri gjér ne shtepi te armikevét. Te perqafonj vellazerisht

*E. V. Marko*

BKSH

Edhè une vellaj i z-satè te perqafonj vellazerisht dhè lutém te perkujdési per sa u shkruan Thimiu me siper.

*Orhan*

*8 Mars 1881, K-poje*

*Vellaj im i dashur, Visar Dodani*

Te Shtune qe shkoj u shkruam karte bashke mé Najim bèjne é mé Sami béjne, po te pergjigjur nuku kèmi mare. U shkruam qe muarme karte te bashkte te Orhan-béut, te Jovan Kosturit dhé te Efthim V. Markos. Nde ate karte shkruanine sè mesonjetoréja vété mbare Pajtuane dhé nje mesonjetor per turqlshtén frengjisht ép msim Pandéliu Sotiri Postenani. Ishin ne te pajtuare dhé nje msonjetor per élinishtén po s'é kishine mbaruare, sé u tha qe te méntohèt pa t'u ipté fjale. Dukéte q'i kishin hyre t'i prishine mendjène faqè zèste armiqt' è kombit tyrè, te cilet kishin derguar dhè nje karte nde flètet te „Nèollogos» dhè é kish shkruar nde flètet te se Merkures 6 te ketij muaji èdhè nde ate dèrdhine farmaqn' e tyrè èdhè tradhetimè dukè mesuare guvèrnen qe t'è ç'duknje mè kohe punen è shqipés.

Shkruanine Orhanbèu, Jovani dhè Efthimi mundnine te bejne katerqint gjèr me pèseqint nga dy grosh per kolle te shtypure qe te mbaronèn vivllat qe kane mbétur pa shtypur pastaj nje fléte per jave, a nje flètorè per muaj si te dukèt mire. Kj gje na u duk dhè nje tjèter çap ne mbaresi dhè u gezuam, muntme dhé ketu te oejme ca ndihma te tilla.

Te perqafonj vellazerisht.

*I. Vreto*

*Ne K-poje, te 1 Majit 1887*

*Vellaj yne i dashure é zot i ndérçme Visar A. Dodani, te falémi*

Kartat qe muarme kete jave nga Korça na tre-

fèjne sé shkolla atjè vèté shume mbare èdhé kane nderment te bejne nje shoqeri è te bejne 400—500 ndihma qe te paguajne per te shkélur vivlla mesimi è ç'do faré flètorè te névojshem, èdhè keto bèsojme qe prape do te shkèlèn aty ; prandaj u ļlutèmi te perpiqi te behèt prape aty shoqeria, è cila si marim vèsh nga zoti Vrètua eshte gati per te bere. Sa po tani s'kèmi ç'te te shkruajme, u shkruajme mè udzitim édhè te lutèmi te na shkruash per jave qe te dime ç'behète.

Te falèmi si èdhè ketyrè vellèzervè qe na tha z. Vrèto èdhé shokevét te tyrè: Vangjèl Gèços te birit te Gjorgjit, te katervè vellèzervé Terpo, Thanas Haritos, Nik. dhè Pan. Jano Vangjélit, Spiro Monit, Andrè Mborjès, Dhimitri Dockes, Thèohar Hristos, Gavril Pèmes èdhè vèçan z. Konst. Efthimit èdhè z. Konst. Naumèskos èdhè gjithe shokevèt é vellèzervét qe dini z juaj.

*Naim H. Frasheri, Sami Frasheri, I. Vreto*

Z. Vangjél Géços èdhé gjithe zoterinjvét qe mbajtne mire vellane t'èm z. I. Vrèto, si na tha, u jèmi gjithe nene bare édhé u-a dime te miren

*Sami Frasheri*

Dergonani èdhé ca vivlla ketu mè postet sè na kerkojne miqte, duan; t'u dergojme èdhè ca zoterinjvè te large ne udhen Bavi Ali No. 7.

*K-poje 16 Maj 1887*

*Zoti i ndérçem dhé vellaj i dashur Z. V. Dodani*

Gjithe ketu jèmi mire. Muarme karterat è zoteris satè te 5 dhè te 6 Majit, è u gezuam shume per mbaresite q'u nisne se rish è per shoqerit' qe po behen. Ne Korçe mesonjetoréja po vèté mbroth. Shoke é ndihmes per shoqerit' è atjéshmè mund te

BKSH

behèn dhè ne Korçe, èdhè ketu si dhè ne Egjipte è gjètke. Shoqeria è Bukuréshtit eshte névoje te jéte é paréshtuare, flètorè ka dhè mé gati, èdhè te tjéra po behén, andaj shtypeshkronja te mos mbyllete kurre, po te jéte hapur gjithenje, sè kjo do t'a beje shqipetare te mbaruar. Ne gas te math jémi qe shohem sè pun' é mbare ze fill se rish. Perqafojme gjithe vellézerit è shoqerivè qe pærpiqén per punet te mbar' è te pèrendishmè èdhè u jémi per jète nene bare. Zot i vertète è bèkofte shoqerine è vellazerine dhè punen è sjéllte djathtazi.

Te perqafojme vellazerisht dhè te lutémi t'u thuash te fala gjithe shokevè é vellézervét èmer me èmer.

Flétorèt qe na dèrgovè i muarme kete hère mé 9 Maj.

Vellézerit è zoterise s'uaj.

*Sami Frasheri*

*Naim Frasheri*

## QYSH PERPARONTÈ PROPAGANDA

Dykè derguar pergjigje dhè vivlla me te gjithe anet, èdhè me te shumtat ne Korçe ne Jovan Kosturi, pyès me ç'visé jane hapur shkolla nè Shqiperi èdhé ne funt te Janarit 1888 mora pergjigjén nga Korça.

*17 Janar 1888*

*Vella i dashur z. Visar Dodani*

Karten é z-saté me 29 te muajit qe dolli si édhè vivllat qe na dergové i muarme édhè te falémi ndérse. Zoti te dhente gjithe te mirat édhé te ngjate jèten.

Na shkruan qe t'u shenojme nje hére holl' è mire sa shkolla jane hapur gjèr tani neper Shqiperi èdhé ku ê ku qe te mbani alillografi mé ata édhé per te kupetuar si véne é ç'lipsèn, é ç'fuqi kane, Per kete pune, na sè ku te shkruajme qe gjèr me sot s'jane hapur te tjèra mesonjetoré shqipé pervèç ketu èdhè nde Pogradèc, po me shume fshatra kane zene te mesojne shqip, si nde Trèske, Poléne, Luaras, édhé gjètke jane

me te hapur è siper, ne Hèrséke te Kolonjes, ne Lèskovik édhé nde Elbasan, sindekur mesojme.

Perseri u lutèmi te perkujdèsi per te shtypurit é te tjèravè vivllavè sa me shpèjt sépsè eshte nèvoje è madhè per 'to.

Te perqafonj vellazerisht

*Jovan Kr. Kosturi*

*Beni-Souef 31-12-1888*

*Zoti Visar Dodani,*

S'me kè shkruar ndonjehère qe te gezohém per shendètin t'end, sé nuku te kam te huaj. Perpiqi o trima, per gjuhen t'ene sa te shtijém faren é shènjte é te zéte renje, pastaj do te mbinje è do te shtohèt vétiu èdhè te miren qe po bejme sot, Zot i jètes do na è shperblèje. Mblidhi vellazerisht te gjithe, trimeroji dhè ç'kathoji sa mè mund qe te mos na marin neper kembe grékerit, psè né jèmi palca é kombèvè te Balkanit, dhè Europa è di mire. Po duhét èdhè nèvé véte te deftèhémi sé «Ron Shqiperia é nuk u trèt!» Gjithe vellèzervè u falèmi mè shendét, é i lutèmi Zotit t'ju jape zèmre te gjere é te mire per kete pune te shènjte qe kèmi zene.

Te puth syte, édhè t'im bij Kosta dhè Mitri te falèn.

*E. Mitko*

*Bukuresht 22 Gusht 1888*

*I nderçem e i dashur z. Efthim Mitko*

Te kerkonj nje mije ndjèsa sè u deftéjèsh pertac qe s'ju pergjigja mé kohe létres z-s'uaj shkruar qe ne Prill. Te mesuarit t'im s'eshte pa ngaje, po me kote mprohém, gjithe fajtor quhém mé qe s'te shkrova dot.

Djé mora lètren é dyte te z-s'uaj shkruar qe me 11 te ketij dhé u gezuash fort shume, sè s'ma paské shkruar per meri per sjèlljèt é mija. U paçim shendoshe.



SPIRAQ EFTIMIU

Lindur nde Bukurèsht, i bir' i Gjorgj Eftimiut, avokat ministériabil; mé gjith ato nuk haroj faré ndjènjat kombjaré posi ata vellézérit tane te Italise. I ndyéri Spiraq Eftimiu mè pakursim, mè fytyren é tij te çquar na ish gati te ndodhét ne mblédhjét é Shoqerise «Drita» «Dituria» per te dhiorganisur Statutèt é Shoqerivèt.

Ndjése paste !

BKSH

Nèvé jèmi mire nga shendèti dhè nga punet é shoqerise, nga te dyja keto qe te intérésojne. Shoqeria j'one «Dituria» u perterit édhè kish nene shtypjé abétaré te tjéra qe u mbaruan. Gezoju sé shtypme 3000 cope kete hére, mbi ato 2000 te parat nga te cilat kèmi éndè; shtypme édhè 2000 cope Diturite édhé 2000 Dhèshkronja. Tani arka ka mbètur zbrazur. Kam prishur dhé pè t'imèt. Lark nga mua te te mburèm mé kete kallezim, po dua te thém qé na kane mbétur pak shoke ne shoqeri, dhé mé shume rendesire mblídhén ndihma; andaj jam shume i hidheruar sé kam frike dhè nuk di a do mundim te vème perpara? Sé per véç qèsatit te math qe kémi ketu, po kèmi mèkatne qe kamesit s'japin pa dhene te vobèket trégetare, per te cilet na pyésin: «Ku i kini shoket?» Anathèma, ç'na beri ay djall Naço! Disa nga ata qe i dinim te mos japin ndihma na thone, po mè ze te shuar. sikur eshte ndonje mfshénje: „Mja-ni, s'eshte koha tashi; s'behét gje!»... dhè te ketijte sbythin dhé te tjeret. Flasin mé nje talént si-kur jane diplomate posa ngritur nga sofr' è Bizmark-ut. E di mire qe te hélmonj mé keto kallezimè, po s'dua prape te mbétémi vétem mé shprésat é ketushmé. Névé gjith do te è héqim zvare ketu, sé kam amfer t'im ungjer po «s'behèt véra mé nje lulé». Pastaj thom qe névè punojme, mundét perseri te mblèdhim shoke; po dhé z joté sa jè ne gjallime veshtro atjé ne Misir t'è ngjallesh perseri deshiren kombjaré te na dergohén gjekafsh nga atá qe jane shkrojtur; tani koh' è Arabi-Pashes u largua. Te paken sa te vdéç i gezuar, sé punen é shénte qe niste dhé né ju ndoqme pas, t'é shikojme te mbaruar,

Te puth doren è te perqafonj mé mall si djali t'uaj

*Viske Thanas Dodani*

P. S. Z. Lakçéja eshte jashte Bukuréshtit, ne çiflik. Keto dit' é prèsim te vinje dhé lètren é z-s'uaj do te ja jap ne dore.

## KAPTINA V

## AKTIVITÈTI I SHOQERISE «DITURIA»

### VÈPRIMÈT É SHOQERISE «DITURIA»

Víme taní ne gjéndjén é Komítétít te Shoqĕríse «Díturía» te cilet jane :

| | |
|---|---|
| Kryés | Kostaq Duro |
| Nenekryés | Thanas Harίton |
| Arketar | Spíro Marko |
| Shkonjetore | Vísaríon Dodaní |
| » | Gjorgj Gjéço |
| Shoke | Vasíl Hr. Tarpo |
| « | Gjérgj Théodor |
| « | Zíso Valíu |
| « | Spíro Gorguzí |
| « | Gjorgj Llazar |
| Çenzore | Théohar Hrístu |
| « | Konst. Naumescu |

Si u zgjoth Komitèti dhé arka è Shoqerise ishté me te mbaruar, me njane nga qe prishéshin per vivllat, me tjater ane shoqeria kish rene ne litargji nga turbullsirat è Naços, tani mé ngajen è perteritjes, «Diturise», pas zakonit, per

BKSH



THANAS HARITUA

Pas familiès Tarpo dhé Gjéço, ndenment vjèn Zotí Thanas Haritua dhé Nikollaq Evangjèli qe pushtuan idéat è nisjatorevét te perlindjès se kombit shqipetar.

Thanas Haritua ish shume hère i zgjédhur nenekryés i shoqerivét, dhè bashke mé 'Nikollaq Evangjèle mbétne dirèke te forte te idhése shènte. Mè gjithe qe tradhetor' i kombit, apo marroci gjakpiresi Naço ja nguli kamen ne kellk ne Pomu Vérdè qe vojti trè muaj, ay qendroj burre ne shoqerite kombjaré.

Qoft' i pa haruar èmer' i ketyre dy dirèkevè te shoqerivé kombjarè.

THANAS HARITUA

Pas familiës Tirana dhe Gjeçe, ndermënt vjcä Zoti Thanas Haritua, dhe Nikolla Evangjëli qe gushtoan idéat e nisiatorevet te gelindjës se Kombit shqiptar.

Thanas Haritua, ish shume here i zgjedhur nenkryetar i shoqërivet, dhe bashke me Nikolla Evangjëlin mbëtne direkte te forte te ndihmes së vetë. Me gjithe qe tradhetor i Kombit, apo matnost gjakeverës Nako ia ngujë kaqyn ne krahet ne Pomu Vëdë ne vojta të muaj, ay qendroi burre ne shoqerite kombjare.

Qofte ipa Harusa ... dy dirdhe ... te shoqerive kombjare,

SOTIR TARPO

Nga dirèket è shoqerivét shqipetaré ish dhè i ndyèri Sotir Tarpo Posi i vellaji i 'ti, Vasil Tarpo, ka punuar mè zjar te shéntete per shpetimn' è Atdhèut, pa kursyér haroma per dergimèt è bibllavè ne Shqiperi.

Ka qene arketar i komitètit dhé ne kohe kur u mbaruan se shtypuri bibllat, qe te mos paguanje shoqeria qira shtepiè kotte, ndertoj ènkas nje godine ne obor te shtepise se ti str. Poliţiėi 9, ku mbajtme shtypeshkronjen disa vjétè, dhé ku u shtypne bibllat è fundit pa ndonje page.

Qoft' i paharuar émeri i ti!

BKSH

BKSH



DIAMANDI TARPO

Diamandi H. Tarpo, i dyti vella mé Vasil Tarpon, anetar i shoqerise shqipé dhè arketar ne komitét.

Eshte per te mbajtur ment èmeri i ti sè é para shkolle me gjuhen kombjaré u hap ne shtepin é Diamandi Tarpos ku gjéndèt édhé sot, te cilen è fali mé goje per nga héra. Kish létre kembim mé te ndyèrin Naim Frasherin; pa nj'ère kur Naimi è keshillontè te fale shtepine sa esht' i gjalle, i pergjigjét qe shume hère i vjèn gjér ne goja t'è jape, po é gelltit prape. Edhé Naimi mé qéshka i shkruantè: «Kur te te vinje tjatre bére gjér ne goja, thirè tet nip Visken te te shtrengonje per gryké qe te mos munç t'é gelltitesh». Mè te vertéte i ndyèri Diamandi nuku jéptè si te vellèzerit, po mé fjalen é vdékjés è fali shtepine.

BKSH

PÉTRÉ HR. TARPO

Nje nga vellazería Hr. Tarpo eshte dhé Zotí Pétré Tarpo, m'í vogelí. Burr' í urte dh' í pa larguar nga ndihmat qe shtepía Tarpo í ka dhene çështjès shèntorè. Zèmer' è millovatur nga hèra, ka deftyèr deshíra mírebenjesé dhè Korça shprèson mjaft nga ky Zoterí.

BKSH

véç pagímévèt te permuajshmé me 11 Qérshor 1987 ju be nje prike é vogel è cila pason ;

| | | LEI |
|---|---|---|
| Vasíl Tarpo | | 100 |
| Díamandí Tarpo | | 80 |
| Sotír Tarpo | | 100 |
| Thanas Haríton | | 50 |
| Vellazería V. Marko | | 150 |
| Avram Ioan | | 50 |
| Petro Tarpo | | 60 |
| Gjeorgje Llazar | | 75 |
| Evangjél édhè Gjérgj Géço | | 100 |
| Dhionís Míhaíl | | 50 |
| Théméli Hrísto | | 30 |
| Kostaq Duro | | 100 |
| Zísu Vasilíu | | 50 |
| Gavríl Péma | | 100 |
| Vellazería Dodaní | | 100 |
| Eraklí dhé Thém. Duro | | 100 |
| André Ioan | | 20 |
| Eftím Emanoíl | | 20 |
| Dhím. Docka | | 20 |
| Vasíl Emanoíl | | 20 |
| Ník Evangjélí | | 20 |
| Gjérgj Théodoru | | 100 |
| Vangjél Anastasíu | | 20 |
| Anoním | | 10 |
| G. Atanasíu | | 15 |
| Efthím Lazí | | 40 |
| Naum Kameníca | | 20 |
| Míhallaq Qiríca | | 20 |
| Konst. Naumescu | | 10 |
| Naum V. Sotíriu | | 5 |
| | | 1635 |

BKSH

## DISA VÊNDIMÈ TE KOMITÊTIT

Me 30 Shen Endré 1887, shoqeria «Dituria» shartoj te shtypèt Dhéshkronja (Géografia) dhé Fizikoistoria, dhé émerohét Thanas Haritua, Spiro Markua dhe Visar Dodani te mbléđhin darovat q'u neneshkruan si đhé te tjèra, ku te mundin đhé kane te drèjten qe te japin deftésa per sa qe te mblèđhin.

*Komiteti*

(Pasojne èmerat đhè vula)

Me 25 Kollozhéku 1888, mblèđhja è shoqerise «Dituria» mori shartim: 1) Te njojturin è statutèvèt te saj mé 26 nyja; 2) Emerlm' i Dhiamandi Tarpos per arketar, ne vend te Spiro Markos, qe dha dorehéqjén; 3) Emerimin è Thimi Markos ne Komitèt, ne vend te André Jovanit q'u hoq vèhte; 4) Emerimin è Thanas Haritos, Thimi Marko đhè V, Dodani, qe te shtypin Dheshkronjen đhé Fizikoistorine, si t'é gjéjne mire. Edhé mblèđhjét é permuajshmé qe me 1 Janar 1888

*Komiteti*

(Pasojne èmerat dhè vula)

Me 23 Shen-Endré 1888 u mbloth komitèti i shoqerise «Dituria» i ftuar nga Sotir Tarpo, nje nga shoket è shoqerise, đhé ky i jép fjalen qe shtypeshkronja é cila gjéndéshé ne apartaménton é tij, str. Polițiéi No. 9, sot per néser, ka per te mbétur per nga héra pa qira sa te jéne névojat. Komitéti i falét mè ndér dhé i déklaron sé sot per sot s'ka fuqi te punonje gjér te mblidhèn ndihma.

Sotir Tarpua ju proponoj qe ay é leshon vendin mè qira ne punerat é tij, mé kondita qe ne vend te paguanje qira te punoje punera per shoqerine. Komitéti é pranoj kete gje dhé è fuqizoj Viske Dodanin dhé Thanas Hariton, qe t'ja japin mé invéntar shtypesh-

KOSTAQ DURO

Nje nga diréket é shoqerivét shqipetaré ishtè dhè i ndyèri Kostaq Duro-Drènova (Korçe). Mik i pa-ndare mé Vangjo Gjéçon dhè Vasil Terpon. Bur' i matur dh'i urte. Bashke mè gjèrinjt' è 'ti: Erakli Duro, Thèodor Duro, Thèmél Duro, Mihallaq Eftimiu, Llazar Duro, Vellazeria Llasko Dogani, Zisu Vasiliu, Eftim Emanoili, Vellazeria Marinka, Kostantin Nauméskuu (Raci), Nikolla Tabaçi, Ilié Mingu, ètj. Te gjithe njères mè rendesire, mé promotore shpirt' ndriturit Konstantin Eftimiu dhè Spiraq Eftimiu bégatosne shoqerite shqipetarè per qellimèt te shénta.

Kostaq Duro kishté qene kryètar i shoqerise «Dituria». I paéharuar qofte èmeri i ti.

BKSH

ERAKLI DURO DRÉNOVA (Korçe)

Trégetar mé fame. Kíshté nxjére me shume sherbetore zoterínj me véhté. Burr' i urte dh' i dashur neper shqípetaret trègetare, hyrí ne shoqeríne kombjaré mè shume shoke, dhè posí i ungjí i 'tí Kostaqí ka qene nenekryés i shoqeríse dhè mè rendesín' è 'tí ka ndíhur ne mbaresín' è çeshtjes kombjaré. Eshte dhé mírebenjes i Korçes.

Qofte émer i 'tí i pa haruar!

BKSH

52 III

DOKTOR GJORGJI ADAMIDHI

Ne kohen kur nde Paris pritéshin fatét é Kombévét, nde Génévé ishin mblédhur paresia é Shqiperise, réfuxhatet. Atjé ndodhéshé pé vjétésh dhé z. Dr. Adamidhi, nje shqipetar luftetar i zjarte, qe kishté njétash létre kembimé mé mua qe kur délté «Shqiperia» nde Bukurésht.

Me 1915 kur vajta dhé une nde Gjénéve Dr. Adamidhi u be i pari shkaketar dhé kujdésetar te fillohét nje komitét i réfuxhatevét nga paresia shqipetaré qe ndodhéshin atjé, per te punuar per rilindjén é kombit shqipetar. Réfuxhatet ishin: Turhan Pasha, Syrja Vlora, Néshét Pasha Ymér Vrioni, Hasan Taksim Pasha Genéralli, Dr. Adamidi. V. Dodani, Major Ekrém Libohova. Qémal Tahiri, Naum Sotiri Pogradéci, Dr. Xhévat Mérushi, Gabril Iatru, B. Zografi, Véhip Gjérgjani, Harif Dima, Ahmét Dinua dhé Qèmal Taksimi.

Nga te gjithe keta, z. Dr. Adamidi, si vendes m'i vjètre atjé, m'i njohur, po dhé m'i papertuar, pas mua eshte njériu qe ndihu pa mase te perparonje deshir' é te gjithevé. Mik mé Engléze mé Amérikane njéres te medhénj, mé te fameshmin gllosollog Z. Pithar vendes, te gjithe filloshqipetare, Dr. Adamidhi ka sherbyér çéshtjén shéntoré plotesisht.

Si u fillua «Komitéti Kombjar Shqipetar nde Gjénève», u zgjolh Présidént Turhan-Pasha dhé nenekryés z. Dr. Adamidhi, sékrétar V. Dodani dhé shoke ata qe thame. U dergua i pari Apél né Baron Sonino mé luturi te jape urdher per te qendruar ushteria italiané ne Shqiperi dhé te perfaqesonje Shqiperine ne Kongrés te paqés nde Paris. Tere keto vépera jane publikuar né zhurnalli i Romes «Kuvendi» No. 20, me 1918 Nentor. Si vajti Turhani nde Paris tere bara é levizjès i mbét Dr. Adamidhit.

Tani Komitéti mé doren dhé mundimèt é Dr. Adamidhit ka shkruar né Wilsoni, né Lord Lloyd George, Georges Clémenceau, Take Ionescu, luturira te posaçmé, bashke mé «Annexe Historique», «Annexe Anthropologique, Ethnografique et Statistique», ne gjuhen frengjishté dhé énglishté, per révéndikimét é Shtétit shqipetar, vépra te cilat i mbanj ne kopjé per t'i lene ne Bibliotéke te Shtétit per te arthmén ne mos me lente shorta t'i shtyp ne biblle.

Dr. Gjorgji Adamidhi ka punuar, dhé desheronj te kujtohét émer i 'ti per jéte.

BKSH

kronjen dhé te perkujdésén per te shtypur ç'do qe t'è gjèjne ata mire per kombin.

*Komiteti*

(Pasojne èmerat dhé vula)

Me 5 Maj 1888, shoqeria «Dituria» ne sallon te Sotir Tarpos u mbloth dhé bisédovi çèshtjén è darovcs qe kish bere mè dhiate, shpirt ndrituri Gligor Nukua (nde Egjipte) per te u perhapur gjuha shqip ne shkollat è Korçes, dykè lene tri véta te èmeruar: Vasil Kota, Mita Harizi dhé Nuçi Pilati. Mblèdhja è gjèti per mire qe per kete çèshtjè te luqizonje Anastas Avramidhiu èdhè Konst Eftimin, qe ata t'i perkujdèsèn kesaj punè. Me kete ngaje mblèdhja è shoqerise «Dituria» zgjodhi per kryés te ndérit Avramidhi Lakçen dhé per shok te ndèrit Konst. Eftimiun.

*Komiteti*

(Pason vula dhè èmerat è komitétit)

*Janar 30, 1889*

DEFTIM

Shoqeria Shqipetarè «Dituria» sot 30 Janar 1889, pati mblèdhjén é saj ne shtepi te z. Sotir Tarpo, str. Poliţiei No. 9. dh'u veshtruan llogarit' é motit pas statutes nyjat 14 dhè 17 dhé u gjétne te mira mblédbur édhè gjithe te prishurat:

| | | |
|---|---|---|
| Ndihmat é pergjitheshmé | lei | 2185 — |
| U shtua édhé suma nga é qena | » | 242.50 |
| | lei | 2427.50 |
| U prishne per qèllimèt é shoq. | » | 2407.50 |
| | | 20.— |

Pastaj u zgjoth komiteti i ri pas statutèvé, pervéç kryétarit i cili eshte zgjèdhur per tri vjèt, èdhè jane:

Kryest Kostaq Duro, nenekryest Thanas Haritoj shkronjes: Visar Dodani dhè G. Gèçua; shoke: Gjergj

Théodoru, Vasil Terpo, Erakli Duro, Dhionis Mihail, Vangjèl Ançé dhè Mihallaq Qirica.

*Komiteti*

(Pason vula dhè neneshkrimét)

NJE ADRÈSE NGA SHOQERIA

*Bukurésht 4 Mai 1896*

*Zoterise tyré*

*VisarionA. Dodani, Gjérgj Mano dhé Gjérgj Gjéço*

*Ketu*

*Zoterinj shoke,*

Komitèti i shoqerise «Dituria» ne mblèdhjén te permuajshmè me 26 te Prillit, shartoj qe te shtype Omére, te perkthyèr literen A.

Pas nyjes 30 te statutit, marim ndère te ju perparojme doreshkronjen qe t'é veshtroni édhè z.-tuaj, édh' u lutémi te n'a pergjigji mé nje perçiaqjé qe duhét te beni siç thote statuti.

Pritni, u lutémi ndère q'u pastrojme.

*Kryési, Pandéli I. Vangjéli*

*Me 8 Shkurt 1890*

Shoqeria «Dituria» pati mblèdhjén è permoçmé ku u pane llogarit' é te ardhuravèt dhé te prishurat per qellimin qe ndjék shoqeria édhè u gjétne te mira perdorur.

Mbétne ne arke te shoqerise lèi 140.45

Pastaj pas nyjat è statutes 14 dhé 17, u zgjoth komitètit kryes: Kostaq Duro; nenekryés: Th. Harito; arketar: Dhiam. Tarpo; shkronjes: Visar Dodani dhé Gj. Gjeço; shoket Gj. Théodoru, V. Tarpo, Eftim Emanoil, Erakli Duro, Dhim. Nikollau dhè M. Qirica.

U shartua te shtypét nje Abédaré shqip mè dielèktin gégenisht dhé nje statut ne gjuhen shqip, i atille si eshte ne gjuhen romenishtè, mè nje ndryshim

PANDELI EVANGJELI — KORÇA

Ne ngjizjén é ne fillimin te levizjès kombjaré Pandèli Evangjèli nuku mundi te mare pjése, sè ndodhèshé jashte Bukuréshtit nde Buçumén: po pas katr' a pèse vjèç kur ardhi ne Bukurèsht hyri ne shoqerite mé énthusiasme te flakte dhé u zgjoth Nenekryés i komitétévé. Haraktér i urte, i duruar, i ndèrçme, gojembel, i papertuar, ben qe te jète i dashur nga gjithe kollonia shqipetarè è Bukuréshtit. Kujdéstar i math per perparimin é çeshtjés shentorè gjèr dhé mè thèroresi, I mesuar, i matur, ky burre ketu ne Bukurésht nuku beri dot as-nje armik. Kombetar i zgjédhur. Kollonia shqipetarè é Bukurèshtit è zgjodhi perfaqesonjesin é saj dh'è dergoj ne kongrès te Parisit. Si u mbarua lufta dh'u prè fat' i Shqiperise vajti atjé dh'ariu Ministre, Kryéminister, Kryés i Sènatit, dhé si u prish Sènati, sot eshte Kryès i Kamères. Ne kohe te Princ Widit ish prèfèkt i Korçes.

BKSH

vétem qe ata shqipetare qe duan te jéne pasketaj shoke ne shoqeríne tone „Dituria», mund te hyjne dhè pă bere kerkimne mé te shkrojtur te komitètit, po hatín te jène truhur nga dy shoke pè te komitétit dhè te pranuar nga komitèti mè majoritét.

*Komiteti*

(Pason vula dhé neneshkrimèt e shokevè qe u ndodhe)

## VDEKJA DHE VARIMI I A. LAKÇES

Gjer me kete kohe, 1890, shoqería «Dituria» punonté, po mé shume pertèse (si é ka zakon shqipetari) dhè me shume kur shikonin sé shkolla u hapne, vivlla u-shtypne, kriz' é madhè ne trégeri ardhi, kundreshtimé nga te papuneshmit é nga zuzaret dèlnine dal-nga-dal, shoqería po bijé pa-mèt ne gjume. Po ne Shqiperi lufta kombjarè po shtohèshé kuntra grèkomanevèt. Deshir' è shenjte po renjosèt ne per shqipetaret kristian' é musulmane; me disa visé u filluan kllub' é vellazeri midis tyrè dhé çvillimi kombjar perparonté kaqé sa vuri ne kujdési komshinjte, te cilet bejne kallezimé, ca te vertèta, po me shume çpifje, ne guvèrnantet, te cilet silleshin kaq kèq sa ata véte ndihne qe te sqohèn dhè musulmanet é te lidhèn vellaj mè vellane è te degjojne mè mê shume vullnèse keshillat è te ndriturvèt béje, qe dergohéshin nga Konstantinopoja, se pari per letrature, udhehéqesen è shpetimit dhe lirimit nga tirania é huaj...

Me 1894 vdiq ne Bukuréshț Anastas Avramidhi Lakçè nje nga te paret shoke mé rendesire qe na sherbéjti te fillojme shoqerite lètrarishtè mè léhtesire, Po édhé qe kur lengontè çfaqi deshiren, qe kurm'i tij te mbulohét ne Korçé, atjè ku u lind. Per kete fakt therèt Vasil Terpon, Konst. Eftimiun dhè mua, édhè si na kallezon deshiren è tij te fundmén per mbulimin é kurmit te tij, na la njezèt è tré mije léi qe te paguajme mjèkun q'è kerkontè dhè q'è ballsamosi, Pétrini Paul, qishen ketu, Shen Gjèrgjin, Episkopet, dhèspotet, kupèurat dhè trasurat q'é percuall gjér ne „Gara dè Nord« njèr'ne qe è pásontè gjér ne Korçe dhé komisionin é

shoqerise «d'Expèdions». Pune qe ju be mè nje ndér te math gjér ne Korce, si é méritonté. Korça njetash è dinte kete ngjame.

Po kur na vjèn nje télègram nga Korça dhè na thone qe t'è mbajme ketu ne Bukurèsht lipsane, gjèr sa te marim nje létre prèj Kristaq Nikos, Jovan Manços édhé Nastas Racit.

Ketu né i kishim bere tere prégatitjèt, pune qe nuku munt te menohéshè as nje dite me von dhè derguam nje lèfre mè te shpèjte.

*Bukuresht 26 1894*

*Të ndérçem bashkatdhétare z.z. Kristaq Niko, Jovan Mano dhe Nastas Raci*

Muarme tèlègramen te z-tuaj, mè ane te se cilese na lajmeroni qe te mbajme kufomen é te lumturit Avramidhi, gjèr sa te marim dhè nga z-tuaj nje lètre mé vèhté per né. Mire do qè te mos i kishim bere gati ato qe lipséshin bere per te derguar te vdèkurin, pa marc téjskronjen é z-tuaj, dhè te mos e kishim lajmeruar neper zhurnalèt qe *me gjashte te Shkurtit do te behét percjéllja é lipsanit.* Ashtu ato qe na mesoni si te bejme, jane te tèpera. Ndegjojme mé te ardhur kèq shume, qe disa atdhètare te mare-vésh mè musulmane, per turp te memedhèut dhè per dem te perjéteshmè te fatkéqés atdhèjès do te perpiqén qe mè ane te guvèrnes otomané, te mos è lène te mbulohèt i vdèkuri ne te dashurin te tij atdhèjè. Nuku mbésojme te jéte nje kaq é madhè ligesi dhè qèneri neper atdhétaret t'ane, po mé qene qe nje é ketille perhapjè frikeson ç'do bashkatdhétar, muarm kujdés te pyèsim dhè te vertètohémi goja-gojes nga ambasad' è guvérnit otoman, i cili na siguroj, sé te tille panjèrezìresi nuk do te ngjasin ne shtètin otoman, si as nde ndonje shtét te qytéteruar. Kesish pra ju bejme te njohur qe me gjashte te Skurtit, do te dergojme kurmin è te lumturit, dyké é pasuar mé Kristo Proton dhè te nipne

JASHAR EREBARA

Ishtè nje djale i ri, shqipetar nga Dibra, ardhur nde Bukurèsht te mbaronje shtudimét nde Univèrsitét te Bukuréshtit ne kohen kur shqipetaret é Bukuréshtit ndodhèshin ne deshirat te shènteta per te filluar litèraturen dhė qytéterimin è kombit shqipetar.

N'ate kohe fatndjéku N. Naçua njétash kish arire mé dhélperin' é ti te hapnje nje shkolle mé èmerin «Shkolla Normalé Albanèzé» ne piaca Amzi. Atjé na vèté dhè Jashari mè Léhoven dhé Dérvish Hima qe te fléne pa te paguajne qira, èdhè ca me shume atjè gjénin kur è kur dhé ndo-nje gjèlle. Te tré keta shtudènte pikasin sè mè kete shkolle, i zoti héq nga 800 Napolona nga Shtéti Rumun qe te ndihe Shqipetaret ne mesimé si Shtèt gjithenje dashamires i Shqipetarevét.



JASHAR ERBARA

Ishtë një djalë i ri, shqipëtar nga Dibra, ardhur ndë Bukuréshti të mbarojnë shtudimet ndë Univérsitet të Bukuréshtit në kohën kur shqipëtarët é Bukuréshtit ndodhéshin në dëshirat të shënjta për të filluar literaturën dhe qytetërimin é kombit shqipëtar.

N'atë kohë ndodhéshe N. Naqua njëtash, kish arrë ndë dhëlqesiaj é të të hapnje një shkollë më emërin «Shkolla Normalé Albanézé» në piaca Amzi. Atje na vétë edhé Jashari më Léhoven dhé Dérvish Hima që të llonë pa të paguajnë qirá, edhé ca më shumë atjé gjéndin kur é kur dhé ndo-një gjéllë. Të tré këta shtudénte pikasin së më këtë shkollë, i zuri héq nga 800 Napoléona nga Shtéti Rumun që të ndihë Shqipëtarët në mësimé si Shtét gjithënjë dashamirës i Shqipëtarëvet.

BKSH

Dhionis Nasèn dhè pas njezét dit mbésojme te arinjc ne qytétne t'one Korçe. Aty é dime qe bashkatdhé-tarет do te bejne détyren mè tèperice dréjt nje atdhé-tari te ralle é te vètem te kohes s'one, i cili s'u gezua mè as nje tjater gezim, per vèç qellimit te shénjte te jètes, i dobishme per atdhéthin' é tij per gjérinjte dhé bashkatdhétaret, pastaj édhé per vendin ku i fitoj bégatite.

E mballsamosura é kurmit u be pas sistéméyé te réa. Mjèku zotohèt mé te shkrojture te èvrakèvé qe vine pas te vdékurit, qe kurre ndonjére nuk do te mbanje ére lipsani, per andaj dhame édhé dhjéte mije frenga; ashtu qe s'mbétét me dyje, sé do te kudsoje njèri te kerkonje no nje ngaje a te méte.

Lè te dihèt dhè kejo, qe i lumturi mè nje te shtuar qe beri me 16 Noèmbriè 1893, ne dhiaten è tij ka pajtuar tere trashegimtaret te çperblihèn nga demét q'i gjèn nga bonurat te réma te Grèqise.

Dykè desheruar qe dhè te tjère te perngjasin te ndyérit ne mirc-beresirat è ti, mbarojme kete létre mè ç'do qe duhèt per mè u sjèlle bashkevellèzervèt tane.

*V. H. Tarpo, K. Eftimi, V. Dodani*

BKsh

## KAPTINA VI

# NGA ARRESIMI NE KRYENGRITJE

Qe me 1881 qe kur u fillua nde Bukurèsht è para shoqeri per létratyre ne gjuhene shqipè nen'émerin «Dèg' è shoqerise Stambollit». è gjèr me 1895, kaqè ketu ne Bukurèsht si dhè ne Shqiperi dhé ne tere qytètét ku rrojne shqipetare ne Europe, n'Amèrike è gjètke, ndjénjat kombjaré te popullit shqipetar u rèthuan ne nje mbaresi te mrékullshmé. Vellazeria midis shqipetarevè musulmane è te krishtère, njetash zuri rrenja te thèlla dhè événimèntat te perjashtmè bashke mè tiranite te halldupévé perbrençme i forcojten kaqè me shume shqipetaret, sa zjari çfryvi ne Ipék, Dzakove, Prizrén, Guzina, Karllkadét, Prishtine dhé ne gjithe anet. Kllubèt dhè shoqerite per létrature ne Shqiperi u kthyèn ne shoqeri te mfshèta révollucionarè. Me te gjitha anet, levizjè kryèngritesè. Guvérna otomané dergontè njéres shume mé prémtimè te rèformavé, disa te zène krènaret è degjuare—bujaret é vendit—dhé disavè pè tyré u épté shkalla te larta neper visè lark qytétit tyrè, po te cilat nuk ishin tjater pervéç surgjynè. Keshtu zuri Fuat bène nga Fulipradó, Husén béne nga Paramithèa, nga famili è Dinojvè, Marko Gjone, Kajmékam i Mirditevé nga Oroshi, Murat bèj Toptane nga

## ALO-BÉ DISHNICA-KORÇA

I ndyéri Alo-bè Dishnica nga héra ka qene mik i dashur i Korçes. Burre trim mé ment shume, finak, i urte dhé mik i pa ndare mè vellézerit shqipetare kristiane. Ne kohe te zjarit me 1879 dhé ne kohera te andartevè kur Bèktashi dhé Nèxhipi kishine nder ment mè shoqt' é tyré dhè donin ta benin plaçke Kozçen, ish i ndyèri Alo qe na shpetoj Korçen. Ne évollucionin é shqipetarismes ish ay dhè i ndyéri Orhan Çérçis-bèu mé Kapobéjne qe ruhanin kombetaret korçare nga furrja è grèkomanevét. Andaj me shkruanté Thimiu ne létre «Visar, mos me ki kujdésne mua sé me ruajne si te dy syte burat é fuqishme». Keta ishin te dy burrat: shpirt ndriturit Alo béj Dishnica dhé Orhan Çérçis-bèj te cilit me shkruanin è me épnin kurajo.

Ndjèse paçin dhé kujtim te perjétshem

BKSH

BKSH

Tirana, te birin é Said Topjes, Dérvish bèjne—te bir' è Jusuf bè Elbasanit, Mulla Zèken nga fshati Krajnía qe ngriti flamurin è lirise ne Ipèk, é te tjéret—dhé i ben te gjithe syrgjyn. Riza bé Dzakova çpall nje prokllamate dykè deftyèr sè «turku na vé te vritémi vètem per 'te, por ndonje miresi per Shqiperine s'kujtohét».

Shtypi i Europes po kallezontè si shqipetaret po ngrihén kunder qévérise otomanè. «La nazione albanèsè» deftèn te kèqiat qe hèq kombi shqipetar nga turqit. Dé Rada, Ansèlmo Lorèchio, ngrèhin zene dykè tréguar vojtjèt te pa mbarueshmé te popullit...

## ZHURNALI «SHQIPERIA»

Mbi keto é siper, Bukuréshti qe ngriti kete Flamur se pari per shoqeri létratyré, tani mèndohét—dykè pare sè zjari u ndès bréndа ne Shqiperi— sè esht nèvoja te ngrère dhé ketu flamurin é kryèngritjés dykè qitur piksepari dhé nje zhurnal. Po qe zhurnali te muntnje te flase pa pike drojè é te kallezoje tere te keqiat qe héq populli shqipetar nga tirania è turqvèt dhé nga gjithe armiqte qe na rèthojne, duhéshé te shkruhèshè nga nje njéri vendes, qe munt te flase pa friken è qévérise rumunè, è cila munt t'è ndalontè zhurnalle dhè rèdaktor è tij me njezét é kater ore t'a nxirtè jashte kufise rumunè.

Keshtu pra me 1895, mora te drèjtat civilé dhè politiké nga Dhoma é Sénati Rumun èdhé u bera neneshtètas i vendit. Me njane vivlla po dergonim ne Korçe né Iovan Kosturi, i cili i perndanté dhuretisht neper tere Shqiperine, me tjater ane te tjèra vivlla po shtypshin nga shoqeria «Dituria» te cilen é kryèsonin shqipetare te flakte si Kostaq Duro, Kristaq Naumi, Thanas Haritua, Thoma Çami dhé me ne fund, Pandèli Evangjéli, burre i urte, dhé zèmergjere. U kupetuam pra te nxjèrim nje zhurnal kombetar révollucionar, i cili te largohét nga shoqeria lètrarè qe te mos persyshén shoket è shoqerise «Dituria» te cilet kishin familjèt é tyrè ne Turqi. Ky zhurnal u quajt «Shqiperia» dréjtimin é mora une

dhé è çpallnja mè te hollat é mija, dyké patur dhé ndihmes mè page Gjérgj Méksin disa kohe nde perkthimét é allbanollogevé érudite si M. dé Vogue, Luis Béaloéw étj. si dhé nga fare faresh lajmé.

## SHTYPI SHQIPETAR DHE LEVIZJA KOMBETARE

Ne kete hop kohè, n'Itali njetash ishin çpallur zhurnale kombjaré nga shqipetaret é Italise, konstitujuar ne shoqerira lètratyrè dhè révollucionarè, ku shkruanin bura te çkelqyér si Girolamo dé Rada, Ansèlmo Lorècchio, G. Konforti, Giuseppe Schirro, étj. mè te cilet kam patur létre-kembimè te gjate, te cilet bene te dijén n'Evrope, deshirat te popullit shqipetar dhé te kèqiat qe po héq ky popull nga tirania turkè.

Kur po ngjasin keto levjzjé, me 1897 béfas ne Bruksèlés çkrèp nje rèviste è permuajshmè mé émerin «Albania» shkruar ne gjuhe shqip è frengjisht, dhé ne No. 2 «Varia» te kesaj réviste u duk si ne pasqyre dliresi é shpirtit te rèdaktorit saj.

Ky zoteni, i cili çvjell tani fjamur' é kryengriljés çiltash nene émerin Frank Spiro Bég, ishté Faik Konica; i pari musulman qe kuxoj te bertase: «Vellézer musulmane, hiqni dore nga turku! Né jèmi shqipetare musulmane, nuku jemi turq. Sulltani eshte kusar» étj...

Pra, buri qe na shtoj kurajon te çpallim dhé né zhurnalle «Shqiperia», ketu ne Bukurèsht, ku eshte mburimi i létratures kombjaré, ishté ky zoteni, mé te cilin nisa nje léter kembim te gjate dhé te çilte, si do te dukèt me poshte.

Te tria keto dijetare: «La nazioné albanese» nd' Itali, «Albania» nde Bruksél dhè «Shqiperia» ne Bukurésht, u çéle zémrat e djégura te shqipetarevé, ne Shqiperi dhé kudo, dhé kllubèt è shoqerite per létrature tani kthéhén ne qellimin è kryéngritjévét dhè ne vellèzerin' é kombit, gati te çfryjne kuntre tiranise. Ndihma po mblidhéshin ne shoqerite per révollucién brenda dhè jashte ; zhurnalet «Revue d'Orient» nga Buda-Pesta, „Itti fak» nga Sofia, po kallezojne n'Eu-

## JANI MIHAIL LÉHOVA

Nje nga te vjétrit ushtare bésnike rotull luftarevét per rilindjén é kombit shqipetar eshte dhé Jani Léhova. Me nje kohe kur fatndjékesi dhé gjakpiresi Naço, per te genjyér shtétin rumun, beri nje pséfto-shkolle mé émerin «Shkolle Normalle Albanéze» dhe hiqté nga 800 napolona ar ne mot. Jani Léhova mé Jashar Erébaren dhè Dérvish Himen pikasne mé hidhérim shpirti sé kejo sharllatani do te goditnje ne ndére é kollonise shqipetaré per te cilen Romania s'la te méte dyké ndihmuar. Jani Léhova mé ane te Taçit é kallezoj ne Dr. Léonti, qe nuk ékziston as nje «Shkolle Albanéze Normale» pervéc sé nje fare asil (Téqé) per te fjétur pléqte dhé tri studénte qe msojne ne Univérsitèt. Keshtu u zbulua fajtor vétem fatndjékesi dhé shpetoj tere kollonia. Dhé kur u çpall «Shqiperia» mé artikulla kryéngritesè dy bashkepunetore kisha te pa ndare, Jorgo Méksin dhé Jani Léhoven, i cili pa frike neneshkruanté émerin çiltash. Jani Léhova, plot kurajo i pa kursyér ka shètttur Shqiperine dhé gjétke vétem te harinje qellimn' é shènjte. Léhova i pa lodhur, i flakte kombetar ka prishur te fundin dyshke te çpallnje nje zhurnall kombetar mé émerin «Atdhéu» dhé ishté i pari qe kerkonté ne zhurnall Princ Wiede per mbrét ne Shqiperi. Punetor dh'i-duruar shume mesojti dréjtesine (avokat) dhé ron si i tille ne Dobroxhe Méxhidié, shume modést ne vent te jéte ne atdhéjen é ti, qe leftoj per te dhé q'i ka hijé! Dy bésnike bashkeluftare kisha, Jorgo Méksin dhé Léhoven. Te dy te haruar, kur te tjére u çperblyén mé téperice!

IRONI E SHORTES!!!

BKSH

BKSH



JORGO MÉKSI

Jorgo Mèksi me te shumen kohe te djalerise se tij è ka shkuar nde Athine, ku ka mbaruar mesimét dhè si specialitét xhurnalistiken. Kur degjoj sè nde Bukurésht po gatuhét rilindj' é kunorès se Atdhéjes se ti Shqiperise, u sul nde Bukurésht dhé shkruantè ne gazéten gerqishté «Patris» gjèr sa beri njoftim mé shqipetaret édhè hyri ne zhurnalli «Shqiperia» bashkepunetor per idèalle shentor aqè per litèrature sa dhé per shpetimin è kombit.

Njoftimin qe beri «Shqiperia» mé fillolloget te fameshme si Louis Benloew, E. M. De Voguė étj, shkaketar i pari qé J. Mèksi. Bésnik i palodhur mè shprésa te sukçésit Méksi benté dhè administraten è gazétes s'imè «Shqiperia».

Me 1917 kur Gjirokastra ish ne dore te italianevèt Jorgo Méksi patriot i flakte fjalosėt mè z. Gaban dhé Maior Loti mé zèmer filloitalianė per te miren è tere Ballkanit.
Me 1919 bashke mé Léhoven dhè Myfitne ka shkruar né Wilsoni; mé nje fjale Jorgo Méksi ka punuar tere jèten per rilindjèn è Shqiperise. Dy bashkepunetore trima pata ne zhurnalle tim kryéngrites, po as nje nuk u çperblyè faré. Ironi é shortit! Méksi dhé Léhova vuajne!

BKSH

BKSH

rope qe shqipetaret jane gati te ngrihèn dhè keshillojne Turqine te mare masa te forta per te shuar zjare mê perpara. Turqit è rinj i trazuan punet éndè mê shume; serbet, bullgaret dhé grèket, qe shpréhnin te ritéshin nga kuriz' i Shqiqerise, po mèrén vésh midis tyrè t'i bijen Turqise, gjoha; po Italise dhè Austrise (Iugosllave) nuku u jéptè dore qe te bjére Shqiperia ne Grèqi, a ne Serbi, a ne Italia nga shkaku i Adriatikut; te dy aliatet é medhènj, Austria dh'Italia i nxjerin méndimét é fshéhta ne faqè, dhé thane, qe Shqiperia duhét bere me véhté, pa munt te jéte bésnikeri é vertéte midis tyré, édhe kjo gje édhé sikur te mos ishté Shqiperia, po kur ajo ékziston?!

Pastaj donin qe te dy dhipllomatirat te lithnin prinsipaten Maqédhoni pas Mbrèterise Shqipetarè q'i dhane mbrétin Wièd.

Kur po gatuèshin keto shartimé midis dhipllomatise t'aliatevé Itali é Austri, serbet, bullgaret dhé gréket, ahéré shpétohèn dhé pajtohén midis tyré dhé nisin luften kundré Turqise, po me tjatre ane shpirtndrituri Ismail Vlora, po baristé qe me nje shtét ne tjatre t'Europes, posi mbléta neper lulèt qe te thethinje embelsiren é te benje mjalten, dhé, po mblithtè prémtimé nga shtétèt è medha per shpetimin è Atdhèut se ti, Shqiperise, dhé me 28 Nentor 1912 mé shqipetaret te prègatitur, é *ngriti flamurin é lirise ne Vlore*.

I pa vdékur qofte émer' i ti!! ..

## MIDHAT FRASHERI DHE ÇESHTJA E SHKRONIAVE

Kur po perhapéj «Shqiperia» neper bote, me 28 Korrik 1897 mar nje létre nga Knnstantinopoja pré M. A. F. (Midhat Frasherit) é cila thote:

*Zoti V. Dodani*

*Bukuresht*

Mè gas è mè hélm te math pame è kenduam disa numura te «Shqiperia». U gezuam qe dolli èdhè nje flète shqip, aqè mê shume sa pandèhèshé sè do te diltè mé shkro-

njat qe jane aqè te bukura. Po s'mund te kupetojme çudine dhé hélmin qe ndjéjme dykè pare qe jane mé ca shkronja qe, vèç mos pyèt.

Nuk è marim vésh qe dhé nje fléte qe dolli, psé te dale mè ca shkronja qe as djalli s'i kendon dot. Dukè pasur plaçken t'one muarme te botese, q'eshte m'é shemtuare nje mij hére sè ngaj jona. Né po na vintè rende qe «Albania» dolli mé shkronja te huaja, po thoshim q'é beri ngaj è kèqja, po «Shqiperia» ç'djall ka? Ndodheshé ne *miné* te florinte dhé mori balte: Çudi, çudi!

Dykè pare qe flèta shkruhèt bukur na èrth akoma mê shume liksht per diamane mè rèth te plumbte! Zoteni, kejo fléte thèmi sè mund te na prishinj pune, sé vèç qe s'è kendon njeri, po shqipetaret kane per te thene: a po dita per dita shkronja te ra kane per te dale? te tjèra te vivllave, te tjéra te ditarevè èdhè keshtu shume njéres zémer ljépure jane per te ftohur nga né. Pa lé qe gréku, vllahu, serbi étj. do te thone duké pervéshur buzet: «Oh, shqipetaret sa te mençme jane, sa dita per dita shkronjat po i ndrojne». Kam degjuar per zotesine t'endè qe jé memedhétar mè shpirt è mé zèmer, kjo na hélmon ma téper!

Oh, sa na kish per te hyre ne pune «Shqiperia» sikur te shkruhéshé: «'qiperia»; sa propagande do te mundtnim te ben'n! sa mendjè do te zgjuantè, sa zémra do te ndisté, sa memedhétare te vertète do te pillté. Kemi shume shprèse, zoteni, qe per se shpèjti kini per te nderuar shkonjat, mé qene qe é mèrni vèsh vète miresine qe do te punoni ne komb te bèkuar t'one.

Kam shprèse te madhé nga nje memedhètar si z-joté qe per s'aferti te m'apç siharigne te pa çmuare te keti ndryshimi.

Armiqte kane gjetur tradhetore ne mès t'one é i kane vene qe te na prishin pune, po prape thomi sè do te kupetosh dhèlperite é do te ndahèsh nga te tijte njéres te rézikte. Ungjit è mij dhé as njeri ketu nuku

è kendon ate flète pa dale mè shkonja shqip as njerí nuk é zé mè dore sé jèmi shqipetare é jo vllèh...

Te falèm mé shendét

*M. A. F.*

nga komitéja é shqípès

Adrèsa : M-me Julie Marius
Poste-restante
Au bureau Allemend
K-ple

BKSH

## NJE LETER NGA THIMI MARKUA

Pas kesaj lètré mar dhe nje tjater qe nga Korça préj Th. Markos :

*20 Vjésht é I-re 1897*

*Miku im i dashur dhé krushk z. V. Dodani*

Lètren te z-satè pè 8 keti muaji é mora dhè u gezuash per punete dhé sherbiméte qe beni. U lumte è Zoti u dhente gjithe te mirate qe u do zémra. Kombi do t'u jéte nde-ne barre dhè èmerat do t'ua shkruanje ne faqè te pare te Istorise, mé shkronja te arta, per sherbimét qe beni te dale nga hèresira è padijesè. Gezonémi me shume sè shohim qe dhé njerese te huaje perkujdésén si shpirt mire qé jane, te é nxjérim nga héresira é padijesé kombin tone te mjérin dhé ahèré pa ndushim faqézinjte grèkomanet do pushojne te luftuarat è tyré. Per mesonjesit qe do dergonène, jèmi gezuar gjèr ne shpirt per te ardhurit é tyré ; pervéç ne Korçe gjétke nuk dime ku eshte me mire. Sot per sot gjétke nuku eshte hapur mesonjetoré shqip, pervéç ketu si è dini. Sa per te priturit èdhè te sjéllate tona mé 'ta, mos kini frike sè do mos priten, por do te jène te kenaqure nga te gjitha ; véteme nje gje duhéte dhé eshte nèvoje è madhè te kéne ata zoterinj ; lipsét te kene léjé nga guvérna turkè qe te mos i

shohe mé sy te lik as ata, as névé, te mos mare shupé (ipopsi) as per 'tá as per né, sé Zoti na rrojte, ne vent qe te vejme pune te mire è prishim fare. Kejo pune duhét mèntuare shume dhé per kete lipsèt te kupetoji dhé z-tuaj mè miqte te K-pojes te cilevèt dhè nèvè u shkruam sot si te bejm qe te mos pesojme gje. Z. Visar, me shenoni qe te mos me vinje rende per literat, per sistemen é ri qe kini zene te shkruani gjuhene shqip. Une dhé tjater hère u shkrova pak. Sot u thom gjénè pak fjale, por u kerkonj ndjése, sé nuku munt te gjykonj mè mendjèn t'imé te pake punera te medha dhé te lartra. Nuku munt te thom qe qellimi· i z-suaj nuku eshte i lartere dhè i shenteruare, kete gjithe bota e di. Kaqé vétem u thom, qe eshte é vertète qe gjithe kombet kur çpikne gjuhen é tyrè mè te shkuare, sicili krèu nje sistèm mè véte per allfabètne edhé keshtu nje ane é kombit mesonté pas njerese sistème dhé tjatera pas tjatrese, gjèr sa me pastaj u mblodhe me te diturit é vune nje sistém te pergjithesh mè. Keshtu dhé shqipetaret punuan me shume sistéma nga te cilate me te shenuarat jane: sistém' i Pètro Bogdanit, i Nastas Kulluriotit, i Kristoforidhit, i Mitkos dhè i Naum Bythkuqit. Po keto sistèma ca u punuan nga fort te pake shqipetare, ca munt te thèmi nga vèteme ata te zote q'i çpikne. Fort mire è dini z-tuaj qe m'é perhapura dhè m'è thémèlosura sistéme mé te cilene jane shkruare dhè shtypure shume vivlla shqipé qe po gjéndèn u dvkè kenduar ne te gjithe shqipetaret eshte sistèm' i shoqerise «Dituria». Pas keti sistèmi eshte ngréhure èdhé mesonjetorè shqip, édhé shtypeshkronje; pas keti sistémi jane stervitur gjithe shqipetaret qe duane dhè ndérojne gjuhene shqip; mè mesimét é keti sistémi jane ujitur djèmte è Toskerise:

Fat' i Shqiperise u ndoth i ketile, qe te mundime te gjykojme qe me pare ç'sistèm eshte m'i vlére dhè m'i mire per gjuhen shqip. Sot per sot pas mendjèse tone, è mira éshte te mos kèmi te ketiila grindja, pa kur te vinje ora te mblidhène ne ate dite te shenuare

te diturit é shqipetarevèt, atèré gjithe shqipetarete do te aferonèn é do te pushtojne mé gjithe zèmere ate sistém, qe te gjykojne per te mire te mesimit. Kaqé u thom dhè u kerkonj ndjèse per keto qe flasim.

Té perqafonj vellazerisht, miku yt.

*Th. Marko*

*Bukuresht 10 Oktober 1897*

*Vellaj im Efthim Marko*

*nde Korçé*

Mora létren tuaj te 20 Vjéshtes pare dhé u ngjatjétonj per fjalet te mira qe m'i shkruani, mè urimé dhè mè levdimé. Po u lutèm ato fjale qe m'i thoni mua, ato z-saté u kâne hiè mé shume. Une benj dètyren vétem si zémerzhurte, per te shtrènten t'one atdhè, édhé è benj mé léhtesire sè ndodhém ketu ne Rumani, ne dhé te bèkuar nga Pèrendia, ku kane mare shpirt dhé te tjére kombé; po z-joté, vella Thimi, é kè çmimin è vléften me te larter. Pa ne dashte Zoti, qe te arrijme ate dite mé ato shprésa qe kishim me 1881 kur é nisme kete pune te shènteruare, tyne, Thimi vella, duhét te te shkruhèt èmeri ne faqé te istorise, sè ti durovè burerisht atjè lufterat e grèkomanevèt dhè turkomanevèt. Per mesonjesit, per librat, per gjith ato qe duhén, mos kini faré kujdés sé névè ketu punojme plot gèzim, sè shprèsat po na behèn mbésimè. Jona, mor jona!

Sa eshte fjala per literat, qe kembèva dhé mora krèjt llatinishtét, tjatre hére me shkrovè mê bute, dhé sikur me aferohèshè; po tani me shkruan me çkrèpure. Une é di mire, se qe ku vjèn kjo furtune; po, kejo furtune eshte é dobet, pa ndonje mçètke te shendoshe. Njérezit è medhènj, udhehèqesit t'ane qe na dhane kurajon t'i hyjme kesaj te shènteruarè pune, nuku é pranuan mè ende ate allfabèt, q'i thom allfabét i Stambollit; po ne ate mblèdhjè pé shtate a téte

vèta, q'u shartua te mérèt i atilli me te cilin u shtyp-ne ato dymbedhjate faresh vivlla, allfabèti ish gatuar nga plaku Vrétua njétash, i cili mè zemerim dykè shtrire te dy duart, é dyké deftyér q'ay u méndua qe mè kete fare gje do te pajtonje èdhé grèket édhé slla vet èdhè gjithe orthodhoksine, Fisniket shoke nuku déshin t'ja prishin plakut, i cili njétash ish mare vésh mé kombetaret è Misirit per kete sistème; dhé qen-druan mé ate, po vètem puna te behét. Kristoforidhi, ay papa, s'désh as aqé. Ay qèshtè mé ato; ay dèsh vétem mè gèrqishtét dhè te mbushén mè llatinishte ato q'i mungojne greqishtés. Me ne fund u be ajo qe dime dhé qe shtypme vivllat (gjat' é gjere 12 cope farèsh) te cilat gjèr é kembéva une sistèmen afro u honèpse. Shtypeshkonja, ne dore te botes, dita dites mvidhèshè dhé literat pakesohèshin dhè nuk vètem literat, po dhè vègelat, sa dhè régalèt (kutite). Duhéshè perseri shtypeshkronj' é ré; po ku?... Monopoll? Ku do qe te ndodhéshè nje shkronjetor neper Europ' a gjétke duhèj nje shtypeshkronj' é Vrétos!

Mire, z-joté thua sè «ne kete u ujitne djémt è shkollavé dhé Toskeria, dhé u stervitne, dhè keshtu duhèt te véne perpara ata qe duan èdhé qe nderojne gjuhen shqip». Mè nje fjale, o miku im i dashur, mire liksht, perpara gjér sa te dalin njèeres te ditur é te she-nuar, qe te mblidhén ata te bisèdojne édhé te marim pasendaj ate, qe te na japin ata. Me ndjé dhè z-jotè, pa te ndjénj edhe une.

Sa per vivllat qe arrine é u shtypne stambollishté dhè duhét te véme perpara *sé arrine* é u shtypne, kjo deftén qe ka te méta alfabéti, po *arrine* sè «fat' i Shqiperise qenka i ketille». Nuk eshte ashtu. Ne dasht te vèsh ne Bagdat dhè harovè pashaporten ne Buku-rèsht, nkthèu qe ne Konstance te març pashaporte; nuk duhét te vésh perpara, kur sqenkerka mire. Thoni, qe ja qe u shtypne liksh; duhèt te véme perpara?...Po sa libra kémi na? Gjérmania, Austria kane miliarda vollumé neper bibliotèkat é tyré mè litera gothishté

dhé i perkthéjne llatinishtè thjesht. Bohèmet gjithashtu, dhé s'kurséhén, po pranuan é shtypne llatinishtén dhè nèvé qe mézi shtypim nga nje vivlle te vème perpara? Tridhjet e gjashte shkonja ne koke te foshnjes!?... Pastaj pa simètri, pa bukuri, pa lèhtesire, as forme, as gjèndèn kudo te tera t'i gelltitim, vètem sè Vrétua u méntua te pajtonje orthodhoksismen? Si néser do te nisin dhe ruset è bullgaret te shkru jne llatinisht Njétash disa pè sllavet me te gdhendur nisne. Ungarete, gjindjé turanike, s'muar èlifèt, po thiésht llatinishtén; sa perpara van' ata ne qytèterim? Ebrejte shkruajne llatinisht dhé vètem per gjuhen fétarè *lushenakodisk* ruajne elfdalles, qe me te djathte me te mengjer. Por dhe keta kur t'u dale ndryshku nga koka si dhe turqit nuk do te shkruajne me shkronja llatinishte?... Ky sistem qe mora s'eshte t'imi as i tjatrit, eshte thelpi qe dolli nga llambiku i akadhéminjvèt t'Europes. Nuku mbèsonj kurre te dalin nga akadhemite é tjera forma-shkronjash, per veç sé keto qe dihen, ndofta pajtimé per te perkthyèr, po forma te tjera, jo. Çallmurke δ, kopani ϱ, murge λ, qahiçkè σ perperuge χ, pupeza g, étj.

Keto te bukura mé shoqèt è tyré po jo mè shkronja llatiné. Une mbèsonj qe llatinishtèt mbètèn per gjithe gjuherat, iéroglifet bijén si rane te tjéra mijera shkronja.

Me shkruajne dhe te tjère qe nga Stambolli si z-tuaj, po ju pergjégja mè keto argumènta. Nuku m'u zèmeruan po vètem faji qenka sé: «ja qe keshtu u nis é keshtu u mesuan bota»; pèse para s'jap me per kete. Une shikonj thémèline te shendoshe dhé vètè perpara, pa psè u zèmeruaka nje Vrèto maniak. Ç'beri ay? Nje propagande neper myslymanet pashanj é béjlère ne Misir ku dergonja gazéten «Shqiperia» dhè ay qe m'i dinté adrèsat i beri te m'i kthèjne togje-togjè te pa hapura farè, mè fjalen «rèfusée» nga tri katre hère pas shtate muaj kur u kerkova pajtimét. Po ç'beri? Une

vètè perpara sè gazéta me kerkohèt mé ndèr é mè urimè, puna me vétè, djale pa rendesira jam, si mposhtém tjatrit pa arguménta. Po ne daça qe t'i benj téligraf vrètishtè do te mérét télégrami ?

«Puno o Vϱετο, nxíto vελa, δε dígo τε kϑεσ σqípεn sε djaλí ϑínjak mbetεσ».

Thimi vella, ti me di mire, mua po te mos me mbushét mendja mire, une s'los nga t'imét. Nje Midat, nje djalosh do te me perkedhèle, qe jam i genjyér nga armiqt é kombit, qe une i kam bésuar shoke, qe te mos me thoie sé jam i shitur, ètj ?

Te puth vellazerisht

*Visar Dodani*

LERTA NGA A. KRISPI DHE L. BENLOEW

*Roma 3 e Llonarit 1897*

*I ndritshmi zot V. A. Dodani*

E mora mé te math gezim karten t'endé èdhè fléten «Shqiperia» qe me dergové, te haréstis shume, shume.

Zoti Konstantin Kastriota Skendèrbèg rri ne nje hore é kluar Lecce—Via Augosto No. 16.

Shkruata tim kusheriri z. Francèsko Krispi sa te me jip thélimin te ja dergonja fotografine è tije.

U dergova nje libre qe e shkruati gjériu im Francèsco Krispi i urte, é i dishem, qe vdiq té viti 1856 nde Palazzo Adriano hora ku gjéndét fara é Krispit.

Té te parat flète è atij vivlli ka shkrojt G. Krispi per allfabétin shqip, duajé èdhé ai ate pe do nani z. Louis Bénloéw.

Te prasmét dit te kesaj javè dua te vétè té hora ku un glèva, Palazzo Adriano (Siçilia) sa t'i puth doren memes é sa te gezohèm ça dit mé vellèzerit è mé

BKSH

## MURAT TOPTANI

Murat-béj ish djal' i Sait-bé-Topjés nga Tirana pré Familiesjse madhé ne Istori te Shqiperise. Djal' i ri 28 vjéç, i mesuar, trim mé zémer te flakte, nuku duronté te shohe atdhén é dashur ne zgjédhe tiraniké, dhè u trazua ne leviziètkombjaré. U bashkua mé Marko Gjone kapitan é Mirdites ngaj Oroshi, mé émer te math n'istori te Shqiperise se épermé, familie prinçiaré, si dhé mé Dérvish-béj Elbasane te bir' è Jusuf-bèut, i degjuar ne Shqiperin è mèsmè dhè nisne nje propapande kombjarè kaqè te rèpte, sa vune ne mèntim te frikçmè guvérnen halldupè, qe t'i zère dhé t'i humbase pa gjykuar faré.

Keshtu mè fare-faresh dhèlperi, therèsin ne hyqmèt Muratne sikursè Muhasèbèdziu ka névoje te lère disa pagèsa te iltizamit dhè Toptani vajti, po kur dontè te iktè i thane «ti jè burgosur mè urdherin è Mbrètit», dh'è suall ne Elbasan. Atjè pikasi Dèrvish bèu dhè vètè mè disa trima ne hyqmét dhè kerkon t'é leshojne mé révolvèr ne dore, po ushtaret qe é kishin sjèlle ngritne karabinat t'u bijèn. Ahèrè bimbashi therèt: mos, Sulltani i kerkon te gjalle! dhè i derguan ne largimè syrgjyn nde Tripoli ku Murat bèu ka héqur te keqiat è tmèrta. Une po gjemonjà, siç po dukèn nè Zhurnali «Shqiperia» Bukurèsht 1897 No. 27, 28, 29, 30, 40.

Kur mar nje lètre plot gas qe éngjelli i Shqiperis i lèsoj udhen te shpetonje nga burgu dhè vjèn ne Itali dhè me kerkon 10 napolona te cilat ja dergova si kundre duken nga korèspondènca qe vinin mè poshte,dukè vazhduar perkujdèsjèt è pastajmè.

Murat bèu Toptani i bir' i Tiranes, ish dhender i Naim Frasherit, ish vjèrshetor, dhe fatmiroshe nè q'è pame sè na ardhi dhé ketu ne Bukurésht bashke mè zotin Faik Konicen. Emeri i qofte perjète i kujtuar.

# MURAT TOPTANI

Murat-bej ish djal' i Sali-be-Toptes nga Tirana prë Familiesjse madhë në istori të Shqipërisë. Djal' i ri 28 vjeç, i mesuar, trim me zëmer të flakte, nuku duronte të shonë atdhen e dashur në zgjedhe tranike, dhe u trazua në levizjet kombjare. U bashkua me Marko Gjone kapitan e Mirdites ngaj Oroshi, me emer të madh n'istori te Shqipërisë se epërme, familie princ'are, si dhe me Dervish-bej Elbasane të bir' e Jusuf-beut, i degjuar në Shqipërin e mesme dhe nisne nje propapandë kombjare kaqë të repte, sa vune në mendim të frikëme guvernen halldupe, që i'i zëre dhe i'i humbase pa gjykuar fare.

Keshtu me fare-faresh dhelperi, therësin në hykmet Muratne sikurse Muhasebedaju ka nevojë te tere disa pagesa të trashmit dhe Toptani vajti, po kur donte të ikte i thane «ti je burgosur me urdherin e Mbretit», dhe s'uali në Elbasan. Atje pikasi Dervish beu dhe vete me disa trima ne hykmet dhe kerkon t'e leshojne me revolver në dore, po ushtaret qe e kishin sjelle ngritne karabinat t'u bijen. Ahere bimbashi therët: mos, Sulltani i kerkon te gja-lle i dhe i derguan ne largime syrgjyn nde Tripoli ku Murat beu ka hequr te keqiat e tmerta. Une po gjemonja, sic po duken ne Zhurnali «Shqiperia» Bukuresht 1897 No. 27, 28, 29, 30, 40.

Kur mar nje letre plot gas qe engjelli i Shqiperis i lesoj udhen te shpetonje nga burgu dhe vjen ne Itali dhe me kerkon 10 napolona te cilat ja dergova si kundre duken nga korespondenca qe vinin me poshte duke vazhduar perkujdesjet e pastajme.

Murat beu Toptani i bir' i Tiranes, ish dhender i Naim Frasherit, ish vjershetor, dhe fatmireshe me q'e pame se na ardhi dhe ketu ne Bukuresht bashke me zotin Faik Konicen. Emeri i gofte perjete i kujtuar.

BKSH



## LOUIS BENLOEW

Nje nga me te medhénjte fillolloge te Frances Z. Louis Bénloéw lindur ne Efort (Prusia), mesoj ne Univérsitétét te Bérlinit, Lipsise dhé Gottingut. Me 1839 u be vendes Francéz. Ka qene kujdéstar i bibliotékes te Sorbones, profesor dhé Dékan ne Univérsitét te Dijonit. Si Doktor fillollog ka folur shume per gjuhen shqipé mé ane te se ciles ka zgjidhur gjerera te héreta per diturit é lartra. Ishté filloshqiptar i ndézur.

Me 1897 i dergonja gazéten «Shqiperia» dhé fare faresh libra shqipé qe u shtypne ne Bukurésht nga shoqeria «Dituria» dhé hyme ne létrekembim. Z. Louis Bénloew na kallezoj sé ne Paris benét nje kongrés i Oriéntalistevé dhé na keshillonté mé shume vullnése te marim pjése dhé né shqipetaret. Qysh nèvé ketu na mungonin njéres per nje t'atille kongrés, ju lutme Zoterise Bènlloéw, i cili na é pranoj perfaqesine édhé na reprézantoj mé shume ndér. Zoti Bénloéw u prit shume mire nga an' é te diturvét, po dhé névé ne Bukurésht véte ministr' i mesimit nde France Z. Alfréd Rambaud pati miresine te na levdonje.

Z. Louis Bénloéw qoft i kujtuar ne nisjén é Istorisé Shqiperise.

BKSH

motrat é niprít timé. Rri atjè gjithe kete muaj é pa prurém Roma.

Te falém é te perqafonj mè mall vellazerisht,

*A. Krispi*

*Bukurésht 2 Korik 1897*

*I çkëlqyér z. Louis Benloéw*

*Paris*

Lét:a è z-tuaj 10 Qèrshor, na mbushi plot gezimé dhé ju ngjatjètojme per ndére qe z-tuaj na bete. Te math gezim na dhate sé létra é z-tuaj deftén qe nuku pushoni kujdesjén dh'e interéson qe po defténi sè mbani per kombin shqipetar gjér me sot. Kini shkruar, zoteni, vèpera te fameshmé, po ajo qe gezon é manit zèmerat è shqipetarevèt me shume eshte dyké leçitur per na punera qe vétem énthusiasmi dhé intèrèsi i larter qe mbani per na é kombin shqipetar u ben te ngrini larter zene. Zoteni nemna lejé t'u thémi sè jini m'i larter sé i ditur. Jini njeriu mé zèmer, jini njeridashes dhè mjèshter per popujte qe te héqin dobi nga vèperat t'uaj. Jini per né shqipetaret at é shqipetarizmes. njeriu qe na udihu ma shume nga gjithe sérislindjén é kombit t'one.

Shqiptaret lètrares do te njohen mundimét t'uaja dhé ne paçim fatne te hyjme dhé na n'udhe te qyte terimit, détyra è tyrè é pare do te jète kujtimi i éme rit t'uaj mé ndèr te math. Kenduam mé verrèjtjè keshillen qe na jép mé miredashje tuaj. Sa eshte fjala per zhurnalle t'im qe ju pelqèu dhè duhét shkruare i tere shqip dhé frengjisht, kjo munt te behét kur «Shqiperia» te behét èdhe me é njohur. Per diksionèr, gramatike dhè kristomathi do t'i veme ne pune posa qe te mundim. Mbi gjithe keto, u lutémi te m'èpni léjén t'ju bejme nje lutjè, te cilen miredashja è zakoneshmè

è z-tuaj nuku mbèsonj qe te mos è nqasnje. Na dhate nje dije qe kete vjèshte ne Paris do te mbahèt nje kongrès i Oriènṭalistevèt. Shqipetaret è Rumanise te gjithe u luten te na perfaqesosh z-jotè,

Ne eshte pune qe behèt, ne eshte sé punet è shumta ju ndjèjne te beni kete gjé per na, u lutémi shkruanani.

Ç'fare forma duhét t'u dergojme, èvraké te vèçéta apo mè ane te gazètes «Shqiperia».?

Bashke mé mirenjojtjét t'ona te separmé, u lutémi te nqasni ndère tè math qe ju mbanj, i perhunjuri i z tuaj sherbetor

*Visarion Dodani*

*Berlin, Hotel Sans Souci 8 Korik 1897*

*I shtrenti Zot,*

Shpéjtohèm t'u ngjatjétonj per ndére qe me beni dyké me émeruar perfaqesonjes t'uaj ne kongrés te Oriéntalistevét qe do te mbahét ne Paris me 5 te Vjèshtes, vétem te kini miresine neperfaqesonjen qe do me dergoni te thoni sè Shqiperia dèl dhé ajo nga Tiranet, keshtu do te kém te drèjten te mblèth é te héq verrèjtjén è Oriéntalistevè dhè mos haroni te na perméndoni disa punera istorikè, lètrarishta dhé politike qe kane te ngjare mè goditjè te mèndimévét te savantevé qe do te mblidhen ne Sorbone. Mos haroni te defténi bésimin qe kini ne ndjènjat liridashesè, gjithmone, te Frances, tere jéten doregjatesè é ndihmetaré, gjagje per çéget, udhe refénjesé dhé farefaresh qe takojne létraturen é fillollogjine, étj. Mè qe nxitohèm u lutèm te me dergoni sa te mundni gjekafsh, dhé té mi dergoni ne adrèsen é me sipermé sé ne Paris do te jém ne fund te Gushtit. Rofte Shqiperia.

I z tuaj

*L. Benloew*



## JOVAN KOSTURI — KORÇA

**Nisjatori** *Eftim Markua derguar nga Anastas Lakçia nde Korçe te perhapnje idéjat shpetimtaré te kombit per té filluar shkolla kombjaré, dirék te çélnikte Jovan Kosture gjéti me pare. Mé gjithe grékomanismen é vendit vérbuar nga shkollat é nga Qishat élinishta mé ane te axhéntevé Dhéspotlére, Jovan Kosturi qendroj hérou kombjar, faqé mallekimévé rasezinjvé dhé paresise shpirtshiturvét. Mé krahn' é Jovan Kosturit deshmori Eftim Markua hariu te mblédhe 130 shtepi kombetaré qe pranonin gjuhen kombjaré ne shkollat è vendit dhè do te mos hiqnim te kèqiat qe hoqme, po te mos ndodhèshin trè katre tradhetore, qe frikesuan mireberesin Lakçé, qe prèmtoj thésarét è tij per te formuar nje Llaso mè vèhtè.*

*Jovan Kosturi duroj te keqia dhé plage te medha è te tmérta mé vrasjén é te birit Spiro! Ç'humbi ay! po mè gjith ato ay nuk i-u largua se drèjtes. Kombi duhèt t'i mbétèt mirenjohes shpirtndriturit Jovan Kosturit.* *Ate qe Vasil Terpua punonté nde Bukurésht, punonté dhé Jovan Kosturi nde Korçe per te arrire ldéalle te shènte. J paharuar qofte kujtimi i ketij deshmori ne historin é fillimit te perlindjés se kombit shqiptar,*



IOVAN KOSTURI — KORÇA

**Nisjatori** [illegible]

[illegible]

BKSH

KONFORTI

Nje nga vellèzerit tane te ikur qe ne kohen te roberise ne Itali, dhè i cili tere jèten è 'ti eshte deftyèr kombetar i math mè nje miresi posi Ansèlmo Llorèqi, Shqiroi, Krispi dhè shkronjes i komitètit Italo-Albanèz. Eshte dhè Prift.

BKSH

## KAPTINA VII

# ZJARI U NDÉS ANE Ê MBANE

## SHQIPETARET È ITALISE NE VALLÉ

Kur po rjèdhin lèter-kembimè ngaj ana è anes Europes, te cilat disa çpallén neper ditarèt shqipetaré, Turqia è kujdèsuar dita mé diten po ndjék kombetaret shqipetare mé fame. Keshtu me 20 te Oktombit 1897, konsolozi i Austrise nde Durres. ndodheshé ne Tirane édhè mé patur miqesi mé Murat-béj Sait Topjén, ndènj dy dite ne shtepi te keti qe pandaj vinté ne Elbasan. Armiqt' é Murat béut, gjéjne rast te marin rushféṭè nga guvèrna, vène dhè kallezojne mé çpifjé, qe Murat bèj Toptani dhè Dérvishi punojne kunder qévérise, mé konsolloze austriak. Pa pandèhur farè, Murat béu kapét prèj ushtaresh dhé sillét ne polici, ku po i benin fare faresh pyétjé te renda, dhé kur u nis ṭe dale jashte i thone qe ay eshte i burgosur. Te nésermèn é nisin t'a dergojne, po ryn ne mès Dérvish-béu mè tré djèma dhè kerkon te leshohet Murati. Bimbashi mé ushtaret e tij jép urdher te hèqin mbi 'ta, Rurpashaj i mban te mos i vrasin sé Mbréti kerkon qe t'a shpijén te gjalle.

Dérvish bèu hipen pèlen mè shoket dhè mèr malét. Murat bejne é bejnè syrgjyn ne Tripoli. Po sa pikasim per kete ngjame, é çpallim ne zhurnalin t'one «Shqiperia» Vit I No. 27 dhé 28, frengjisht, mè titllin «Apel a l' Europe» dhé Shqiperia gjéndét ne levizje e kryéngritjé, nisur qe ne Ipék, Gjakove, Prizrèn, Tetove, Gushine, ètj.

Gazéta la «Libérta» 14 Janar 1898, çpall nje kerkèse

qe dèl nga «Komitèti politik i shqipetarevé te Néapolit dhé Kallabrise», i cili thote:

«Shoqeria kombiarê shqipetarè ne èmer te te gjithe kollonivé shqiptaré qe ndodhène ne Itali, dykè mesuar sé vellézerit è tyré muarne armete kundra administrates otomanè per te kerkuare autonomine è tyrè, vime sot nè guvèrna è Mbrèterise t'i thêmi, dykè sjélle nderment intêrèsat qe ka patur Shqiperia me Italine.

Te sjèlle nderment lidhjèt é vjètera qe kane paturc shqipetaret mè Mbrèterine é Nèapolit édhè mé Républiken é Vénéciés, ndihmate dhé te mirate qe kane sjélle perpara kaqé shèkullavét, gjakne qe kane dérdhur shqipetaret per punera kombiaré litishté. Kerkon qe dipllomatia é Italise te pergjigjét ne vend te dyvé ketyré kombévé vellézer é te kerkojne t'i jépéte Shqiperise, pa vdékure édhé nje fitim i math per te dy keto shtété te fista dhé fqinjé.

Marchisé Giovanni Kastriota Skandérbé, P. Leonardo de Martino, Profésor Pasguale Turiéllo, Comm, Achilé Torelli, Barone Alfonso Kastriota Skanderbég, Avv. Francescco Mauro, Avv. Luigi Masci Avv. Giusépé Marchiano, Avv. Genaro Lusi, Athanasio Dramis, Avv. Vincézo Strigari, Prof. Gérardo Conforti.

Napoli 13 Genaio 1898

*Soc. Gerardo Conforti*
*Albanese delle Colonie*



ANSÉLMO LORÉCHIO

Ishté djal' i Shqiperise préj ata q'ikne nd'Itali, kur ra Shqiperia nene zgjèdhe te Turqvèt. Ndonesè ronté larg Shqiperise pè qindra vjétésh, ay si dhé vellézerit te tjére shqipetare te Italise è mbajtne mè shènteri dashurin' é Atdhése Shqiperi dhè kane punuar pa réshtur per rilindjèn è saj. Ansèllmo Lerèchio perseriti dhè forcoi ndjènjat kombjaré dita mé diten. «Albania» è Faik Konices, «Shqiperia» é Bukuréshtit dhé «La Nazionè Albanese» é Loréchios ne vjètèt e fundit bene qe Europa te perkujdèsét per shorten è Shqiperise. Lorèchio nga familié te fameshmè mé titullin «Kavalér» ka patur vellèzer te mesuar, njè nga vellézerit e ti ka kthyèr ne gjuhen shqip nje pjése nga «Divina Comédia». Ka filluar shoqerira shqipé dhé ka qene kryés. Ka shkruar nde «Giestra», nde «Il Rèsto del Carlino», «La Quèstionè Albanese». Mos u harofte émeri i Ansèlmo Lorèchios.

ANSELMO LORECHIO

Ishtë djal' i Shqipërisë prej ata q'lindë nd'Itali, kur ta Shqipëria nenë sgjedhe të Turqvet. Ndë nestë ronte larg Shqipërisë pë qindra vjetësh, ay si dhë vellëzerit të tjërë shqipëtare të Italisë ë mbajtne më shëntet dashurin' ë Atdhëse Shqipëri dhë kane punuar pa rështur për çlirmëjën ë saj. Anselmi Loréchio perserriti dhë forcoi ndjënjat kombjarë dita më diten, «Albania» ë Fait Konicës, «Shqipëria» ë Bokuréshtit dhë «La Nazione Albanese» ë Loréchios ne vjetët e fundit bene qe Europa të perkujdësët per shorten ë Shqipërise. Loréchio nga familié të lameshme më titullin «Kavalér» ka patur vellëzer të mesuari bjë nga vellëzerit e tij ka kthyér ne gjuhen shqip nje pjese nga «Divina Comédia». Ka fillaur shoqërira shqipë dhë ka qene kryés. Ka shkruar ndë «Giestra», ndë «Il Résto del Carlino», «La Questione Albanese». Mos u harroftë ëmeri i Anselmo Loréchios.

## DY LÈTRA NGA ITALIA

*Pallagrio 5 Noémbrié 1897*

*I nderçmi Zot dhe miku im i dashur*

Mora lhepushen è Zoterise satè 14 te muajit qe shkoj dhè u gezova sa mê, sè psé ajo me fton miresine qe kéni per mua.

Me thoni, Zot, sè muarte fytyren timè dhé u lutém te me dergoni èdhè tuajen.

I shkrova z. Louis Benloév mé indirizin qe me dhate Zoteria jué édhé i dergova ca vivlla ; kam bése sè ai do te m'u pergjigjèt.

U falèm ndèrjès per levdimét qe me beni per politiken qe mbanj nde Ditetari «La Nazione Albanese». Une bésoj sè memedheu jon do te mbahét lark nkaa gjith te huajvèt, qofshin gréker, austriake è italiane. Te huajit nuk mund te duan te miren toon.

Shume mè shpelqèn ai Zoti Frénk Spiro nde révista «Albania», kurdohére behen fjaje per *intrigat e Italies.* Nuk eshte vertèt. Italia nuk ben intriga ne Shqiperi dhé une benj vèt politiken é memedhéut. Prandaj do te benj si thote z juaj : nuk hapi polémike, sépsé programi im esht pa gje te fshéhte. Nde qofte sè i shkruani zoteriéjuaj te ja thoni.

Politika qè mbani nde «Shqiperia» édhe me pelqèn è me dukét shume mire, psè esht politika qe kerkon jéten è memedhèut, domèthene politika kombjaré etj.

I zoteris tuaj si vella

*Ansèllmo Llorécchio*

*Paina déi Greci 15 Decembrie 1897*

*Miku e vllau im i dashuri Dodani*

Do t'me kèesh per te ndjésur ne nuk te kam shkruar, si dhè u kisha desheruar aqè mot. Po mos te dukèt sé te kam harruar; te thom sé ti mè gjith vllézerit çe ndodhij Bukurésht me trini nde mès zemberes é ju dua gjithevét mire saa siit tim, persè doni vertèt mire Memen Shqiperii. Pérendia ju dhefshite dit é drit! Nuk dii te te refènj, o miku i dashur, harèen qe kam pasur é qe kam qe ték é para dit qe zura qe vellézerit tane ngréjten kriet té Dhèu jini a sè gjithe Shqiperia zuri zjarr. Ti vétem, po ti vétem men t' è delgjosh! Zèmra jimé, kriét t'im jane atjé tè ku dèr dhét gjaku per lirin. Befte im Zot qe kete hère Mema jone do t'lirohét vertét!

Te thom shume vjèt per gjith ato te mira, qe me kè bere tè «Shqiperia». Fjalet t'oté è ato qe thote Zoti Gèorgès Mèksi me kane limaksur shpirtin; déja édhé t'i shkruaja Mèksit, po nenk dii sè ku rii, ne é pafç te m'i falèsh è te m'a puthç té siit. Nani te thom sè sosa nje poème épik mè dhjét copa, qe i thom «Tè dhèu i huaj». Tè kii poém isht vune gjéla é ka tundit t'im; atjè rrefihèt si klé qe érdhen shqipetaret gjishera nde Itali è nde Siçilia, èdhé tè tjéra. Kam èdhé per te tiposur nje Raccolto di canti popullari dèll' Albania tçé i vète sa nje sii; jane kenga gège è toské dashurijè, dasmoré é trimash. Te tipos poémen „Tè dhéu i huaj» é keso kenga te lauzit i duhèn dii qint frenga. U te lutem atjè ne Bukurèsht me gjèsh keto haroma, sè te pak dit libri ment te dale me drit Te dergonj te shtypose, té „Shqiperia» kengen qe me flytyroj nga zemera té kto dit mbi te marret zjarr te Shqiperise. E bera dhè è lashe si me buroi nga gjiri.

Nani te puth é te perqaf te m'i falesh gjithe vellèzerve è te me shkruash shpét.

Dishiroj fort ritratin tent.

Vellaj i dashur

*Giuseppe Shqiro*

*Poéma u shtyp té „Shqiperia“ nde Bukurésht 1897 Decémber „Marko Gjon mos rri nde zii»*

ZJARI NE SOFJÈ Ê N'ATHINE

*Shoqëria «Dëshira»*

*Sofje 10 Qérshor 1897*

*I ndérçmi z. V. Dodani*

Ditetorja «Shqiperia» qe dél prèj nje komitéti (?) ne Bukurèsht, èdhè arketar ini z tuaj, èrdhi edhè mè gas te math é kèmi pritur. S'mund t'ju reféjme dot gaz è math qe na ndjéu zèmra jone. Ah ! sa mire è mé sa deshire é me vrap po punojne shqipetaret ! Pèrendía ua shpente perpara qellimin è bukur qe kini nisur, édhè shendét è dite te mira. Kejo ditetorè qe lindi ne Bukurésht si édhè gjétke, kèmi shprésen né Pèrendia qe te sjèllen gjitha te mirat èdhé do te zgjojne è do te u hapin syte mè mesimè gjithe shqipetarevé te humbur.

Zer' i bukur i kesaj ditetoré u hap neper te gjithe ketu. O burani ! punoni, jépuni te kupetojne te humburvèt shqipetare dhé tradhetore q'i ka pllakosur mjègulla è kèqè sa s'shoh'n farè ku jane.

Kryèsonjesi, *Dhimitri Spiro.*

*Nde Athine me 1 Shen-Endré 1897*

*I ndérçim z. Dodani*

Flèta «Shqiperia» é cila shkruan per te ngriturin koke te Shqiperise kundra tiranit saj, gezoj tere shqipetaret é ketushmé édhé mè gas te math présim te mare nonje fund te mire per atdhéjen èdhè te mos vèje kot ky gjak qe dèrdhèt sot. Mbésojme qe ata pè shqipetaret qe mundin do te çallestisin mè gjithe fuqine è tyrè te nxjèrin nonje te mire nga kjo è ngritur è Shqiperise.

U bejme rixha kur te mérni kete kartene t'one te na dergoni flèten t'uaj «Shqiperia» mè kete adrése:

L. Natsis & S. Pétsis (Etudiants)
Cafée de Paris
Athénes

S'kam ç'te shkruanj tjèter pervèç i falèm Zotit t'u jape fuqi ne kete lufte te madhe qe kini nisur.

Une
*Leonidha Natsis*

TE GJITHA KOLLONITE NE LEVIZJÈ

*Shibin-El-Kom 14 Marsit 1898*

*Memedhétar i dashur Z. Viske Dodani*
*ne Bukurésht*

Létren è Zoterise s'uaj te gjate, shkruar préj kohè é mora dh'è kendova mir' é bukur, po dua te me ndjésh vellazerisht qe s'tu pergjigja mè kohe, si kundre èdhè sot nuku munt te te pergjigjém ashtu si è do puna, per véç vinj te te thém mè gas te math: te lumte, te lumte mé te shkruarat é tua ne zhurna-

ZOTI LEONIDHA NAÇI

**Korçar, ka bere mesimét nde Gréqi, dhe ka ndenjur midis Grékevét; po kur ishté djal i-ri me 1897 nxenes nde Athine dhé liçit zhurnalle tim «Shqiperia» me kane uruar mé gjithe zémer fatbardhesi ne luften é madhé qe pata nisur.**

BKSH

BKSH

llin «Shqieria», te cilit fort me pelqéjn' artikullat é tua, dhé Zotí te dhente durim é dite è jète, vajtte ky zhurnall shume kohe, per fatne è memedhéut tone, i cili gjéndét dhè gjèndèmi ne rézik te math.

Shkruajme dhjéte (10) cope ndihmes per Vivllen e burrit tone Skendèrbèg, te cilen thua qe do t'a kthénje nje shqiptar i ndjére ne gjuhen tone shqip; te lutèn thuaju dhè atyré te Sofies (Bullgari) te me dergojne dhjéte cope kalèndare te vitit' ri dhé nje te vitit qe shkoj. Keto dhè kejo kar te te gjètte mé shendét e gezuar.

Te puth mé mall miku yt

*Spiro Risto Dine*

*Nga Palérmo 19 te Majit 1898*

*Shum i shkelqyér Zoti Dodani.*

Zura nga imè ungjel Avokat Gjon Krispi nde Bukurèsht Romani jane ca te gjakute ime—jashte nga Patrida persè è déshene shume mire—qe mè gjithe sé gjendéne té dhé i huajè marrenjene kujdès te te miren te patridhese tene.

Mundur nga thamacina prè punene te zoteriistendè, líp ndelésíé sé artheme te te shkruanje pa i njohur Sa qe dua te t'thom. Per né lère ne dhê i huaj bij te nje kombi pa mundur, gjithe ate qe na flét te dhéut ine, gjith ate qe kujton patridhen jone na dhézen zémeren te nje zjarmi i shènteruar.

Me thot im ungjel, sè nje nga te parate kujdès te shqipetaret, qe ndodhén ne Bukurésht dhé ne gjithe Romani, ish ata te spudhasin humbét gjuhen shqipé, ashtu sa i japnjen ate drite è ate sulme qe i ngjasen sè spodisinjen èdhé sot benjen nje gramatike édhé nje thenim (vocabularin) te gjuhes shqip.

Nga im ungjel ndsura mè shume gezim sé nje nga vellézerit tone qe ndodhèt ne Romani kent vjén n'I-

tali sot te mblèdhe liméntè per te bere nje Thenim.

Im gjysh Ndrisza Dara sa te mos beje te s'biresh gjuha, be è shkruati nje Thenim Arbrésh-Italian é Italian-Arbrèsh mé tète mil fjale, èdhé be nje gramatike é vogél te gjuhes tene. Keto di punera jane gjer mè nani pa uthemitur. U ndihen fatosme, o Zot, ne keto dy punera mundéne te sherbèine per thenimin é madh. Sos kejo lètre ku te pjère ndjése, sé te pa njorur i shkruate, por sé gjégja è Zoterise jotè ish nje nga te parat è komitétit qe sherbén per madherin é miresin te kombit shqiptar, ndéshiandré kja tih kjo létre.

Prunjisht thuhèm zotries tendè

*Gavril Dara*

*Konstantinopoje 3-15 Korrik 1898*

*Zot i ndérçme*

Pardjé mora lètren è Z. sate shkruar me 20 te muajit qe dollij mos u çudit nga ky vonim, sè mè qene lètrate poshtembètese vètem ne dhjéte dit nje hère vémi ne postet; pra mbésonj te me ndjèsh qe te bera é pritè pa dashure.

Nga ky shkak s'prita qe te benja «*réproduiré*» fotografin' é t'im ati, po è shpura é mori nje «*épruvê*» dhè ika; pra te lutém fort shume qe te mos prishète kejo fytyre sé é kam suvènir, dhè kur te te dergonj nje cope nga ato, qe do te mar per nje jave te ma kthéç «*intacte*».

Im ate kete fotografi é ka nxjère ne Janari 1873 domèthene kur ish 31 vjéç afero, (sè s'i kam ketu kartrat ku eshte shkruare ne ç'mot ka lindure), dhè ka vdèkure me 11-23 October 1892.

Biblla, qe do te besh («Mjalt' é Mblètes») vertèt dote behéte nje é bukure, dhé per kete mar lirine te te thém sé ne qofte qe dél mè shkronja shqip, munt te na hyje mjaft ne pune jo po ndryshe do te jéte

sikur s'eshte shqip dhè po thua pa dobi.

Gazèten «Shq'peria» per fat te kéq nuk é mar sé as qe é di faré ku eshte rédaksiè é Novinit. (?!)

Qahini qe s'u ndihin ne te shkruaret te flétese; po ketu nga ata te dy qe mumt te shkrojne: Na. dhé Sa. nje eshte semure, dhè tjatri ka nje bare punera; pastaj ka dhé nje shkak tjèter, qe as njerit nga sa shqipetare jane ketu s'i do shpirti te kendonje libre shqip mé shkronja te huaja.

Nuku zini ngoje èmerine Kristoforidhit midis fotografivé qe do te vini ne «Mjalt è Mblétes», dhé kam frike mos harohèt ky memedhétar qe na ka bere aqé sherbimé te medhénj per gjuhen. Kur pashe qe dote vini dhè Ali Pashen m'u ngjeth mishte, sè ky njéri eshte fytyr' è pabèsise é i ligesise siç è di vète. Mè qene qe po nxitohèm ketu prés kartene dhé kam ndére te te falém memedhétarisht.

*Midehat Frasheri*

Si sosa kartene pashe bibllen ku jane shkruar vjétèt è lindjévèt dhé po ju thom:

Abdyl béu ka lindur 17 Gusht 1839
Najim béu ka lindur 13 Maj 1846
Sami béu ka lindur 1 Qèrshor 1850
Te tere lindur ne Frasher.

*Pjana de Gréci 7 Korrik 1898*

*I dashur mik é vllaa.*

S'kam pasur ngé te te shkruanj, sè nani ka ndoca muaj qi shkruanj è punonj sa te shtypos poémen «*Té dhéu i huaj*» é te tjéra kenga. Te lip ndjès é te lutém te késh bèse sé kriiét po è kam pasur ték tii, o i-dashur, ndodhè èdhé jè.

Kam marre Skanderbégun édhé Qérbélane; te paren é kam xgjédhur mè gezim, sè esht shkruar bu-

kur mè gluh è kulluamè è mé zamber, si dhè thom tè lètra qe dergoj z-tit P. Evangjèli, po Qèrbélajen nuk è kam èdhé hapur gjér me sot, sé me ka lipsur qéroj. Ju thom shume vjèt gjithevét sa jini ne Buhurêsht è i lutèm Pérendise t'ju falnje shendétne, harèe é fuqi.

S'mund te késh bèse mè cilin disherim rri é près «Shqiperine» q'esht drita é vertét è dhèuthit t'ene, si dhè *Nazione Albanese.* Nga pèse-medhjet dit kur marrem é perpinj gjith nji hèrje é nuk çqitém kuurr. Paçi dit per te miren é Shqiperiis!

Dishiroj ndonji shkruamè e jotja, sé ka shume gja nga ç'shoh, è te lutèm édhé te me thuash ne di gje nga istorin è farefisit timè (Sqiro) nde Shqiperi, sé pak è pak dua te kerkonj rrenjen é shpivét Arbenéshe qe ndodhène té dhèu litij kam nxene disa po doja te dija gjeagje èdhé prè jysh sa te mbaronj punen qe nisa S'kam t'jéter te ju shkruanj per nani, po nuk le te shkoje shume qe t'ju shkruanj pamét

Te perqafonj si vlla éete puth syt. Mik è vlla

*Gjuseppe Sqiro*

Ne muaj te Korrikut 1898 Murat bègu shpetoj nga Tripoli dhé vèté n'Itali nde Brindizi, qe nga me dergon nje vjérshe qe eshte çpallur ne «Shqiperia» No. 47 31 Korrik 1898.

I dergova dy qint franga qe nga Bukuréshti dhè pas disa dite mar kete lèter.

*Brindizi 10-2 Korrik 1898*

*Vella i dashtun zoteni Dodani*

Mé shume ndér i mora ato dy qint franga qe me çute, me kan mbaruar pune sa nji mij napolona, u jam fale ndérit, Bej mir mos prit per kèq.

Ketu i kam vu punete mb'udhe, po i sho qe vel-léznit è Italise punojne mé gjithe zèmre per te miren

é Shqiperise. Po dhè pak nga frik' é Austrise u ndi dhé mbréteria. Ender è Italianevé eshte qe te kéne dètin è Adriatikut te lire, se po qe te jéte ne dore t'Austrise s'u punon me trégetia.

Po na duhét te jèmi mir èdhé mè ata qe mèjtojne te marin cope nga né, é ti kréhim sa te mundèmi è ne funt te shikojme punen t'one. Te benèmi pak si prifteria é Elinit?! Thon: «nji qint hilè, nji trimeri». Po sa te mundemi mé faqèn te bardhe ê mè gjak te ftohet.

Shkurt te mundohémi gjithenji, t'a shtiém ujt po nd'are t'one? E zéza politik é ben draguan dhèper, Vella Spiro bègu mire ban qe po i rrefén Turqise faqèn é qèshur te maskese politikese, po fort ligsh prape po punon tu i shan é tu i luton gjith shoqerite. Çuditèmi sè i kendova gjith artikollat gazètes tija, fale mundimit te tija, po te sharat ne fund me ngjan foshnjerisht. Mos kam mendjèn è shkurter un? Po s'di çe t'i shkruaj, çe t'i thom. E kam njohur fort te vogel kur ish ne Stamboll, è donjé fort édhé i thonja shume hère: ti do te benésh burre i math è shqipetar édh' é puthnja shume hère ate shenj te bukuré te madhé qi ka ne mjékr. Po te thém qe é donja si vella si bir si shpirti im, èdhè tash è dua sé me dolli proftija è falli, u be ashtu si paç lut zotit Faiku, po s'di a dot ma degjonje fjalen t'imé?

Asht i éger, zjèn si prushi! Po è mbrapena un deshmimtari do te vèté ne Bruksèl é do te rrihémi mé grumba si ingjilizet mé 'te! Si amèrikanet, sé ndryshé mè koken qe ka Spiroja s'dilét dot! Zoti ja falte memedhéut te ngrate; Sindekur te kishim édhè me te tjère si ay zoteni, po dashuria é ben ègoist. I duam vellézerit te jène farè pa ngalèz é te thjésht. Shum jète «Shqipenis»!

U falèmi vellazerisht si dhé gjithe vellézervé qe jan atjé.

*Murat Toptani*

*Brindisi 13 Korrik 1898*

*Zot i dashur im mik,*

Létren è z-saté mè shume deshir è mé ndér è mora. Fale Zotit, létrat qe kam çu, kujtonj qe te gjitha ne dore kan ra.

U falémi per ditorète qe me çonit è per pyejtjèt qe kishit ba per mua.

Zot, mos kini frik, sè nji hér u genjyè plaka, thomi né Tiranasit. S'asht ajo kohe mâ, qe i zintè Géputin mè qérré Turku! Ketu jam i lire. E per Zotin s'kam frike. Per te holla, vella, jam si gjith ata qe hikin è mâ shum nga Tripolèja. Kam dergu ne shtepi, po s'me kan derguar akoma, mos kan gjét no nje rézik dhé ata? Mè zotin Loréqo é mé te vellane u poqa ne Kantanzaro, me kane vu nde barre ndèrit tyrè. U jam fale.

Si te shoh punet kam fort deshire te vinj é t'ju perqafonj mè dashuri sa vellazer zoterinj qe jéni aty ne Bukurésht.

Jam i Zotenis juaj mik mé bèse é vella

*Murat T. Toptani*

BKSH

ZOTI SOTIR PECI

Lindur ne Dardhe, beri mesimet universitaré nde Athine, patriot i ralle. Vajti ne Amérike, organizoj kollonine shqipetaré te atjéshmé, dhé nxirté gazéten «Kombi». Me pas nxori ne Manastir gazéten «Bashkimi i Kombit».

Ka leftuar mé drèjtesi dhé mé zjar kombetari kudo qe ka baritur, dhé ka fituar ndére é te tere shqipetarevé.

Nje nga faktoret kryésore te kongrésit Lushnjes, arriu minister i aresimit, dhé me 1923-1924 nje nga anetaret é réxhénces; ku punoj mé karaktér dhé drèjtesi.

Emr' i tij eshte i-lidhur mé historin' é rilindjés se Shqiperise. Rofte!

BKSH

KAPTINE VIII

## LÉTERKEMBIMÉ MÉ FAIK KONITZEN

*Bruksél 21 Noémbre 1897*

*I dashur vella Dodani,*

Kendova mè gas létren tendè te dashur, Me pyèt psé ndénja aqé kohe pa u shkruar ? Shkaku eshte sé kam qene ne shume trubullimé. Mé te vertèt kujtonj tani sé te huajte paskan te dréjte : Shqipetaret s'jane te zoterit te marin lirimin è tyré.

Rober te poshter nga 500 vjét é me shume, rober per jéte do te mbètén. Une faqèza t'a thém : s'kam shprése te behét *kure* gjekafsh$^{e}$, dhé jam sigur se te gjith ata qi méndohén pake, ne mendjé t'imé jane. Qe te kishim shprésa, duhéj shqipetáret sot te kishin ne nje mije vendé komitété te shendosha, te kishin propagandiste per te vajtur pshat ne pshat neper tere Shqiperine, te kishin ditetorè dhè flèta ne tere visét é Europes. Po s'kane as gjekafshe !

500 vjèt roberi nuk i tundi pake. Te pasurit s'ndihne, te pa pasurit s'punojne. Ç'prèsim ahèré ? Per

létrat kè te drèjte, por une kam aqè mekat per te shtypur fléten mé ndihmen è atyrèvé te Stambollit; si t'a nxjèr kur t'i zemeronj dhé ata? Andaj punen é létravèt do t'a leshonj te fléje èndè ca kohe, pastaj te hapim nje «discussion».

Te perqafonj vellazerisht dhé mbétèm vellaj yt.

*F. Konitza*

*Bukurésht 9 Maj 1899*

*Memedhétar i dashur z. Faik Bej*
*nde Bruxélles*

Nga lètr' é z-saté kupstovs sa hidherimé kè ne shpirt nga qe nuk i pandévè aqè te poshter è kaqé te ftohte mèmedhétarete per te shénteruarin qellim qe nisè. Té ze dorene vellazerisht sè èdhè nde mua gjith ajo ngahu. Po nje gje dubét t'a dime mire: Puna qe nisé z-jotè èdhé qe te pasova une, nuk esht è paket. Pas kaqè mijra vjètésh, te gjemonje nde kthize te Europes nje zhurnal shqip si eshte «Albania» é z-satè èdhè é dyta «Shqiperia» imè dhè te goditin nde mish te gjalle é te zbulojne cilet jane armiqte, pa kursyér farè, kejo nuk eshte pune é paket.

Dime qe kane dale dhé te tjèra zhurnalè perpara tonavé, po (pas mua) nuku kane patur rendesiren qe pat «Albania» édhè se dyti «Shqiperia». «La Nazione Albaneze» eshte nje fléte é mire édhé «Nouva Albania» gjith ashtu mund te jète, po, mé qene qe shkruhèn italishtè é nga shqipetare qe kane jètuar nde Itali, ata, shqipetaret tane, as qe i kupetojne mire; po èdhé si gjéndét sot mendja é shqipetarevè, mund t'i bésojne si zdurnallè qe punojne per intérésat è Italise; mé gjithe qe ata vellézere jane te paqme shqipetare, èdhè è kane vléijèn é madhe pèr kunder atyrè te Grèqisé, te Misirit èdhè te Rumanise. Mâ pastaj thomi per „Al-

banézul» èdhè «Shqipetari» qe duall ketu nga Naço Çikozi-Prèdéscu, edh' ato nuk patne rendesiren é «Albanise» èdhè te «Shqiperise» mundét sé nuk ish koha po mundèt dhè qe trazuan politika te huaja, dykè çfryre pernjèrésh kunder Austrise è tjatri kunder Rusise, pune qe nuku pajtohèshè mé nèvojat è kombit. Shqipetari kish te tjère me te aferte armiqe ; pra, puna qe nisme nèvè, dykè kruar Shqipetaret atjè ku i hanté nuk ishté è pakete ; me dashka pa dashka duhéshé te ngrihéshin furtuna ; sé shpirtroberit, as qe mundnin te durojne, kur shikonin sè puna vété pèrpara, èdhè plaga malesoj nde te dashurit é tyrè. Lufta pra u hap, èdhe une isha fort i gezuar, se fundja me ne fund do te dale é drèjta.

Gjér mos turbullohét s'kullohèt, thote fjala. Po kur kjo lufte mbahéshé aqè bukur, kurris mé kurris : «Albania" mé «Shqiperine» édhé leftonin armiqte me te kater anet ; kur armiqt è kombit afronin te na bièn nene kembe édhé dykè ndréqur te métat, te hyjne ne udhen è se drèjtes, mjérisht «Albania» zu te largohét èdhé fuqia jone zbriti shume. Po nuku vétem qe u largua, po nisi èdhè grindjé édhé me ne *fund lufte!*

Ç'do mè thene „pa krah Shqiperia eshte é humbur»? (faq 105) T.S.B.... «nene krahun é nje tjétri shtét" i math V. B. (faq. 105) *Lart'madhesi Sulltani* (faq. 121) édhé perpara ?! per vèç sé u largové dhè na le te dobet pa deftyèr mua makar ç'ngjèt?!

Ç'do mé thene : «Ca zoterinj ètj (faq. 168)» hapin udhen è orthodhoksise Rusè étj.

Ç'do mé thene : «Sa te jèmi te gjalle né shkronjetaret è «Albanise» étj. pervéç sé zuré te na luftosh pa meshire. Qe eshte gjekafsh nde més nje gjisht, bèsonj dhè une si bèsou z-roté, po mè ndryshimin, qe zotroté thua sè nuku ké koke t'a kerkosh, kur sè une thom sè z-rotè jè fajtori.

E di sè do te zemerohésh, kur te flas drèq per dréq, dhé bétohèm per Shqiperine ! qe me vjén kèq te zemerohèsh, po te flas faqéza vellazerisht, sé dua te tur-

bullohét per te u kulluar mê shpèjt puna perseri, ngaj qe eshte névoje te jèmi miq. Edhé do te jèmi kur te mê bindesh, a kur te piqémi pamèt nde ate idèe, qe patè gjèr me No. 7 te «Albanise», te se cilese une po i qendronj Bèsnik, édhè do t'i qendronj sa do te mund te rronj mé zhurnalle tim (se mbeta kripe) sè eshte è vertèta ashtu si thom une, ashtu si thè tine, per ato ngaja qe thua ti, mé ato shprèsa qe thua ti, gjér nde No. 7.

Nde eshtè sé mé kesbillen é plèqvét ndéruar u largovè a nde eshte sè vètiu gjykové rrendesiren é zgjédhjèse punevét, édhè deshperimi te beri te largohésh nga Shqiperia è te kerkosh trashegimet nga pushtètet fqinje, pune qe me vuri ne mendim dhè mua, po atehèré çpaté mé *Lart-Madhesine* édhè na lefton?... Ketè nuk è mar vesh kurre.

Sé kejo do te na mbanje ne vend édhè do te forconje zémerat é turkomanevè. Sa per thirjén é ndihmes huaje dométhene te Austrise, kejo me dukèt eshte shume shpèt, me dukèt sé vrasim véhte-vèhtene. E líga do te na gjénje èdhé nde bri te buallit ne u fshèhshime, po te paken névè t'i ruhèmi sa mundime. Une mé mendjèn timè, nuku e gjènj kaqè te rende shpetimin è Shqiperise ne mbiéllçime vellazerine nde mès te llauzite. Kane shpetuar zgjèbarakete, qysh nuku shpetojne léonete? Shqiperia eshte Béktashè m'é shumeta; puna qendron nde dore te 4 Atervé, te cilet kane nde dore gjithe krèret é Shqiperise.

Europa, nuku do te lère por as qe behét dot, si nde Armèni, kur te jène gjithe lidhure. Edhé pune qe ka te ngjare, nde u gatofte deshira per Austri nga vète llauzi, atehérè mbétme per jéte nde duart è saja, si Bosnja dhè Hérzègovina, nde paste ndjénje kombiaré te shendoshe do te jémi dhè nèvé nje shtét si te vègjelite fqinje. Kejo i vjèn mire edhè gjithe llauzevè antisllavista te cilat duan te vène nje rroman te shendoshe nde més te llauzevè. Kejo esht' idée é shume njèresvé medhènj, qé dine politiken è Gjérmanise, édhé

te asaj véte Frances. Per sè te mos hèqim dobin e kohevé? .

Me ndjè qe hyra nde féllesire te politikes se lartere, ku ndofta s'kémi aqé fuqi t'i gjykojme punet mire filli.

Po mé qene me shkruan kete hére zgjèshur une mè pafajnesine timè te shkruanj gjith' ato qe mfshihèn nde thèllesire te shpirtit tim, si nde vellaj im. Sa per punen è Orthodhoksevé, sot qe Gréqia n'a é mori te kéqén mos u tut farè. Eshte mjaft névè, ti dhè une édhé shoket é te dyvé, te kémi dashurine; pa ata i mblèdhim mè ngadalé.

Thuhète dhè nje fjale, qe dipllomatia eshte shtate hilè *édhé* nje trimeri. Bej dhé Z-roté Dhipllomati, (pervéç mé «*Lart-Madheri*» sé na prish). mé Austrine ne mos é gjén pune te veshtire. si è shikonj une; po ki nderment, qe Shqiperia te jéte per Shqipetaret. Sa per abonaméntèt keto dit do te flas mè miqte qe me shkruan.

No. 12 i Albanise eshte éksçélènt.

Te fala vellazerisht

*Vissar A. Dodani*

*Bruksél 11 Qérshor 1898*

*I dashur vella Bésarion Dodani*

*Bukurésht*

Létra é Z-se s'Atè me pelqén shume, sé eshte pa hypokrisi, mé qèrim te math zèmberè. Prandaj édhé une dua te thém dy fjale faqèza.

Eshte vertét qe po te mérén mire vèsh «Shqiperia» dhé «Albania» te gjitha te tjèrat do te jéne te lèhta. Po ne esht ashtu psé s'u muarme dot vésh ?

Munt te ja u thém mé hèlm te math; shkaku eshte ky:

Kémi mare gjèr me sot 5 a 6 létra ku disa memedhètare na mesojne nje gje mé mjaft rendesi.

Dukèt sé Pandéli Evangjéli esht i pàguar préj grékervè per te ndaluar perparimin è vètendjèses kombjaré te Shqipetarevè. Perandaj ky zot—thone memedhètaret, as ndih nonje pune per shqipén, as perkujdèsét te miresohèt shkolla é Korçes, as sh'typ shpèjt bibllat q'i dergojne, te cilat i mban muaj è vjètè pa çpallur; fund, «Dituria» qenkerka si nje gracke ku memedhétaret é vertéte dykè vajtur mé qellim qe te punojne bijén pake nga pake ne ftohtesire è ne gjume. S'do as thene sé keto poshteri as nje hop s'i kémi bèsuar, sé t'u kishim sjèlle bèse do t'i kishim nxjére ne shésh.

Ata memedhètaret qe na shkruanin thonin dhé nje gje: Z. Pandèli perp'qét nat' è dite te prishnje ditetorèn «Shqiperia» mé shqipetaret mé te cilet kjo ditetoré ka te benje.

E perserit si vella èdhe nje hére. Ketɔ kurre s'i kam bésuar. Po si do mos nje ftohtesire u lind midis névé....

Sa per Sulltanin, L! è Ti eshte nje mbrèt mé ment, mé urtesi é mè qyteterim; andaj, dyké è perkedhèlur, kémi shprése te na leshonje shkolla. Shume mirésia è Tij kryéshkronjetori i Sulltanit, Zoti Tahsim bèj na shkroj nga an' é Mbrètit te vémi ne Stamboll, t'a bejne «Albanién» sé atjè ka njezèt mije shqipetare èdhé guvèrna dote na ndihe ne perparjèn è se perkoheshmés, po mjèrisht sot per sot shendèti me ndalon te vètè ne Stamboll bashke mé Visken po te shohem me tutjè.

Duké desheruar fort è fort qe te mos jèse kure nonje ftohtesi midis névé, te perqafonj vellazerisht si dhé zoti Viske Babatasi,

yt vella,

*F. Konica*

*Bukurésht, 3 Qérshor 1898*

*I dashuri Zoti Faik,*

*ne Bruksél*

Létren è mora, u gezuash qe m'u pergjigjè! Pergjigja é z-satê ne lètren t'ímé, qe u-a shkruanja mé aq deshire cshte é ftohte; dashuri mé te pahir nuku behét. Do te vinje nje dite qe te me duash é te me kujtosh, po un i ziu a do te jém atehérè njéri, apo njéringrenes. Mè gjithe qe jam mjaft zémergjere dhè duronj shume dhé mfshihém, péshonj é mat, qe te defténém sè jam i qytéteruar, po gjak shqipetari, vojtkerkam po te duronj shume. Ndonje dit, kam frike mos mar sopaten é te héq me te djatht è me te mengjer, kudo ku jane njéres. Shpirtin è kam te hélmuar shume dhè te jap te drèjte ne Fléten è II-te te z-satè. Qysh? Ne nje komb si kombi yne, nga i cili kane dale njères te famshem qe kane bere punera te paharuara dhè te lartra, sa as qe bèsoheshin dot, nje komb qe ka ruajtur èndè sot vètijat é vjétera plot lartesi, qysh, ati kombi i vdékerkan ndjènjaté kombiarè? dhé ron ne meni è ne nakar?

Réth é perqark kam armiq, dh'ata miqte q'i dinja m'u nkthyèn. Peshpillojne midis tyrè dhè me quajne lavdi-ndjékes, andaj i neneshkruanj artikullat. Mora pseudonimin *Naido, Doinad* ètj. te tjèra te vjèlla, sa me vjen te hiqèsha me njane te botes é te qanja, te qanja sa te pelcisnja. Pè kaqé mijera vjétè [illegible]rth nje dite qe te kéte dhè kombi t'one trè kater organé, te flasin per shpetimin é kombit, mè rézik qe te mos shikojne mê atdhèje; ne vend te ndihèn ndiqèn, ne vend t'i kendojne flétet è t'i thethijne i kthèjne prape, togjétogjé, te pa-hapura faré, mè persiper fjalen: «Rèfusé» nga dy tri hére; pse?.... nga nakari; psé?... nga ègoisma; psé?... qe te mos vété dot perpara; po psè?... psè t'u pelcasin pa t'u dalçin. Po un' or vella, do t'a benj

détyren sè shoh qe jashtathi jam mire priture dhè shoh qe zjari u perhap édhè zuri te intèrésohét per na èdhè Europa umanitaré. Vètem ti o vella, me truhè te shkelqèsat è te diturit burra si Z. Louis Bénllohèv, Emile Legrand, Mèli dè Vogué, Dr. Holger Pédérson mè te cilet hyra ne korispondènce èdhé te cilet è kane truhur gazéten «Shqiperia» dh'i kane dhene nje rendesire.

E nuk do te lihèm tani, si mbésonj, qe nuku do te lihésh as z-jotè mè gjithe qe jè i xvjérdhur kaqé shumé ngaj orthodhokset. Sé orthodhokset grékomane mè myslimanet turkomane ngjasin midis tyré posi dy pika mé uje. Pra, duhèt bere durim dhé zèmer te gjere sè puna qe kémi nisur na, eshte é madhé per njéres te medhènj è te duruar; pra mos m'u zèmero te te thom : *pakes me poshte mé te sharat.*

Te puth vellazerisht

*Vissar Dodani*

*Bruksél 16 Qérshor 1898*

*I dashur vella Dodani,*
*ne Bukurésht*

Mos kujto sè u zémerova faré. Si te zémerohét njériu kur shéh nje vella te vertéte, i cili i flét faqèza ç'ka ne shpirt? Vétem nje gje mund te me zémeronje é te me plagose shpirtin, kur shoh ca memedhétare qe s'kuxojne te me shajne faqéza, po futin spica prapa mè nje poshtersi te turpshmè, é ne nje vend ku nuk ndodhèm per te pergjègjur é per te prishur te çpifurat....

«Shqiperia» sa vètè po permiresohet, ne do bèsoje, ne do thuaj mè vèhté qe dua te te perkedhèl, por è vertèta eshte kjo: qe kur u çporr Mèksissi ditetoria u lartesua shume.

Sa shkruan ti, munt t'i neneshenonj mè te dy duarte aq i gjènj pas mendjés s'imè. Por une thom dhè nje gje : Kèmi qindera mije shqipetare fanatike :

Si te bejme : duhèt nje ditetorè qe te punonje mé te tille menyre qe t'u pelqénje ketyrè njèresvé ! Andaj mè gjithe qe ne qellim jèmi gjithe nje, forma è «Albaniés» ndron pake nga «Shqipéria».

Po te dergonj nje artikull i prére nga è madhja ditetoré e Gjérmanise «Frankfurter-Zeitung» qe 5 Qérshorit, è cila si ç'è di, ka te madhè rendesire n'Europe. Ben fjale per autonomin è Shqiperise é thote qe „Albania» dhé shqipetaret è Bukurèshtit punojne mire per kete qellim. Nga q'eshte pak é ashper édhé nga tjatra ane ben fjale mè mua, s'é nxjér dot une té «Albania». Po ne do perkthèjé dhè çpallè té «Shqiperia» sé ka mjaft rendesi.

Te lutèm te na çosh fotografine tendé, sè kémi nèvoje per 3 a 4 muaj.

Te perqaf vellazerisht
*F. Konitza*

*Bukurésht 20 Korik 1898*

*Vellaj im i dashur Faik Konitza*
*ne Bruksél*

E mora létren t'endè te 11-tes Qérshorit dhé é kendova mé te math kujdés. U ngjatjètonj sè m'i pelqén létrat e mija dhé i pranon si te dala nga zèmr' é paqmé, ndonesè ketu ketjé te kam folur çkrépur. Kam desheruar vertét qe «Shqiperia» imé te mérèt vèsh mé «Albania»-n qe dréjton z-joté mé aqè dituri è lartesire édhè mé gjithe ate hov qe è pat nisur, è mè zjare qe na è zhtivé ti, o vella, kur thé qe shqipetare turq nuk ka, shqipetaret jane vètem muhamèdane é kristiane ; qe sulltani eshte nje kusar ! (dhé tani plot gojen Lartmadheri è Tij Sulltani ?!)

Me thua sé Sulltani eshte nje Mbrét mè ment, mé urtesi è mé qytètèri, édhé dukè perkedhélur kè

shprèse te nâ leshonje shkollat; pa, dhé miresi é t Tahsim béj ju shkroj te víni ne Stamboll te beni atjè «Albanièn» ku jane 20000 shqipetare, pervéç qe dhé guvèrna do t'u ndíhe Ah, o vella i shtrénte shume! Ndofta prape réh é zeze afron te pllakose fatin e Shqiperise! po tine, tine jè ay vèriu q'i perndavè rèhte dhè é nxoré Shqiperin', atdhèjen, ne faqé te Europes, qe te shohe sè ajo ron, sé esht' e gjalle, dhè tani kerkon te vèsh ne Stamboll si *capi né kasapi?* po kryéshkronjes i Sulltanit z. Tahsim paska kujdés per ty sè s'kè pajtimtare mjaft aty, dhé te therèt atjè?... Vellaçko Faik, **gezohém qe qenké i semure** dhé s'vajté dot shpèjto ne Stamboll, sè dhè ti si stergjysbi tent, ay Lèoni i Janines do te gjénjè ate shorte te pabésise nga Larmadherij' é Ti!

Rri atjè ku fatmiresia è Atdhèut tone te shtiri. Ri atjè ne kethize te Europes, mè díturi te larter; une ketu mè sa ma prét mendja, *si tregetar po i nderçem* dhé mè miq è mè krahe te shendosha, o burra perpara! Nèvè mê Shqiperi s'shekojme.

Sa per intrigat qe bejne shoqt' è Naços a ndonje grékoman duké thene sé Pandéliu esht i shitur, mire ben qe s'i mbèson. Un' é njoh ate qe kur íshim fosh nja dhé gjèr sot jèmi te pa-ndare. Pastaj te shtypurit è bibllavé s'kane qene ne dore te tij, èdhè gjith ashtu édhé te derguarit é tyré ne Shqiperi, as dépozitat e bibllavé. Ato kane qene ne perkujdèsjé te te tjérevèt bashke dhé mé gjithe komitétne; te gjitha te zena jane. Ketu pervéç te paket jane turbulletore è spione nga pertèsa, po tani u dollí kripa dhé atyrè, pra, mos u dishpro; perpara si Lion qe jé dhé mos me merzít dashurine.

Véllaj tuaj
*Viske Dodani*

*Bruksél 4 Gusht 1898*

*Vella,*

Te pergjigjèm ne ca fjale te paka te postkartes mé dergimin é se ciles me ndérovè tani shpéjt.

Per te véhtequajturit shqipetare t'Italise me kishé bere fjale édhè nje hère tjarer. Qe te te benj zèmbren, nuku çpalla mê gjeséndi kundra atyrèvè; po tani, ata zune te na luftojne, édhè nè pergjigjèmi. Do te bejme nje lufte pa pertim é pa frike; pa pertim sé jèmi shqipetare dhè s'lodhémi: pa frike, sè te dréjten é kèmi mè vétè. No. 4 i «Albaniés» te ka érdhur èdhè kè pare si i-a zbuluam ne shésh genjéshtrat é Ansèlmo-s. Puna eshte shèsbit; a njériu eshte shpirtrob édhè lindét pa kuptuar, a eshte i zoti te gjykonje, édhé ahèré mèr vésh qe nè kèmi te drèjte. Me thua, or vella, sé mos ftohim zémbrat é disa memedhétarevé dukè share Ansélmon. Bésonj sè keta memedhétare mèntohén ashtu pa ditur sé ç'bejne, sé po te ish ndryshè, zoterotè dhè né do te kishim te dréjte t'i pçynim ata njères, te cilit do te ishin memedhètare po tradhetore.

Ah, or vella! nuke shéh sè te dy flètorét tona kane nje pune te madhé per te mbaruar perpara Historise: qe te vèje mbare kejo pune eshte névoje te ècijme bashke dora mè doren; ne te gjitha, po thua, nje mèndim kèmi; psè te na ndajne spicat é atyré... te Italise?

U be gjèr me sot n'Europe shume propagande è mire per Shqipetaret. Kete propagande é prishi ne nje hop nje italian i qojtur Baldaci, i cili shkruajti sé shqipetaret jane égersira dhé égersira. Kete armik te kombit tone, a é di si é quan Ansélmo-a? «Il nostro illustre amico Baldaci», — do mé thene Ansèlmo-a ka shkruar sé ka per mik te shendoshe ate me te ndyrin armik te kombit shqipetar!..

Mér pra, or vella, vétén, dhé mos u bind, sé spicat qe te kllasin tradhetoret dyké folur mire per

Ansèlmo n Po, si te duash prape. Vétem kete te thom vellazerisht, me vjén kèq kur shoh nje memedhètar si ty te behèsh mpronjes i te *vêtequajturvé* shqipetare t'Italise. Te jémi miq mè njéres si Schiroj vété é vjèn, po jo mè nj'Ansélmo, qe do ta luftonj gjér sa te bindèt é te pushonje mé genjèshtrat dhé te dije qe ata te «Albanies», te Shkodres, te Mirdites, é te Shqiperise tere s'jémi te shitur.

Dykè shprèsuar sè ké per te mare vèsh nje dite sa lajthitur jé, te shtrengonj doren mè zémbre te nxèhte

*Faik Konitza*

*Bukurésht 29 te Gushtit 1898*

*Zot i ndérçur Faik*

*nde Bruksèl*

Mora nje lètre te Z-saté shkruáre me 4 Gusht, pergjigjiè ne nje postalen timé, ne te cilene kisha kurajo, duké rèndure t'u lutèm te mbyllni polémiken qe hapte mè ata te Italise. Nga létra é Z-satè kupetonj qe zémerat jane prishur fort édhè hèlmoném ne shpirtit, dyké pare te tjéra brénga, qe i daline mbrodhesise kombite fatkèq, atjè ku duhète te bashkojèmi.

Nèvè, nuk vèteme 4 zhurnallé qe kèmi, po 100 ne ishté mé mujt qe te nxirnime nje ze te forte te frikshim è te degjuamè nde Europe, per te drèjtate q'i kerkojme, nèvè zume ê po haémi nde mès tene si qénte. Po-sa dualle te dy zhurnalète tona kishime nje dashuri bashke mé ate te Ansèllmos, qe ngjisté me nje buqét te nje lulèjè burbuqè, qe te tria shkoéshin, dyké levduare njera tjatrene; édhé nje hop, kur goditi é pshyri nde gjètké «Révué d'Oriènt» nde qellimin tene te gjithe mè nje goje u pergjigjme. Mbanj ment, z-tuaj, kur thoshité ça fjale te bukura per pergjigjén qe i beri

«Shqiperia», pa, kur ardhi radha te flisni per ata te Italise, thate ; qe asaj ja èpni levdatat qe perpara, domèthene, qe ishté nje armoni, nga è cila vétem ay qe s'gjykonté nuku gezohéshé.

Me ne fund, sikur rame me sy, politika é z tuaj pas 7—8 muaj shkau nga udh' é pare per nga hèra, qe mbêtme te pakupetuare gjèr sot, èdhé pas asaj hyri grindja nde més te z-tuaj è te atyré te Italise. Sa na hèlmojti kjo gje, ndofta è kupetové nga lètrat qe kèmi kembyére nde mès tene. Me tjatre ane, faqéza u thom, sé shume hére shkrova ndé z. Ansélmo qe te durojne é te mos zgjatine polémiken nde mès te vellazerise, polémike è cila behéshé per kurize te qellimit te shènte Edhè qe andèj m'u zotuan qe kane per te hèshture. Po nuku shkojti shume èdhé z-tuaj zute te na ngisni *dhé névé*, qe nuku kémi lojtur pike ngaj udha qe nisme perkundra qevèrise mbytesè qe zoteron Shqiperine. Une qe pata nje dashuri te véçante per penden é zemren è z-satè gjithe hidherimét i gelltita mè bèsim qè kembèsa è politikes te flètes «Albania» behèt pa hir te plote nde shpirtin te z-saté. Edhé si gjyrmatar pandéha sè pupa dhè udhesimi ishté qe nga vellazeria è Stambollit, a i cavè vertèt te véteqojtur memedhétare nga Bukurèshti. Po kur kupetova sè ata te Stambollit nuku vétem qe s'pelqèjne perkedhèlite po jane dhè hidheruar dispréjtur nga politika é «Albanise» qe nga vjèshta è ketéj mbèta mè bése sé rè gjahu i atyrè te Bukurèshtit mè goje te madhé véteqojtur miredashese te kombit. Koha do te deftenje sa patriote jane ata njeres edhe afroj thom te zbulonen gjithe sharllatanite qe benin gjithe sumat pe dhjetimèsh mijrash frangy qe haen ne kurris se çeshtjes kombiare; mundet z. Dervish te u shkruanje gjeagje. Ashtu pra, nje zot si z-tendé me dituri, mé émer, mé gjak nobij nuku ben mire te loç nga udha è pare, qe kishé nisur è qe te ndiqnim pas édhè névé, é te degjosh keshillen è botes se huaj, qe nuk é ké njohur è qe kè pas te çilen bèsové sè jane dhé bota é tjèra. Kaqé per politi-

ken é madhé. Sa per vellèzerit è Italíse une kam bere nje bésim qe jane shqiptare te paqme èdhé i dua mè gjithe zèmer sé ata jane te paret qe kane nisur luften me nje shtrat te gjere te litératures; jane te paret qe dhane ngaje te dalen patriot si Vèqil-Hardji, E. Mitkua, V. Bardhua, V. Kristoforidhi, Bèjléret tane ètj. jane te njohur memedhètare te vertéte nga Dora d'Istria, na è deftéjne édhè punet é tyrè pa nonje intérès. Nde mos dine ata gjuhen tone, si nèvé, kjo nuk ishte nje fjale sé sjane shqipetare? Nde jane qe shume te ikure, kur ata ruajne gjuhen robén è zakonèt shqipetaré jane aqé mê shume per te levduar è per te dashur, qe nuku mohojne gjíndjèn. Ketu nde Bukurèsht gjéndén mbi 20 mij serbe te ardhur, gjithe pothuaj punojne vréshta, é bulmètè, kush é di pè sa qindra vjété jane, thone sé jane pè 320 vjèt, flasin gjuhen é tyrê èdhé émerin é mbajne gjithe serber. Sè mund te bésojme sé shqipetaret é Italise u italizatne? Kjo s'eshte é drèjte, Kur keta te Vllahise punetore vobèke nuku humpne gjèndjén, si mund te humbase shqipetari, èdhé ca me shume asish shqipetare qe s'kishin zémer te qendronin nene nje zgjédhe tirani; une bésonj sè ata *sojlinjte* faré te medhénj, te'gjithe ikne a u bene muhamedane, rozgate si nèvé qendruam te krishtére, si s'na è vune véshne, mè qe duhéshé te punonim dhène. Ashtu pra, ata qe ikne, qène gjekafshe mé shpirt te larte; si èdhé ata béj'éret te sotme, qe jane muhamèdane édhe njerit édhé tjètrit i pa dréjtesojme ne thençim sè asi njeres humbasin kombesin è tyré. Keta na i deftéhu koha qe jane shqipetare te vertéte è qe duhén dashur shqipetaret é Italise, kete è bèsonj mè gjithe shpirt; po qe eshte i mire. Shqiroj a Ansèlmua, Sirimbé a Karoli étj. Kejo eshte tjater fjale, édhé mé kete udhe ké te drèjte te leftosh mè prova si pun' è Baldaçit è tè ilustri mik i Ansèlmos. Keto kam te thom, o vella, ne keto dy çéshtjé: zjoté jè zot ne pune tendè te shkruarat mbètén me qafe te kujt, èdhé me shume keto qe shkruhén sot ne nisjén é perlindjés se Shqiperise. Ndèri i z-satè é ker-

kon te mos kini lufte mé shqipetaret é Italise, dukè mohuar ate qe shqipetari ka me te shtrénjte; po kini te dréjte te shani ate vètem qe ndjèni sé ben politike te huaj te Italise, é cila nuku na jèp dore nèvé. Mè aqè fjale qe bera dykè dhene mendjén timé nde nje vella qe ê dua pa njohur qoretisht me féllesin è shpirtit tim kam frike mos me maresh per armik a grandoman, èdhè ajo do te jète nje nga te medhate plumba qe mar per dita nga vellèzerit te ketushme qe nuk i pandénja. Zoti Murat Béu Toptani gjèndét ne Brindizi Itali, Hotèl Cèntral via Garibaldi No. 18. Me shkruan é me vertèton qe shqipetaret è Italise jane te paqme; Ansélmon é ngrè shume; ka ndermend te vinje ne Bukurésht.

Te perqafonj mè dashuri dhè sa do te merzitésh ti une, do te te dua si nje vellaçko.

*V. Dodani*

*Bruksél 3 Prill 1900*

*I ndérshem atdhétar Dodani,*

Te falèm mé gjithe zémer per létren qe me berè ndèrin te me dergosh. Une zoterine tendè gjithe te kam pasur ne ndèrin me te math, si è provova èdhé boterisht, duke shkruar shume hère levdimé te dréjta per ty. Por Albanièn s'ja çova as zoterise tendé *as njériut* tjatre ne Bukurèsht as kembéva létra mè njéri aty, dhè per kete shkak:

Une èrdha ne Bukurèsht, dy vjèt me pare, te piqém mé ju. Bashke mè mua ish dhé nje sherbetor i Sulltanit, mé émerin Murat Toptani. Shqipetaret é Bukurésht, qe jane te pasur é hiqén si atdhétare, prishne nja 10.000 frenga per sherbetorin è Sulltanit, qi pastaj.. (m'a ndjé fjalen) u ngrit é vatè ne Stamboll; mua qi jam, sado larg, nje gjak mè Ali Pashen, une qe u rrita sa vjét n'Europe mè deshiren é Shqiperise, qe me

ne fund hapa i pari luften é jam dukè punuar è duké vuajtur qe pèse vjét, mua s'é gjykoj njéri mire tè me ndihe, jo per vèté po per fjalorin é Boçarit, qe donja t'a nxirnja è per disa te tjèra libra, qe présin te shtypén.

Pra, é kupetova dh'è mata atdhésin' è Shqipetarevè te Bukuréshtit dhè é gjykova me te ndèrshme pune per mua te mos kèm faré te benj mè ta.

Po prape thom sé kurre s'kam pushuar, ty te te ndéronj si é provovn per sa thashe tè «Albania», è po te falém mè mall.

*Frak. Spirobég*

*Bruksél 29 Noémbrie 1901*

*I dashur vella Dodani,*

Shume me gezové per ato létra qe me bere ndèrin te me shkruash. Po psè aqè ralle ? pse si nje djélle qe rreféhèt nje hère ne mot ? Per Princin e Aladros qe me pyété munt te te asiguronj sè eshte njèri shum i ndérshem è me dukèt sè qellimét è tija jane te lartra è te bukura. Eshte mire te kembèsh dhè zotroté lètra mé te. Ne do shkruaji nje pergezim per èmerin Skendérbég qe ka thèméluar i cili i-a tha sivjét nje bashkepunetori t'im nga Grékeria qe ka shtypur disa libra. Princi i Aladros dha édhé disa mijra frenga per nje karte dhèshkrimtaré te Shqiperise qe do te dale ne drite ne funt te Kalèndorit Eshte gati te prishe édhé te tjèra te holla, po kam frike sè mos è lodhin se rjépuri ca zuzare te pa-turpshem.

Ate Kolonjarin Shahin, per te cilin me pyét, s'di ç'te te thém se as une véte s'é njoh. Pra lé te présim. Koha na ka per te refyér sè ç'njeri eshte. Mjaft me hèlmove per ate fjalorin è math te te madhit t'one Kristoforidhit dykè mesuar sé ra ne dore te grèkevét. Te lutém, vella, te me dergosh nje artikull si ngjau

32/1



PRINCI ALADRO KASTRIOTI

Pas te shkruarat é sivellajt tim Faik Konices princ i Aladros ish njéri i ndérçme mé qellimé te lartra; ka shtypur disa libra dhé ka dhene mijra franga per nje Harte Dhé-shkrimtaré te Shqiperise. Nje gezim i-math ishté heperhe per shqipetaret, po é rembéu shorta!

BKSH

BKSH

kjo pune: Do t'a botonj ne kryé te numurit 1 te motit VI. Ne mos te vjèn ndorje te vésh èmerin tend, me dergo nje lètre, é andèj une nxjér nje artikull. Numurat é «Albanise» qe te mungojne t'i kam per te derguar mè gezim; po sot per sot jam duké vene ne kasèlla gjithe librat è karterat te tjèra, sè do te ndronj vent, po mé te vene punet mb'udhe do t'a plotesonj deshiren.

Te ngjatjétonj per vjérshat é Zykè Kambèrit, Jane te hieshmé po mbanj mè çupat é Shqiperise dhè s'dua t'i ègersonj.....

«Shoqeria é Bashkimit» ne Shkoder botoj 6 libra te cilat per se afermi t'i dergonj; pjésetaret è saj te nxèhte è te forte jane burra è do te bejne shume pune; une ca q'i njoh kane punuar; Abén' è «Albanise» è lashe pè dy vjèt é u bashkova mè 'ta. Eshte mire t'u bashkohén èdhè gjithe atdhètaret é mençem sé eshte turp ne syt' è botes se qytéteruar te perdorim nje abètar te ndyre è te èger si ate qe na nxuar kembe-lepiresit é Sulltanit. (?)

Zoterinjvé miq è atdhétare te fala. Te perqaf vellazerisht.

*Faik. Konitza*

Drèjtimi i Princit te Aladros:

S. A.

Don Juan, marquis de Aladro, prince de Kastriot

9 Square Lamartine

Paris

KAPTINA IX

# LETRA TE NDRYSHMÊ

*Bukurésht 30 te Korikut 1898*

*I nderuar Zoteni édhé mik*
*z. Dr. Turtull-béj,*

Lètren é z-tuaj shkruar me 24 te Korikut (stilit te ri) é mora mè shume gezim, é u falèm ndérjès qe me ndèruat mé vrap, dyké u pergjigjur ne létren timé.

Jam mé kurajo te madhè, me pare sé z-juaj me pelqéni politiken t'imé ne me te madhéa pjèse; po gjéndèm ne mèjtim, sé nuku mora vésh dot cila eshte ajo pjès' é vogel, mè te cilen z-juaj nuku pajtohi mè mua Edhé fatmires do te ishnja, ne z juaj do te ma çkoqitnit, gjer è gjate, mé prova per sè nuk paj-tohèni me ca shénja, qe keshtu, dykè deftyére njéri tjatrit udhen, te mundim te mérèmi vèsh é te mbli-dhèmi me nje flamur tok, sè ndryshè mundimét vène kotte, pa koha nuku nà prèt. Jèmi te gjithe shqipetare bijt è nje kombi mè histori te madhé, mè zakoné te vjétera édhè te ndèruara ngaj bot' é ndritaar èdhè du-hét te deftèhèmi ne bote cilet jèmi pa turp é mé goje te madhè,

Ne ate politike fatkèqé qe kèmi patur, duallme gjithmone te genjyèr; puna èdhé katandia si gjendémi sot na é deftéu mè téperice; qe ata qe kémi dashur nèvé me shume sè véhtén na é kane bere mè te pabèse.

Te me ndjèni ne è mora mè ment lajthitur, sè z-tuaj nuku me pelqèni pjèsen é vogel te politikes timè, dométhene persè ndahèm è shahém mè grèket.

Mê gréket shahèm sé ata nuku na duan te mi-ren tone, per véç sè dukèn sikur na ndihin per te shtuar kombin é tyrè, kombin grèk. Une kam bésuar qe grék dhé shqipetar jane dy kombè te vèçeta, qe-kur eshte bota, ashtu si eshte i véçte nje grék è nje françéz, a nje gjèrman. Péllasget, thote Hèrodhoti, qéne nje komb i vjéter dhé gjuha é tyrè nuk ngjisté mé Elinishten, ajo ishté barbarè. Pa, édhè ne vafshim mè ate idhè, qe na ka vérbuare gjér me sot, ç'do te fitojme? A eshte pune qe behèt te humbasim gjuhen shqipé? A, esht' é udhes valle névè te keti shèkulli te perpiqémi per te prishur nje naciune qe é vertéta é kerkoj te ronje gjér sot? Jèmi valle grèker, sé njo-dhén ketu ketjé nga ca pak fja'e Elinéshté, te cilat mbè-tèn ne lufte per te zbuluar, ne i muarme nèvè ngaj ata, apo ata nga névé? Po sa fjalera te huaja gjéndén ne per gjuherat é kombèvé? Persè véme me larg, kur Rumunet, qe ngjasin aqé fort ne gjuhe mè Italianet, a a Italianet mé Spanjollet è mè Françézet èdhé mè gjith ato émerin é k ne te vèçte, Shtetét i kane te ndara? Edhè ca mê fort, Serbet, Muntènégrènet, Bullgaret étj. Sllavone, qe jane faré te aferte nde més te tyré, dhè mé gjith ato gjithe kush mban mé madheshtori émerin é tij me vété è Sthètn' é tij te ndare? Pastaj per véç atyrè qe é kèmi dètyre t'i dime è t'i njohim véte si shqipetare, po édhé gjithe gllosollogět é me-dhénj nuku kane thene qe shqipetaret jane grèke, a prapkethi. Pa nde i gjykofshim punét pas luftavè, qe i kèmi patur gjithe bashke mé gréket, kejo nuku deftén sé jémi gjithe nje komb, pervéç sé ja ngaj névoja q'è beri njerin komb te ndjèke tjatrin, ja nga frik' é fuqise

ja sè po kane qene intérésat é njérit paralél mè te tjatrit ; pune qe ngjèt édhe mund te ngjase me ç'do pushtét nde gjithesine.

Jam kundra fjalese, sè mé t'u hèqur nga Grékët do te humbasime prindrit tane te lavderuar; Alèxandrin è Math apo Aqilène, te cilet mbètèn gjith' ata qe kane qene, te thjèshte Shqipetare. Une thom, ne zençime udhen' é mbare mè mê shume deshire, nuku vétem do t'i kèmi keta, qe kini frike mos i humbasim, po do te prishène tere monopollét qe kane bere istorit' è Grèqise, Serbisè dhé te Turqise mbi burrat te Shqiperise.

Nde eshte sè duhét te leftojme bashke mé 'ta kundre Tiranise, sè Shqipetaret kristiane jane te-paket nga musulmanet (idée é sotmé é pergjitheshmé afro ne Shqiperi te poshtmé) une nuku bèsonj sé eshte urte per kesyrésh idée fanatike, ne kete époke. Sé nde u befte Shqiperia igjèmoni, nuku do te behète mé fuqine tene, pa u trazuar Europa mè keshillat è saja. Kur Europa é gjén mire per te krastitur Turqine, eshte afer menç, qe nuku méndohèt te ngjalle nje Turqi tjater barbaré. Une bésonj sè, atehèré nje Princ i-huaj apo shqipetar i vendit do te na qèvérisnje, jo turk, a nde mos, po te pakene do te jète nje drejtesi, do te jène nomé, do te jète nje mbréteri è vogel rréthuar mé shtêté tè krishtèra, nuku si sot, mé Tyrqi te madhè, barbarè, po Shqiperi mè organisme è mé nom. Me dukét è téper gje, qe per te ketilla ngaja te durojme zgjèdhen te Grèkut, qe na mban lidhur kemb' è duarsh. Pastaj, Gréku, nuku do nje Albani, po as nje shqipetar makar ay do nje Gréqi te-madhé shtrire mbi dhé te Albanise poshtemé; sa per Albanin' é épermé a Gègerine nuku vètem, qe s'mér as nje kujdésie, po Grèqis' i simfèr te jéte cope, cope, nde Munténégrénet, Bulgaret, è Serbet! Kush eshte Sh»ipetar mé bèse te duronje kete fatké-qesi, kete turp ! ! Per ate karten' é Stambollit dergova t'i pyes èdhè po prés. Di qe Naim béu eshte semure.

Ndjéme ! Miku i z-satè

*V. A. Dodani*

*Brindisi 25 Gusht 1898*

*Vella memedhétar Dodani,*

*Bukurésht*

Kartolinat é zoterisatè i mora, Kur te vinj ne Bukurésht do t'u thèm çe me ndjén zémera per ndihmat qe me bete. Po, zoterinj, u a kam hua, jo vêtem keto po dhé shume te tjéra. Sè me kete dite nji vlèn sa nji mije.

Jéte paste memedheu! pa me sillni as si pika shijut ne dèté; E dini nji histori te shènte?

Sollomonit gjithe kafshet i kishin prur nga nji kaniske, édhé milingonja nji kam karkaléci i kish shpur; Sallomoni qêshi. Mos qèsh tha miza-perdhèske, sè per mua rendesij' é kesaj kofshé karkaléci eshte sa nje kafshe Kamilèjé per zoterinetaté! Edhé vellézrit é mi Shqipenise ashtu t'i ndihne. Ndihma jone per Shqipetin é vogel dukèt, po per nè, qe si jèmi sot mjaft asht, Pika, pika behèt dét, gur gur kalaja.

Po te çonj nje létre qe te ja çoni t'im vellaj ne Tirane mè adrésen qe di Dérvish Hima. Te lutèm kjo karte te véje shpéjt. Néser nisém per Napoli do te ri kater dit é pastaj do te vété ne Rome ri trê dit è do te vétè ne Bruksél.

Kam mare karte nga Spiro Bègu.... Akoma liksht shkruan per italianet. I ka hy djalli ne bark lanétit. Oh! sa do te rrihèmi mé 'te! Ashtu si do te rrihéshim ne shkolle ne Stamboll.

U perqafonj vellazerisht.

Jam gjith juaji. Te fala gjith vellèzen Zoterinj

*M. Toptani*

*Napoli 6 Vjésht' é pare 1898*

*Zoteni i ndérçme vella*

Lètrat é z-saté shkruar me 24 Gusht per mua é 29 Gusht per Confort-in i muarme mé gas te math. Ka nji jave qe jam ketu ne Napoli, i kam vû punet fort mire ne ruge. Mè shume deshire punon ketu komitéti per bashkimin é gjith shqipetarevè qe jane jasht Shqiperise.

Po bejme nje program qe ne kryjèt shkruam keto fjale: *Shqipnija vétem per kombin Shqiptar.*

Sa jémi do te kémi nje qellim, lirin' è gjuhes, bashkimin è te katre vilajétévèt me nji vétem. Nji rèkllam do te shkruhèt ne Bruksèl nga dor' e Faikut Konices é gjith shoket è Italise do te vène firme me kete rèkllam. E keshtu ç'do te thot gje tjatre i dashtuni Frank Spiro? Te Entén 6 Vjesht' è pare do te nisèm ner ne Bruksél, i kam shkru Frank Spiro bégut, i kam çu dhé nji vjèrshe. Me ndjèn zèmra nji gezim te math fort.

Vellazer, t'a zam mé fuqi kete hére, è shprésa ne Zotn' è madh; do te na dale fort mire; sa munt te thirrm é te zam Anglitèren è mos t'a leshojme. Né ketu è kèmi pa mè udhe, qe gjith komitétèt shqipetare te kémi nje qellim: lirin' é gjuhès shqiptarè ne Shqiperi é bashkim i 4 vilajétèvè qi thame me pare. Kejo asht nji pune fort é madhè! Po dhé juvé beji gati, meshtilli beni nji progsam t'a kini gati, qe kur te vinj une é t'u bije programin qe te benjem ketu mos te humbasim kohen kot. Shkroni dhé ne Egjipte shoqerise Misirit é Alèksandrise te jène dh'ato gati t'a dine dhé ato qe sot behèmi bashke per te miren é *sélamétin* é se dashures Shqipeni.

Ketu u kam then' italianevét shqiptare: A è doni te miren é *sélamétin* é Shqiperise? Po, m'u pergjigje. «E pra vllazen, u thash, Shqiperia sot esht ne rrèzik te madh. Ju po é shihni dhé véte, Sllavi po è melon

gjith dhèn! Shqipetaret po perpiqèn mè mish è mé shpirt é po zéne lufte mè Sllavin. Po Italia é Anglia a nuk humbasin ma shum sè shqiptaret? ç'i mbètèt Italis' è Anglis ne Adriatike è ne Méditèrane kur te mbushèn keto détera mé vapore Sllave é Ruse? Shqiptarin, qe é njéh Europa per barbar, ky komb po é shéh Europen te zgjuare è te qytéteruar qe Europa po flè ne gjume è nuk mèr armet ne dore kontra Sllavit.

Shqipetari barbar!! po è shohin qe lufton Sllavin me pare sé Europa é qytéteruare; si dhè ne kohe te Skendérit qe Europa flintè dhé zihéj njeri mé njerin, è shqipetari i varfen é i pak, thérèj mé Sulltanat ê mè Turqine!

U thashe t'i sherbèjne Shqiperise pa maske ne fytyre si bij te Shqipenis è jo mè qellim te huaj è mè mèndimè te fshèhura! E pra vella Viske, gjith è muaren fjalen t'imé mè énthusiasm é u gezuan è dhan bèse è ban bé qe do te leftojne per te miret e Shqipenis si na é ma fort sé na. Zoti asht i math!

Vella, keto dit qe u gjindèshé ketu ne Nèapoli ne vend te sillèshè udhes si zozaret, kam punuar mé nje grusht vllazen per memedhène dhè levdohèm sé è di qe do te me levdosh dhé ti.

Kam ba buston é Skanderbègut te math sa ish po thuaj. Ketu ma pelqéne, po te qisim forme do t'u dergoj nje juvè, dhè nji ne komitét qe [te jète nji suvénir i bashkimit i gjith shoqerivét. Kete bust è kam ba pas nji tablloje te Marqér Aulèttes é te Dora d'Istries é Konfort-it. Ishin tri, si njera dhè tjatra. Tabloja ish po thua si plak, une é bera me te ri è mvésha ne hékra sikur shekon armikne mè sy te ègersuara; po do t'a shihni.

Letra q'i dergové Konforti-t na èrdhi n'ate çasht qe po flisnim per bashkim. Fort mé kohe è mè vend na érdhi ajo lètra è ndérçmè; è kendova mè ze te larte; te gjithe rrahen shuplakat è thirne: Rofshin gjith bijt' è Shqiperis.

Te pergjigjémi ne émrin é Konforti-t dhè gjithe komitètes qe te falèn mè shume ndér. Une si jam per gjithe vllazenit è mi shqiptar è dini mir po dhè perseri u thêm qe ky i ngrat asht sherbetor i gjith atynéve shqiptare qe duan memedhéne è gjarper i tradhetore vét.

U falèm ndèrit è u perqafoj vllazenisht si dhé gjith te tjèret.

*M. Toptani*

*Paris 10 Sémtémber 1898*

*I-shtrénte Zoteni*

U ngjatjétonj shume nga zèmra per lètren te ndèrshem te z-tuaj prèj 28 Gushtit si dhé per levdimèt qe me beni ne te vjèfshem ditaré «Shqiperia».

E ngarkova librare tim te kerkonje dhé kerkonj édh' une véte «Shenderbèjne» pré Labardini. Po u lutèm do me lini nene barre ne me thençi te drèjten qe mbani shume n'édicièn pé 1597, sé jane 5 a 6 èdiciè me t'afermé qe munt t'ja u gjénj me shpét.

Kur «Skenderbégu» i Paganelit nuk eshte perkthvér qe nga vèperat latiné prè Barlétius po libre origjinalè.

Kur do te ngaje te me shkruani gjeagje, thuajmeni ne dini gjekafsh per nje shkronjetrègipe qe paska bere z. Eft. Mitkua per topografin' é Korçes, nje broshure pé shume kohe.

Sa te jém ne Paris thome-ni dhé mua t'u sherbènj me nonje nèvoje qe kini.

U a di per mire per No. 39 dhé 40 qe mi derguat sé me lipséshin nga togu.

Mè tere zémeren yti,

*Emile Legrand*

BKSH

*I shtrénte Zoteni Dodani,*

Mé kurièr' è sotmè, rékomandat, u dergova nje éksémplar pé Istorin è «Skenderbégut» prè Camillo Paganél. Eshte nje libr' è mire dhe mire shtruar dhé léhte per te kenduar . Mbésonj sè do te jéte m'é dobishmé ngaj ato te perkthyèrat nga frenkçja prè Barlètius é Lavardin, shkruar mè gjuhe te vjèter è mè koklaj é kenduara é tyrè esht é rende makar dhé per autore françèze. Istoria è Skenderbègut nga Paganél eshte fort è ralle, mos è pernda sè eshte rende per te gjètur nje éksémplar.

Do te me lésh ne bare ne qofte sè do me dergosh nje éksémplar nga broshur' è z. Benloev «Sur le rithm dans la poesie albanaise» tiraqi te vécét nga «Shqiperia», sé mbanj te kém nje livre te vogel qe s'ka te shitét ne Paris.

Mè gjithe zémer yti,

*Emile Legrand*

NJE LÈTRE NGA ÇAJUPI

*Kairo 4 Oktober 1898*

*I shtrénti Zot. Vis. A. Dodani*

Duké ju njoftuar marjén è se dashures s'uaj lètre mé date 8 Shtator te fundit, nxitohèm te ju kerkonj ndjése per vonésen è pergjigjès s'imè, vonése invollun-tarè, è shkaketuar prèj nje udhetimi qe bera. Dukè ju falendéruar pa mase per kompliméntat èdhè ndjènjat dashamiresé qe me shpréhni, ne radhen t'imé, ju lutèm te bèsoni sé z·juaj me inspironi rèspéktin dhé ndérin me te math bashke mé admiraten t'imé me légjitimé.

Ne keto fjale nuk eshte aspak no nje komplimènte é zakoneshmé, mè qene sé vêpra é shèujte qe

kini plotesuar mé zèll, mèriton jo vètem levdimèt por èdhè mirenjohtjén è gjithè shqipetarevé. Ne gjèndjén ku ndodhèn sot kato ndjénja, munt te jène, mbasé, te gabueshmè, por duhèt shprèsuar sè è arthmja do t'i ape te dréjte atij, i cili, si ju, i dèdikohèt mé trup è mé shpirt çéshtjès shqipetarè.

Jam i lumtur po te munt te vè dhè une nje gurr te vogel, nje gurriçke makar, ne godinen é kombesise s'one, per te cilen perpiqi aqê madherisht. Gjithashtu mé nje gezim te math, me pelqèu te pasonj dhè une mé fuqit é mia te vogla levizjén madheshtorè qe behèt réth kesaj godinè sa é sa me te madhé, nga mjéshter te çquar dhé te mençur qe punojne atjè, dhè è vètemja deshire qe kam eshte t'a shoh nje dite kete vèpre te plotesuar.

Mbanj te ju siguronj qysh tash sè ne sa perkét gazèten „Shqiperia" pranonj pa as-nje rézérve pllanin èdhé politiken è saj tuè qene sé me pelqèjne plotesisht idhéte qe ajo prokllamon édhé mpron mé aqe te madhé kompéténce. Ka ketu shqipetare te cilevé kjo politike intransigjènté dhé radikalé nuk u pelqèn. Por sa me perkét kam bindjèn intimé qe s'kèmi kurgje te perbashket mé fqinjet t'ane turq édhé grèker. Te transigojme mè 'ta eshte nje paburni kur shohim humbjén t'one dhé sjèllja è Shqipetarevé qe méntojne ndryshe, me dukét tèper èkuivoke.

Duké mbaruar ju falém ndèrit nxéhtesisht per dashamiresine mé te cilen kini pritur artikullin t'ém mi abéçéne, dhé te cilin miresia è juaj è gjén te dénje per gazèten t'uaj. Sinqérisht ju thom sè perkthimi q'i kini bere atij artikulli eshte admirabil, vèçanerisht po te marim parasysh péngimèt è medha qe ndalin shpréhjèn lètrarè dhè skènsorè ne nje gjuhe è cila, nga kjo pikepamjè eshte akoma ner fasha. Por lèhtesira mè te cilen z-juaj é shkruani gjuhen t'one eshte nje prove me shume sè ajo eshte é perdoreshmé per ata qe è njohin thèllesisht, dhè é zonja te arije nje dite nje gjuhe skèn-

corè. Prandaj véndosa te mérèm mé mesimin é saj sériozisht dhè pa rèshtjé.

Kam patur me shume hasjé mé doktorin Turtulli Bèj dhè zotin Nikolla Kyriaku te cilet m'u dukne mjaft dashamires te marin pjése ne deshiren t'imè per te perkrahur mè influéncen é tyrè gazéten t'uaj ne Missir Nga ana imé do te mérém sériozisht per te plotesuar ate qe é konsidéronj si détyre te shénjte perdréjt gazétes.

Kam dhé nje lutjé te fundit: te me dergoni dy vllimè te «Historise è Skendérbégut» ne vjersha, prèj Naim Bèut, te cilin pata rastin t'a njoh pèrsonalisht ne Stamboll ku kam nje xhaxha avukat te qojtur Géorgés Tchako. Jam nga katundi Shèpéri i Tépèlénes. Ja nje paraqitjé è shkurter; duké shprésuar sé do te kèmi ndo-nje dite rastin è lumur te njihèmi pérsonalisht, ju lutém, i dashur zoteni, te pranoni shpréhjén é konsidèrates s'imé me te çquar.

*A. C. Zako*

P. S. Mé poste do te mèrni fr. 25 per pajtimin t'èm ne gazêten «Shqiperia».

## NJE KUJTIM NGA GÈNÈVA

Me 24.12.1898 mora nje létre 6 faqèsh nga Dr. Turtulli bèu, gerqisht. Létra nistè keshtu :

*Z. Visar Dodani*

«Lèçitme ne nje fléte qe dél ne Bukurèsht nga nje zot Dhimitri Ilo, i cili te shan ; te keshillonj te mos i pergjigji ne gazéten t'uaj «Shqiperia» nje njériu si D. Ilos ètj.» Pastaj me shkruan, qe te mérém vésh mè Naim Béjne nde K-poje dhè mè te tjére disa shoke te ndérçem nde Bukurésht dhé te véme nde Viène, ku gjéndét Béroviç-Pasha, qe kish hikur qe nga Kréta, te fillojme nje program te pergjitheshmè dhè shume te tjèra. I shkrova Naim Bèut dhè m'u pergjigj shkur-

ter: «Hiq dore nga ay njéri. Doktori eshte nje drèdhak. E njoha ketu".

Mè te vertèt zoti Mjèk Turtulli s'ka desheruar te ndahèmi nga gréket dhè te mbétèmi shqiptare te paket per kunder Sllavevèt Bullgare dhè Serbe dhé te largohémi nga Ahilèa dhè Aléksandri i Math, qe u trazuan dhé u quajten nga gjithe shtètét é qytéteruara sé jane gréker. Per keto ngaja te medyjeta me zotin Dr. Turtulli, Shqipetaret è zjarte s'kishin bèsim te punojne mè nje te qojtur grékoman.

Me 1919 z. Mjèk Gjorgji Adhamidhi jépté nje konférénce nde Génévе ne Batiman dhé ftoj te vinje nga Llozana dhè z. Turtulli Bèjne. Atjè isha dhè une. Zoti Konfèrènciar Dr Adhamidhi mé te cilin kishim katre vjét qe punonim bashke ne çèshtjèt kombijaré, è gjéti mire te me ndèronje dyké sjélle per krahu zotin Mjèk Turtullis-Bèj dhé me truhu mé gas: Urdhero! «Ky eshte Dodani!» nje nga nisiatoret è çéshtjès kombjarè ne Bukurèsht. I zgjata doren dhé i thashe: «Vertét njihèmi mé létra qe perpara dhjète vjèç, kèmi patur lèter kembimé zoti Mjék, kur nxirnja «Shqiperine» nde Bukurèsht.» Po nuku dita dhé as sot nuku di persé z. Mjèk Turtulli Béj m'a hoqi doren dhé i tha zotit Mjèk Adhamidhit perpara mèjè: «Une s'è njoh faré kete njeri, s'kam patur fjale as korèspondènce mé kete! Eshte shum' i vogel per mua», dh'u largua. Zoti Adhamidhi mbèt perpléks, po as un' é dita ç'ngjau. Prandaj si kronikar, é shkruanj dhé kete bashke mé korèspondéncen doreshkronje origjinalé. Koréspondèncen qe kam patur mè zotin Turtulli Béjne é kam vene nde te tjèrat lètra origjinalè korèspondènca qe i kam gati mè prèmtim qe do t'ja dergonj arhives se Shtétit Shqiptar si te mbarohét se shtypuri biblla «Mémoriét é mija».

TE TJERA LETRA

*Roma 8 Gusht 1899*

*I ndérçem Zoti Dodani*

Mora vivllen «Mjalt è Mblétes» qe me dergové te muaj' i Prillit nani shkuar; te haristis mé gjith zèmer.

Menova te te shkruanja persé kam klene ktu ktjé per te bera te spiis timé; u lutém te me ndjéles.

Esht pun' è madhé sé shqiptaret te bègate (te quashme) nuk japin faré ndihem memedhétarevét, per punera kombjarè. Banqèret grèke kane dhene paseqir ç'esht te behét per gjallm è kombit. Shqiptaret gjith sa jémi mysliman é te krishtrér do kèmi gjith qellimin shèjt te ngrinim situaten nga dhèu ku eshte shten Mema, jan haruar.

Bilet é Shqipris jane trima, veljèr mê sé te tjéret na mbahèn lidhur vellèzerit, ne pak kohe Shqipnia do mérr pashin vent é do mbrèteronje mé tjérat gjinda qe ndodhén ne sinisit é Ballkanit.

Sot per sot névoja è madhè é Shqiperis eshte te kète shkolle è kishe kombjarè. Tè shkolla mèsimi do jèt atdhêu ne gjuhen shqip, è tè qisha lutjét do thuhèn sikush gjith shqip si ç'kane gjégjur nga mema q'i ka dhen sis.

Flèta, vivlla mesimi, Biblla é Korani kthyèr ne gjuhen shqip, do jén ven ne duart é ne siit te gjitha shqiptarisht.

Mè shkoll é Qishe komhjaré Shqiperia do lulezonje nji zê é munt te vihèt bukure é stolisur tè ila è tjèravèt kombè te qitéteruare.

Shkolla é Qisha kombjaré do sherbênje édhè te mos japem doren te huajvét te hiinjén tè shpia jon sat ven, thon ata nen hen é atirè shkollt' é Qishet é

tiré. Ajo hè esht farmakosur (è hèlmuar) è ben dem i math Shqiperís.

Vení njize ne duart tona shkolle è qishe.

Te shtrengonj doren vllazerisht

*Antonio Krispi*

*Tripolis bejas 17 Janar 1899*

*I dashuri Zot V. Dodani*

*ndé Bukuresht*

Ditetarén No. 55, 31 Dhéqémbrit te motit qe shkoj è mora. Bésonj sé do t'e kém règullat. Perkujdèsém è kupetohém mè disa te pake shqiptare po te mire atdhètare dhé s'kam medyjè qe per pak kohe do te mundim t'u pergjigjémi per ç'fare-do qe te jéte névoje. Ne qoft' é shtypur istoria é se dashures tone atdhèjes dergoma-ni mua dhè shenoma-ni çmimin.

Zotí békofte te shèntetin qellim bashke mé punetoret è syré.

Dergimèt t'i beni nga hèra: udha Paris qe te mos bihén ne poste te Turqise, po ne te Frances.

Njeditzaj derguan ne perzim nje djale nga Shkodra i cili mesontè ne shkolle te Pigrovolévè ne K-poje nga perséja q'è zune mé ditetaré dhé mè biblla shqipé, t'é dini.

Mé ndér,

*Efthim Tsakos*

BKSH

*Bukurésht 30. XI. 1898*

*I dashur Zoteni E. Legrand*

Ju lutém te me falni qe nuk ju bera pergjigjè mé kohe ne te dy létrat t'uaja.

Ardhja midís nesh te dy vellèzervé te shkelqyèr Murat béj Toptani dhé Faik bèj Konitza, eshte nga shkakét kryèsoré te kesaj vonésé.

Mė shume gas po ju dergonj te dy numurat te gazètes s'imé qe m'i kini kerkuar.

Per ç'do véper qe do te trajtoje mí shqipetaret dhè do bjére ne duart é mia, te jini i sigurte sé do t'ja u dergonj mé nje hère.

Sa perkét Historine è Skendérbéut, nje botim pak me i ri do te ishté me mire, sè botimi i 1621 do jéte bésonj, me i rende per t'u kupetuar, dyké mare para sysh sé gjuhen frengjishtè nuk é di krèjt mire. Ne rast sé nuk ka tjéter, dergomeni botimin é 1621.

Juaji mé ndérimè dhé dashuri

*V. A. Dodani*

*K-poje 17 Maj 1899*

*Zoterinjt é vellézer te dashur*

Mé qe u kèmi vellèzer te dashur, mê pare shpèj-tojme te pyésim per shendètn' é zoterise-suaj, dhè Zotit Math kete gjithnje i falèmi dh'i lutèmi. Sa do qe nuku kémi pare njeri tjatrin, po njihémi nga zèmrat, nga farefisi dhé nga émbri qe kémit Shqipetare. Ah! sa i bukur émber!... Ju paçim o vellézer per jète! Sè, mire-beresit tane Zoteria juaj ini.

Kete kurre s'è harojme. Z.-Juaj mundohi è per-piqi jo vétem per né, per tere kombin shqipetar. Po né persé te mos u ndihim dhé te punojme mè ate fuqi qe kémi?

Te 8 biblat qe derguat Z. N. Vrionit quajtur «Mjalt' è Mblétes» mé ndihmen tene è mé te tjérevèt u shitne. Edhè sikur te dergoni é ca te tjéra keti zotit qe thame, jémi te ngarkuar qe t'i shèsím èdhè sa do qe te kini sé ketu shikojme qe tere shqipetaret kane nje deshire te madhé per te kenduar; ju paçim per gjithenje, édhé Pérendia u dhente jéte te gjate, qe nxuart kete bible èdhè ju vajte mbare per te nxjére dhé te tjèra me te embla nga ky mjalt....

Eb, mbajé shprésen gjithenje o zémra jone!..»

Memedhètaret te kthjèllte é vellèzerit tuaj

*Toké Téli & K. Joséf*

Dergoni bibla, lètra mé adrésen Signorè Davélo, posté réstanté, a la posté Alémande, Stambul Galata.

## LÈTERKEMBIM MÊ N. VRIONIN

*K/poje 4 te Shkurtit 1899*

*Memedhétar i dashur Zoti V. Dodani*

Karten é bukur te dashur te zotris s'uaj mè gezim te math shum' è muarm, édhè duké kenduar ndjéjme gezimé te medha shume nga miqesia memedhètarisbté qe na deftèni. U lutèmi te na ndjéni per vonèsen è pergjigjiès gjér tani, sé kur muarm te ndérçem karten tuaj ishim pak semure, dhé gjér tani mèzi muarm véhtèn, dhé mè te paren é punravét u-shtrenguam per te pergjigjur Z-suaj. Mè qene qe na shkruani nje karte fort miqesisht é vellazerisht si nje memedhétar i vertète. per vèç sè na pyésni, po kishim dhé nèvoje t'u deftèjme nga jémi dhé cilet jémi. Une, zotni, jam shqiptar toske na Bérati, jam nga familia è Vrionit, masè kini degjuare, dhé me quajne Nyzhét Vrioni; sikundre ju kishim shkruar dhé me pare, ketu ndodhémi nxenes ne nje shkolle te-madhé te nemur te halldupevèt.

Per *bése,* mos me pyèsni, sè nga è cila jémi entérèsaturi, familjen è kèmi myslimané. Jam afro 20 vjétésh; gjashte vjèt me pare, qe kur isha ne Bèrat. im ate vuri nje mesonjes qe me msoj shqipén. Me pare kisha mesuar turqishtèn dhé frengjishtén, te cilat ndonesé te huaja i di me mire nga shqipja, sè i kam msuar mé règulla. Motin qe vjèn mbaronj ketu dhé per «étude supèrièuré» kam qellim te vétè ne France, nde Paris. Si mesova shqipèn, te shkruarit é te kenduarit mire, nga familja jone dhé nga kusherinjet, djèm è çupa, me shume sè 20 shpirte, ju kam msuar gjuhen è memes te shkruajn' é te kendojne, dhé keta keshtu i kam bere shqipetare: sè si kundre qe munt t'a dini, ne Shqiperi, shqipetaret myslimane s'dine tjater gje véç bése myslimanllek, dhè gjuhe arabisht dhé turqisht, dhè te krishtéret bèse orthodhoksine dhé gjuhe gerqishtén. Sa per bésetè s'thom gje. po gjuhet grèqisht é turqisht dhé per kombèt é tyré turk é grèk i kam shume armiq dhé gjith i kujtonj é i méntoj mé te mshtira. Me ngjan sé ç'do shqipetar, qe ka ment dhè di ç'do te thote komb' é gjuhe lipsét keto te dy kombè dhé keto dy gjuhe t'i két' armiq per vdèkjè. Sé keto ruajne dhè kerkojne te na humbasin gjuhen tene te bukur dhè turqit é grèktit kombesin é shénteruar; po me shume sè ata na kane nene domination; ata mundèt te na è bejne varre mâ te math sè u vjèn ne dore; si po i shohem.

Qellimne qe kane per nè te na léne ne varferi, ne padituri è armiqesi, qe te copetohemi, Zoti ja-u dhent' atyrèvé mbi koke, dhè pesofshin me shume sè né. Biografia jone dhé sèntiméntat tona jane keto, te mos u lodhim mê tèper.

U lutémi te na ndjèni sè s'ju deftyém me pare émerin é vertéte, sè s'pandèha qe do te na pergjigjéshit. dhè me shume vendé pé shoqrivét gjithe mé ate èmer jèmi njohur. Pa, kush na eshte pergjigjur si dhè Z-tuaj na kane njohur keshtu.

Per pune te shkronjavét shqip qe na pergjigji gjer

é gjate, ju thom qe une s'jam ne mendjè qe shqipja duhét doémos shkruar mè shkronjat è «Diturise». po une shikonj sé kushdo qe shkruan gje shqip ka dhé shkronjat è tija, si te Shkrodres, te Kristoforidhit, per vèç shoqèrise Bukurèshtit «Dituria» mè ate te Sofjés qe kane shkruar nje sume préj 30 farésh libra qe ato jane me te shumat dhè ashtu ay sistém duhèt mbajtur gjér te mblidhèt nje akadémi qe te nxjère è te zgjédhe nje pale shkronja.

Une s'jam fanatik per shkronjat è «Diturise» dhé z-tuaj na shkruanit qe «Qerbelaja» q'u shtyp pardjé do te shtypèj mé shkronjat è rèa, psé u shtyp mé ato te «Diturise»? Dukét qe dhé z-tuaj atjé s'kini bashkim. Po ay Yll' i Shqiperise qe dolli aty ç'ben, ç'shkruan ? te tjèret vuajne per te simplifikuar shkronjat shqip dhe ay do te trazonje me tèper; s'i dalin keto; shan é perqésh shoket. Kejo eshte nje è méte é-madhé dhé fort turp per shqipetaret qe kane nakar njeri tjatrit dhé s'mundin te shohin mè sy te miren; lérè ne mès tene po dhè ne syt é te huajvét, t'Europes; qèshin mè né dhè na thone barbare si dhé haldupevèt. Por per shkronjat qe ka krèjtur s'marrim vésh dot ç'qéllim ka? Dukè patur *q* psé te marim *kj* dhé te tjérat me kêq ?

Na shkruani sé allfabéti jone duhèt te jéte llatinisht sè keto shkronja jane te pergjitheshmè si dhè me te léhta sè gjéndén kudo, sé Franca keshtu shkruan dhè sé te tjéret shtètè po léne te tyrèt dh'i kthèjne llatinishté; kete nuk è mohojm' as nèvé per 36 shkronja qe jane shume munt t'i mbushnim mé ca shenja. Po sa te mundim difthongat t'i kémi te paka. Fjala *véhte-véhtés* s'eshte drèit, duhèt *véthe-véthés* po atehèrè kendohét ndryshè, duhèt gjétur shkronja. Te me dergoni tere numurat te pa-lidhura te «Shqiperise» mire mçèlle me èmerin Miko Sqyfter. kunati im, i bir' i Hajrèdin pashe Janines qe ka t'imé motre. Adrèsa Miko Squftér Posté-restanté au Bureau Autrichien K-ple.

Ne duhén te tjèra te holla shkruani dhè ju dergonj dhè me dergoni bulèten ne adrésen Monsieur

Niko Vrapi Libraria Carabette rue Sublime-porte. Kostantinople.

Dyké pritur pergjigjén é Z tuaj u perqafojmè ve llazerisht dhé u falémi mé ndér.

i tere juaji

*N. Vrioni*

*Bukurésht 20 Shkurt 1899*

*I shtrénte Zoteni dhé vellaçko i dashur*
*N. Vrioni*

Lètren te ndèrçmén tendè qe 4 Shkurt è mora mé kohe, po s'munda dot t'u pergjigjèm per fet, sè jam plot dêtyra; duhèt te me jépni moratorium, kush me do, gjèr te kém ngé èm te shkruanj ne gazète dhé te pergjigjém ku duhet.

Ato qe u mungojne dhé ç'me kerkoni do te ju mbushén. Te paça shendoshe dhè te puth syt' é gojen qe me lajmeron kaqè çiltash è çkoqitur biografine dhè te tjèrat hollesira te véçeta, qe me mbushne zémren plot kurajo. Ne verste tuaj isha dhè une kur nisme disa djéma konshkollare te perpiqéshim per serishlindjén è kombite tone ketu me 1881; po qe te flas mè bése: une kisha frike nga myslimanet (turqit, si quhé shin vêhte vellèzerit tane ne Shqiperi).

Po shoh qe nuku versta è paskerka fajne, fatkèqesisht dituria qe s'è kishim te dlire. Ku pandéhnim né te gjoret, sé juvé na dashkerki si vellèzer qe jèmi vertèt? Né kristianet, gjithe dinim gjesént per vellazerine te njehèreshmè; prindrit na deftènin sé kur vinin ur dhia tyrqesh, kur è kur, ne Korçe vinin neper kasaba (domèthene neper myslimanet) mfshihéshin atjé grate tona dhè plèqte, dhé nga ky shkak grate tona mé myslimanat ishin bere motra, dhé kish mbètur zakoni qe névè pashkevét dergonim neper motrat kulèç è vèze te kuqé, dhé Bajramèvé na dergohéshin fare faresh

hembelsira: *asherasher* étj. dhé linin te kupetojme sé névé nje hére kèmi qene motra è vellèzer. Po kejo butesire qe na pelqènté dykè degjuar nuku mbantè shume; sé piqèshé mé Béqir pèmaxhine a mè Isuf nallbatne dhè i thoshèt «Po névé jèmi vellèzer tungjatjèta;» pernjérjés te ç'ndéronte: «Susjabana kaurr, te kam lark 40 vjét nga dini!» E si te mos késh frike nga turku? Nèvé djémuria, qe zjénim ne mès tene qe te shpetojme njére nga zgjèdha tiraniké, shprésat i kishim nga grèket a nga no nje ngjame Europjanè; ku e dinim nè te mjéret, sè ka dhè turq (mé fjalen t'uaj: Turrk el-ham durula) sé dhé myslimanet jane shqipetare, vellézerit tane qe zjèjne me fort sè nèvè! Po nuk Béqiri dhè Isufi fajtonté, po vérberira dhé padija ku na lane tyrqit halldupet, intérésat è huaja, po, i math eshte Zoti; dukét qe afroj drita dhè pèr na.

Sa per ate qe çpalli nje apo dy numura te njej gazété «Yll' i Shqiperise» qe shan é perqésh shoket, u thom qe s'duhèt zene ngojes; eshte nje i pléravèt, ketu é dine te gjithe; é kèmi patur ne shoqeri mè roge qe te na mblédhe pagimét é permuajshmé dhè po mblithtè 300 franga, 3 muaj s'é shikonim te na sjélle para; pa n'i théshè psé nuku sjéll parate qe ké mblèdhur? thoshté 3 muaj nga 100 roga bejne 300 franga, pra ay eshte i ndérçme, po un è nxora jashte nga shoqeria ja kisha dhè mellene sè kishtè bere dhè nje maskarallek: mçjélle ne nje lètre dhé ja dergoj z. Faik-bé Konices, nje buri qe po nxjèr rèvisten shqip é frengjisht ne Bruksél, mé nje kudhim é nje zjar kombesié. qe s'benèt i dyti djale. Ky saraosh, ky i plèravé na gjèti te mèta mua dhè Faikut.

Sa per fjalen *véhté* qe u dashka *véthé*, s'mund te dihét cili dialékt eshte m'i mire, nèvè ne Korçe thomi per véhté, po per ata qe duan *pervéthé*; qe te mos thohèt ndryshè, lé t'è shkruanj *pervétehé* si thohèt: *atehéré* apo *at'hêrê* dhè nuk *athéré*.

Sa per allfabéne q'è beri nje shoqeri ne Stamboll, un' é di qe vertèt qè nje shoqeri pré 8 vétash qe te

shkruajn' è te kendojne gjuhen po abèçèja ish njètash bere gati nga I. Vrétua i cili é mbajti mè zémerim é mé argumènta, qe ay mé kete sistème dęsh te pajtonje Orthodhoksine. Kristoforidhi nuku dèshté faré sllavçét é Vrètos dhé qèshtè mè to. Vaso Pasha Shkodra as i désh as shkroj mé shkronjat é Vrètos, Vaso-Pasha shkroj mé llatinishtét; kerkohè atjè bibllen è Vasos dhè do te shoç. Mèhmèt Ali-Pashe Bèrati qe te mos hapèt çarjé mé Naimne tha qe qellimi eshte te shkruajne nje hére, pastaj do te gjèndét m'é mira qe te mos ja príshin Vrétos plakut qe bisèdonté mè meni; kete gje ay é ka pré 1879 dhé nuku pè 1884. Prandaj è lane te Vrètos i cili dhé é thoshté: qe av dèsh te pajtonje Orthodhoksine. Po, Naimi dhé Méhmèti dhé une s'kèmi névoje te pajtojme Orthodhoksine as Vaso Pasha.

Keta zoterinj, qe me rane ne sy psè mora llatinishtén, s'me thane *érétik* si Vrètua po me dhane te drejte, vétem qe s'bera mire sé ja qe u shtypne keshtu qe se pari, ja qe keshtu u mesuan. Kejo *ja qe* deftèn nje pèndim, dhé une s'jam mé mendjén te vètè perpara i pènduar, po kthènèm ne te drèjten, pa kur te mblidhèt Akadèmia è di qe do te ndréqèn, pa prape do te ndrèqén si shikojme dhè te tjèret.

Si do qe t'u dukét pergjigjia imè une u lutèm te mos me merzitni, po te me lini tu perqafonj si vllaçko.

*Viske Dodani*

LÊTERKEMBIM MÊ PRINCIN GJIN KASTRIOTI

*Bukurésht 9. XII. 1901*

*Naltesise Ti Prénk Gjini Kastrioti*
*á Paris*

*I-lartere!*

Po si nj'yll i ndriçme q'héq veshtrimin é botes ashtu dh'èmer' i Lartesise-Satè ka hèqur syt' é shqipetarevè atjè kudo qe gjéndèsh. Ne te ketille hêrresire q'eshte Shqiperia sot, drit è yllit shqipetar, qe dél béfas tani, na deftén udhen è shprèses dhè te kurajos.

Kastriota! Skendérbeg! èmer i bukur, ngushullim i te mèkurit komb, mire sé ardhé!

Pronj' é zotit q'u perkujdés te U defténje sot, U prufte ne stoll te stergjyshevé, dhé une t'u bié ne fron é t'u puth kembet dyké thene jam i perrunjuri sherbetor

*V. A. Dodani*

*Paris 17. XII. 1901*

*Monsieur Visar A. Dodani*
*Bucarest*

*I shtrénjte memedhétar*

Mé gaz te math mora te bukuren t'endè lètre dhè te ngjatjètonj mè gjithe zémer per urimèt é bukura dhè te mbara qe me ben, dhè te ndèronj per memedhètaresine te flakte qe po rit ne shpirtin tend.

Daljèn timé ne shésh, te pervéshurit é duarvé mija per Shqiperine, nuke munt t'a jap gjètke, pervèç sè té ajo pika gjak qe me levrin neper trup préj stergjyshit tim, dhè te nje fuqi è pérendishmè è cila me

shtyn dhé me trègon vétem udhen è te se mjères t'one Shqiperi.

Dykè shprèsuar sé do te me gezosh hère hére mè létra, te benj nje mije miqesi.

«Pèrendía bashke mè né»

*Gjini*

## NJE LÈTRE NGA SOFJA

*Sofie 23 Vjésht' é dyte 1901*

*Zoterise Tija Visarion A. Dodani*
*ne Bukurésht*

*I ndérçime Zoteri*

Plèqesia è shoqerise mesimit shqipetarevét «Deshira» ka ndèrine t'u lutét mè kete cope léter, te kini miresine dhé te na dergoni nga nje numur préj te gjithe numuravé te ditarès Zoterise-Suaj: «Shqiperia» sè ka nèvoje shoqeria jone t'a kète kete biblle te vyère ne bibletorèt te saj, ashtu dhé nje cope nga «Mjalte é Mblètes» , per te cilat do t'u dihèt per te mire si ndihme ne kete shoqeri mé qellim te shénjte.

E mira eshte te mundté dot t'i paguanté shoqeria, po mé qene qe esht' è varfere, sé nuku numuron me shume sé 70-80 shoke, te cilet jane gjithe punetore dhé nuku mundine te paguajne dot me shume sé gjysme frengè, andaj i kerkojme dhurate keto biblia qe na duhèn per te kenduar shqipetaret e varfere.

Mbésojme se nuku do t'u vinje rende ky sherbim qe do t'i mbaroni shoqerise tone è cila do te mos u haronje èmerin è Zoterise Suaj per jète te jètevét.

*Kryétar, K. I. Trébicka*

BKSH

## KAPTINA X
## PERPARA INDÉPÈNDÈNCES

### NGA MISSIRI, SHQIPERIA DHÊ AMÈRIKA

*Fasu (Egjipte) 8 Janar 1907*

*Miku bashkatdhétar V. Dodani*
*nde Bukurésht*

Se pari ju deshironj motn' è ri te mbare. Pastaj u lutém qe ne kete kohe te veshtire, si qendrojne punerat, te perseritni perkujdèsite per shpetimin è se dashures tone atdhéje. Z tuaj si i mesuar dhé punetor njèri, mè gjérinjte qe kini, mé bashkatdhétaret te Rumanise, dhé né te Egjiptes, te bashkojme fuqite tona mè nje qellim: miresimin te se kèqés gjendjé te se dashures tone patridhe. Nje haraktér i-paqme, nje shqiptar si Z roté, mè ndjénja te gjalla, te flageta, si ju pashe qe kur isha ne Bukurèsht, nje haraktèr i hékurte si tuaji, sa pune munt te benje kur do te punonje!

Sot esht' ajo mê é perjishmja klipe, qe te deftéjémi si sterniper te nje kombi te math, sterniprit é Burros, Lékes dhè te Skendèrbègut.

BKSH



LUIGJ GURAKUQI

Atdhétar i degjuar mé fame per kombetaresine è ti. Luftetar i-math dhé mik i.pandare i te madhit burre Ismail Kémal Vlores.

Lajmét é 'ti qe me dergonté qe ngá Nissa me 1912 u vertètuan, po s'arriu mire te gezohèt shpirt' i ti; dora kriminalè ja shojti jèten si te gjithevè deshmorevèt.

I perjèteshmè qofte èmeri i ti.

BKSH

Miredashj' é deftyer, politik' é Romanise per shqipetaret faqè Titonif dh'Austrise per nje qévè:im autonomik te Shqiperise nuku duhèt lene fjètur; gjaku i dérdhur i vellajt tone Spiro Kosturit édhé i shume te tjérevé, deftéjne nje métesi te kombit tene, qe s'ka fjètur tjatre hére pa mare gjakn' è deshmorevét. Kombi duhèt te defténje qe rrojme dhé duam te shpetojme nga dy tirane te keqinj, ingrater, qe njerin ê shpetuam dhé tjatrin po é mbajme. Duhèt deftyér qe rrojme si njères è nuku si kafsha. Ahéré dh'Europa do te qéshe mè névé, kur Austro-Italia é thane çiltazi, qe duhét te ndronje jéten Shqiperia qe te mare dot autonomin è saj.

Pra èce perpara, te deftéjme qe rrojme si popull dhè méritojme vèteqévérimin.

Me falni qe flas per ndjènja, po ne te ketille gjendjè te kèqè, gjaku zjén.

Per kete dhé zoteria joté, vère tere fuqite te gjallat, qe mban shpirti juaj fisnik dhè dituria juaj; dhé lèri me njane menite é vèteta, mbuloji ne varr, perpara alltarit te patridhes, te Shqiperise!

Punoni bashke dhè çfaredo qe shartoni juvè è kallezoni ne Sofje, Egjipte, Amèrike, qe t'u ndjékin pas. Mos humbisni kohen, po hiqni dobi nga miredashja è vendit mê shpét, sè dipllomatia nderon programat.

Te perqafonj memedhètarisht.

*Dr. G. Adamidi Frasheri*

*Elbasan me 1 Mars 1909*

*Atdhétar i shtrénjte V. Dodani*

*Bukurésht*

Réndim sot mè ane te kesaj lètré mé ju shfaqun nga mèzi i zèmres falndèrjèt è jona per ndèrin qe na bâte tyé dergumun pèsmbedhéte cope: «Mjalt' é Mblè-

BKSH

tes»; flètoré qi na bâni, duhét t'ä thèmi, nje pershtypjè te bukure è qi è kenduame mè nji ambelsine te plote. Do t'jèmi te lumur è fatbardhe, or Zoteni, te shofim èné te tjèra punèsa vjèrshesiè te dalin prè dores te Zotenis s'uaj, i cili mé nji pende kaq te shendoshe é mé nji fuqie vèrshetori, qi dukét shéshit, vjèrshon mé shijè kaq te madhè,

Ju falèmi ndèrjés per méndimèt é bukura qi kini per Elbasanin é per kllubine jone,

Mbètemi mé ndér shume é ju shtrengojme doren me mall.

*Nga shkrésetorja é Kllubit «Bashkim»*
*ne Elbasan*

*Boston Mas 28 Shen-Endré 1911*

*I ndérçim Zoti Dodani*

Ju perhironj nxèhtesisht per pritjén è mire qe me bete ne Bukurèsht, per simpathine qe me deftyèt. per naten é paharruareshmè qe shkuam bashke dyké kenduar «Serben é Zuzarevè», dhé per ndihmen fisnikè qe me dhate per libren fètarè. Zoti ju a çperblèfte mè nje mije te mira.

Dykè ju uruar motin é ri te mbare, mbétém

Juaji mé bése

*† F. S. Noli*

Box 2445 Boston, Mass

NJE LÈTER È LUIGJ GURAKUQIT

*Bukurésht 19 Novémbré 1911*

Luigj Gurakuqi, i gezuar qe pati ndérin te njihèt mè Z. é Tij V. Dodani, i len shendèté mê te nxéhta è è ngjatjèton mè ndèr.

I vjèn kéq qe nuku mundi t'a piqtè édhè nje hére po è siguron sè do te kète gjiih-mone per 'te nje ndérim te véçante.

*L. Gurakuqi*

*Nice (Rue de France 98) Kollozhek 1912*

*I ndérshem z. V. Dodani*

*ne Bukurésht*

Ju kerkonj ndjése sé nuku kam mundur te ju shkruanj gjér me sot, psé desheronja te ju jipnja édhè ndonje lajm te mire mbi punen qe kémi nisure é mbi perparimin è idhèes kombetarè,

Me gezim munt te ju thèm sé po thua, te gjithe Shqipetaret, si bréndа dhé si jasht Shqipnies jane mé nje mèndim qe lipsèt bere nje çap i perbashkem per te kerkuar ato te dréjta per te cilat sot ka nèvoje kombi shqipetar è jane : njohtja é kombesies s'one nde nje menyre zyrtarè si nga Turqia si nga Europa, liri per popullin t'one te kéte shkollat é tija è te munt te mèsohét é te qytèterohét ne gjuhen é véte. Po levizja jone per te mbaruar è per te sjélle ne praktike kete qellim, po écen dalé è nga dalé, véç nuk duhèt te deshperohèmi dykè qene qe shénjat jane te mira é shprésat te medha. Nde njeren ane po shohim sè te tere dèputétet t'ane édhé ata me fanatiket me te mprapsurit jane ndare nga Komitéti i Turqvèt te rinj è po kerkojne hére per hère è s'bashkut rèforma per Shqiperine. Me tjatren ane po marrim vesh sè dye nga Qévèrièt é Europès mê libéralè, si Franca mè Englitéren, è kane mare mé sy te mire çèshtjèn t'one é jane gati te na ndegjojne é te na ndihin sado qe nuk kane intèrèsa te dréjta ne vendin t'one.

Keto fjale i ndegjova nga Ismaíl Kémal Bèu kur u kthyé nga Londra é nga Parisi, ku kishtè pasur

shigurimè te plota, é lypsét t'i zéme bése nga provat qe patme ne keto ditet è fundit.

Franca i-u pergjigj Turqise sé nuk do t'i ndihe per ndo nje huajtjé nde bankat è véta gjér kur Turqia mos te shuanté trubullimét è mos te qétesontè vendin mè nje administrim te mire; é ambasador' i Englitéres i tha Sadriazémit sé, nde qofte sé trazimét ne Shqiperie è ne Maqédhonie do te zgjatéshin, Mbréteria Inglizè do te shihèj é shtrenguare te nxjére ne shèsh raportat è konsujvét te saj mbi paudhesite è njèresvèt te qèvèries é te ngjalle perseri traktatin é Rèvélit per autonomin é Shqiperies è te Maqédhonies.

I thirur prè shume hère nga députètet shqipetare Ismail Bèu u shtrengua te vinté ne Stamboll é ka nja 10 dit qe eshte nisur.

Duké qene qe puna è jone nuk eshte akoma gati, édhé é keshillova dhè une qe te vèje, sé nde mos do te zémerohin shoket é tij è munt te humbisté vendin dhé mè 'tê bashke édhé rendesiren, si ne Shqiperi si ne Europe. Nuku do te rije me shume sé nje muaj è do te mundohét te mare mè véhtè édhé nonje tjètre nga dèputètet t'ane qe te punojne bashke mè ne.

Shprésojme qe puna te vêje perpara, po ju lutémi qe édhè ju mos te na haroni mè keshillat é juaja te vléreshmè ; i kini sherbyèr kombit per sa vjétè é lipsét as tani mos t'a kursèni punen t'uaj.

Ju lutém te pelqèni ngjatjétimèt é mia mê te nxeta.

i juaji

*Louis Gurakuqi*

## NJE LÈTER É GJ. QIRIAZI

*Monastir me 14 te Korrikut 1912*

*Zoti V. A. Dodani*
*Idashun Zot*
*Bukurésht*

Perpara ca kohé mora létren tuaj qe me 14 édhè djè nje paqète mé te tré librat édhé flèten «Shqiperia» per te cilat ju falèm ndérse fort. As nje nga keto pune gjér me sot nuku kisha pare. Ky eshte m'i madhi shkak qe kam ndjère névoje te madhé per te bere nje katallog qe te dime ç'kemi édhè ku i kèmi te ketilla thésaré si keto, po per fat te lik gjèr me sot vétem tri létra kam mare pré tri shqipetarevé qe me trègojne punet è tyré. Me vjèn kéq sé nèvè shqipetaret kèmi shumè te méta, mè te cilat i sjéllim shume dem vétehès. po s'ka sè ç'te benje njèriu, mé ate brume qe kèmi mé ate do te gatuajme.

Doreshkronjat qe kini jane fort te vejéjtura mè te vèrtét, sè kini gezuare shpirtin mé sherbimin qe kini bere èdhè po beni te varferit komb shqipetar. Si kur te mundesh te gjitha keto, te délnin ne drite per se shéjti do te ishin shume te vjéjtura èdhé per Shqiperine nje bèkim.

Me vjén kèq t'u vé nde nje zamét, po ne qofte qe behèt kejo gje do te jète nje sherbim per mua dhè per kombin.

Bèsonj «Shqiperia» juaj te kète mbajtur nje shenim per te gjitha vivllate qe ka shtypur. Ne munçi te me beni nje liste si pas perkthimit, qe me beni per librat tuaj nde keto lètra do t'é quanj te math sherbim. Mos è mèrni mè nxitim, kur t'a kini ngéne munt t'i beni.

U lutèm te me shkruani nde kini librat qe kam botuare une :

1) Hristomathi cop' é I.

2) » » é II.

3) Kengetoré.

4) Fisike.

Tashi per se shpéjti do te shptyp nje libre mé ndonja 350 faqé «Udhetari».

U perqafonj mé shume mall.

Miku juaj i vertéte

*Gjéorgji Qirias*

BKSH

ILO VASKE KOSTURI

Nga djélmuria préj ata te urtit qe pushtuan se pari Idéjat è rilindjés se kombit tone eshte dhé z. Ilo Kosturi; ka qene zgjédhur anetar ne komitét te shoqerivé litèraré dhè eshte perkujdèsur mé zémer per perparimin è çèshtjés shènte bashke mé Sotir Pllatin, Vellazerine Zografi, Pandèl Durmishin, Djamandi Kardhon, Ioan Kunéskon, Thanas Kantile, Gjogj Manon, Gavril Pèma, Mihallaq Qiricen, ètj. te cilet kane dhè punuar si shoke ne komitèt per lètrature kombjarè me qene disa hère, kur arketare kur shkronjes é kur anetare te komitètèvèt. Te levduar dhè te pa haruar qofshin èmerat è atyrèvé.



ILO VASKE KOSTURI

Nga djelmuria prej ata te cilat qe pushtuan se pari Idejat e rilindjes se kombit tone eshte dhe z. Ilo Kosturi; ka qene zgjedhur anetar ne Komitet te shoqerive literare dhe eshte perkujdesur me zemer per perparimin e cështjes shqiptare bashke me Sotir Pilatin, Vellazerine Zografi, Pandeli Durmishin, Djamandi Kardhon, Ioan Kunëskon, Thanas Kantile, Gjogj Manon, Gavril Pema, Mihallaq Qiricen, etj, te cilet kane dhe punuar si shoke ne Komitet per letrature kombjare me qene disa here, kur arkatare kur shkronjes e kur anetare te komitetevet. Ta levduar dhe te pa harruar qofshin emerat e atyreve.

## KAPTINA XI

## NJE LETRE NGA «DORA É ZEZE»

SI U XVORDHEN PATRIOTET :

*16 Shkurt 1915*

*Vella i dashur Zoti Kr. Luarasi*
*nde Sofié*

Mé bésen è dashurise qe kèmi patur te paréshtur, mè kujtimét é fjalevèt te bukura qe me kini tréguar dykè mé levduar dhé inkurazhuar per flamurin qe mora ne dore per te shènteruarin qellim qe ndjèkim, kur shkruanja «Shqiperine», vinj t'u trégonj nje pune qe me ka ngjare mua préj disa vètavé qe ushèn, é kane nde Sofié édhé zagaret gjahetor' i kane ketu ne Bukurésht.

Tani nje muaj me 20 Kollozhék, diten é Shen Thimiut, ndodhèsha ne Kafé Bulèvard mé nje «cap» béré perpara, dykè veshtruar nje bilard qe losté Dr. Maçiuka dhè Sotir Manua mé dy vlléh te tjère, nje ore me pare ndodhèshè atjé dhè nje djale i Viske Mborjès, qe i thone Taqi Emanoil, ardhur pas méjè; me dha nje «mirembrema» dhé ndénj dy tryèza lark méjé, kerkoj dh'ay nje bire, ndenj nje ore si thashe, dhé kur mbaruan lodren è bilardos, un u ngrita, mvésha pallton te

ikenj sé ora ish 8 e gjysme. Ahéré vjèn ay djal' i sipermè dhè me jép nje létre dhè me thote qe eshte nga Sofia. Un' é vura ne gji dhé thashe: E di, duhét tè jéte nga Dakua, sé me kerkoj «Mjalten é mblétes». «Trovatorèn», «Serben è Zuzarevèt» dhé nje kolèksié pré «Shqiperise», dhè s'ja dergova sé humba adrésen qe me dha Rafaili. Dhé nis te shkonj sé qè menuar. Po miku me mban dhè me thote:

—«Hapè. hape te lutèm, sé me shkruajne qe te mar nje pergjigjiè nga Z·juaj se shpéjti», dhè une è hapa, è kendova dy hère. Ç'lèçit?!! «Komitéti kombjar «Dor' è zèze» ne mblédhjèn é fundit qe mbajti, te denoj Z tendé te japesh tète mije franga ne komitét qe kur te maresh kete lètre gjér me njezét è kater ore, tjatersoj po nuk' i dhé jè i vrare».

Brenda ne léter ish nje deftèse per 8000 franga. Ne kete hop kohé mua m'u ngrit gjaku ne koke dhé ne pyètjèn è mikut, une i thashe qe te me hane..., èdhé ju kam... nenate, grate è motrate (tri hère) dhé q'atjè vajta mora avukatne t'èm dhè vajtme ne Sigurance. Nésermét é gjétne détèktivet mikne, dhè è pyétne ne Sigurance ne m'a dha ay ate lètre, dhè kush ja dha? Ay s'é mohoj qe m'a dha mua, po nuku di kush é solli; ay è gjéti lene mbi tézge bashke mè nje létre per te, po pa neneshkrojtur. Létra imé s'kish pèçéten é postes, pra ish sjélle nga njéri i érdhur nga Bullgaria. Tèlègrama neper granicat kush ardhi nga Bullgaria; i sjèllin te gjithe t'asaj dité dhè te dites se me pare, pas adrésavét; na sjéllin dhé nje djale te dobet te semure qe quhéshé Pafsa. Kete è pyèsin kur érdhi dhé ne solli gjesèndi nga Sofia, pune qe policia é di; èdhè nje dacke mè tere fuqine ja dha shèfi. Ay i semure, dhé kur kerkoj kerbaçne shèfi, thote: qe è solli nder ment, qe nje bure i dha nje kllef te mbyllur mè disa kartra brènda te ja jape Taqè Emanoilit, édhé ja dha ati ne dore, po s'di sé ç'ishin brenda, makar t'é vrasin. I muar nje shiguri ngaj é kishin sjèlle Pafsen dhé i thane te nésermét te vinje vète, po policia prape dergoj è solli.

Suall édhé mikne Taqo pas Pafses, te cilin è kishin vene me nje kamare véçan èdhè Siguranca é pyèt: «Po ne t'i jèpté Dodani tyne te 8000 frangat, kujt do te ja jèpnjé kur ti s'di kush t'a shkroj létren èdhè s'di kush t'a solli lètren?» Ay pergjigjét qe s'di vertèt. Ahérè sjèllin Pafsen nga kamara dh'i thone: «Keti ja dhé létrat?» Ay tha: «Po». Ahéré policia me thote: «Z-jotè tani s'ké pune, tani eshte puna jone.

Keto ngjane vellaçko Kristo; s'kane cilin te vrasin po tepke mua qe jam i pari nga te trè qe é nisme kete pune qe me 1881, po, i math eshte Pèrendia, pa perseri do te ju shkruanj.

Tani u lutém dy fjale: a mund te me japesh ndo-nje lajme mbi kete çéshtjè? Ne di è ne te mundét sapo gjahtoret é gjakataret è paskan ushèn atjé?

Te puth vellazerisht

*V. Dodani*

*8 Mars 1915*

*Vella Z. V. Dodani*

*nde Bukurésht*

Mora lètren è Z-suaj, è léçita mé kujdès te math, u habita kur é leçita, sè ngaj ato qe thoni ne létret jane te gjitha préj Thèmistokli (Germenjit) édhè Dakos, mè te cilet névè sjèmi mire. Mé Thèmistokline pardjé te Premtèn ment u vrame per pake; ardhi ne shtypeshkronjen t'imé, vèt' i tréte, te me rintè dhé mbasé te me vristé. Un' è dhashe ne «Politse» dhè do t'è mbyllnin; shkaku qé per nje artikull qe une s'dèsha t'ja shtyp; po s'ishté ky shkak, eshte gjètke. duan *para*.

Une u shtypa ne mot te ri atyré nje koçan deftèsa «Lidhja Kombetaré» 100 deftèsa dhè ua dhashe, ata i kane mbushur véte Kr. Dakua dhé Thèmistokli Germenji.

Duhèt t'a therisni prape Pafsen (Pémen) t'i hèqin 25, pa te shikosh si do te refènje te vertèten; duhèt te perpiqi t'i zini te liqte. sè une s'di gjesént mbi kete pune. Une jo Z-tuaj dhé tere familièn Tarpo q'i kam patur me te miret miq dhè ndihmetare, po dhè gjithe te tjéret ne Bukurésht è kudo i kam patur miq te bèses mé pune é mé dirse u kam kerkuar ndihme matèrialé dhé moralé per çéshtjèn è çvillimit te gjuhes é te rrenjosurit é ndjénjavét kombjarè ne bashkememedhétaret qe te ritét é madhohèt intèléktuali né kombi yne. ku ka qene mèntimi è qellimi im qe 20 vjét é ketéj, édhé jo mé te rembyér parè nga te pasurit mé te pahir. Lèçitni lutjét qe bejme perdita.

Keta njéres duhèt te ndiqén; dhé te behèn lètra kudo, sé muare me qafe disa djéma, te cilevè ju prishne morallin.

Né filluam mè zotne Midhat (Lumo Skendo) mè te cilin kam bashkepunuar afro 20 vjèt, te nxjèrim flèten shqip dy hére ne muaj dhé dy hére frèngjisht. Te shohem a do te dalin 2-300 pajtimtare qe te permbahèt apo jo. Né kerkojme ndihmera, te bejme nje dètyre.

Per punen é deftésavét q'u kane derguar èdhè njére u thom, mos è lini ne hèshtjé. Vjérshat do t'i botonj. Mbésome si te shkruanj.

Ja i juaji i perjétes

*Kr. Luarasi*

BKSH

## KAPTINA XII

# NJE DOKUMÉNT MÉ RENDESI

### KERKÊSA È SHQIPETAREVÈ TE SVICERES

Na muajin Tétor te vitit 1918 i-u drèjtua n'émer te Shqipetarevé te Svicres, kejo kerkese Ministrit Sonnino. Keskésa u botua ne nje numur te «Kuvendit» te muajit Nentor 1918,

**Shqipetaret é Sviceres Ministrit Sonnino**

*Gjénéve, 12 Tétor 1918*

*Shkelqéses se Tij Zotit Baron Sonnino*
*Minister i Punravét te Perjashtmé t'Italies*

*Zoti Minister,*

Na shqipetaret è nenshkruar qe nashti riem ne Svicère, dykè intérprétuar ndjènjat é gjithe bashkatdhétarevèt t'ane, marrim lirien t'i shtrojme ketu perposh Shkelqéses s'Uaj ankimèt é Atdhéut t'one ne kete kohe qe fat' i Shtétèvét te mbedhénj é te vègjel te botes do te vèndosèt mbi bazen è drèjtesies è te parimévèt te kombesievét.

BKSH

Na nuk duam te pershkruajme ketu historien è Vendit t'one qe permbyll faqè te shkelqyèra. Na nuk do te flasim vèçsé per pése vjétét é fundit qe sualle nje shperformim te thélle ne Sinisien Ballkanè Ky shperformim shkaketoi, mè aresyé, ne konfèrénce te Londres 1913 krijimin è nje Shqiperié me vèhtè é t'asnjansumè asnjansia é se ciles u-shigurue nga ana è gjashte fuqivèt te mbedha. Por, farkèqesisht, kete vèper é pénguan trazimé te perbrençmé qe ngjane per arsyè te ditura.

Ahèré qé q'Italia hyni ndermjèt é, dykè shpallur mvèhtesien é njesien è Shqiperies, zotonèj t'a mburoje kunder çdo pèrzihtjè è kunder çdo pusiè t'huaj.

Shkelqèsa é Juaj tfaqtè kesisoj, mé arsvè te drèjta, ne ligjeratat é vèta sé puna per mè caktue me hollim kufiet è Shqiperies mbas parimit te kombesievét è te vètvéndimit te popujvèt, njashtu siç é ka shpalle dhé Kryétari Wilson, u-mbètéj Fuqivét te mbeshtjèllura per mé mbylle traktatin è paqès se pergjitheshmè; sèpsé, mè t'vertèt, ne pjésetimin toksor te Ballkanit, me 1913, Vendi i yne u sakrifikua per dobie te fqinjevét tij, é kjo ngjau nga shkaku qe duhésh te mergohéj mè çdo therorsie, rèziku i luftes europjané qe munt te kercisté.

Por nashti qe kjo lufte ngjau è q'asht dyké marre funt mè triumfin è Drèjtesies se gjithe popujvét, na jémi plotesisht te bindur sé, si pas Dréjtesi:s, kane t'i kthéhén prap Memedhèut krahinat pjèlloré q'jane te domosdoshmé per nje Shqiperie jétoré.

Dyké marre guxim nga tfaqjét é Shkelqéses s'Uaj na ju lutémi te kini miresien e t'u a beni mé diet kete kerkése te tjèravét Fuqivè te Kuptimit qe, mé pajtèse te perbashket, te kini mirsien te mburoni çështjén t'one ne Kongrésin é math è Shqiperien, qe dhé ajo s'mbèti pa vuajtur prèj kesaj lufté, t'a lini te zhvilloje dot, mè perfaqesonjesit è saja. per shpagimét è vèta, per te miren è vendit è per qètsien é pasketajmé te Ballkanit.

Dykè pritur véndimin è fundit te Kongrèsit te paqes, na shfaqim èdhè deshiren fort te nxèhte qe gjithe token è Vendit t'one t'a zère ushtria è Italies é

cila na ka shpallur plotesisht te lire é me véhtè è kete é kerkojme per qétsien è popullsievèt t'ona fatzéza te cilat, te bashkuara keshtu nen nje administrate kombetarè, te mundén t'a qésin lirisht méndimin è tyré mi formen è fundit te thémélimévèt te veta.

Dykè shprésuar sè kjo thirjé ka mè u mare nen veshtrim, i lutèmi Shkelqéses s'Uaj te kéte miresien è te prèse, bashke mè falndérjét t'ona te perparashmè, shfaqjèn é ndèrimévét t'ona me te nalta.

*Turkan, Syria béy Vlora, Dr. Adhamidhi, Gjeneral Hasan Taksim pasha, Vissar A. Dodani, Qémal Tahir, Naum Sotir, Dr. Mérusha, B. Toprafos, Ekrém 'Béy Libohova, Véhip Gjérjanis, Gabriél Tatru, Arif Dino, Ahmét R. Dino.*

**Kerkésa u botua mé keto kométa te shkruara préj méjé:**

Nen kete dokumént mé rendesie lipsét te véne nenshkrimét é tyré te gjithe shqiptaret. Por mè qene sè nje pun' è tille âsht veshtire te behèt, lè t'i dorezojne Qévéries italianè pranimèt è tyrè umum te gjitha Kazate è Shqiperies é keshtu nèvé kèmi bere plébishitin t'ene. Permi kete çéshtjè na dukèt è téperte te zgjatèmi, E léme ne dore te shqipetarevêt te mençur t'i a shqjégojne llauzit tene me mire dhé me kthjèllet kuptimin é rendesien te ketij dokuménti.

Arsyè politiké na keshilluan t'a vonojme botimin é ketij *apelli,* per te cilin mundem vètem te bejme fjale ner numurat é shkuara te *Kuvendit.* Puna, natyrisht, nuk munt te mos hiqtè verréjtjèn è shqipetarevèt è nga létrat qe kèmi mare, nde te cilat auktoret si njèri tjatri çkoqin mé argumèntè te shendosha rendesien é botimît te dokuméntit mè neneshkrimèt é vètedorasvèt, i leshojme shtyllat kesaj létré qe mparme nga Gjènéva:

«Kendova ne No. 16 dhé 17 te *Kuvendit* disa botimé

te létravét è téjshkrimèvét q'u derguan té Çkelqésij è Ti Z. Baron Sonnino nga dísa visé prèj Shqipetaresh qe rojne ne Shqiperi dhé jashte, ne Llozane, Génève dh'Amèrike dh'u-gezova, po me ndjèni t'u thom, sè ajo q'u dergua nga Gè-nèva mè gjithe bègimèt q'é kini ndèruar, duhèt çpallur èdhè me plotesisht per dobi te çeshtjés é per te veshtruar gjithe shqipetaret sé cilat fytyra jan' ato qe adératin dhè deshe-rojne miqesin' è Italise, dhè ngaj eshte shprés' é shpetimit se Shqiperise, dhé kush vètem sé Italise ngriti zene per na dhé per te dréjtat tona.

Neneshkrimèt è burravèt t'apéllit qe flasim nuku vé-tem qe kane rendesire sé i ka njohur Europa dhé me shume Italia, po i njohem dhè nèvé te végjelit shqipetars, po qe kèmi punuar sa na u mund dhè i ndérojme. Pasendaj shqi-petaret njohen dh'ata vellèzer qe shkruajn *Albanin'* é Llo-zanes; per te cilet *Kuvendi* gezonét per tejshkrimin qi der-guan Z. Baron Sonninos, ndonesé tjatre hère i kishin pare tjéterisht punerat. Dhé kejo gje n'u botofte ploterisht si tha-me, mbèsojme qe te sjèlle dashuri midis te gjithevèt Shqi-petare, sé do te kupetonète qe si Llozanasit u pajtuan me ata te Gjènèves dhé kane tok nje mendjè per miqesin' è Italise, ashtu mund te pajtohén shpéjt édhé partijat te shqi-petarevèt t'Amérikes q'u ndane nga «*Vatra*».

Puna s'duron shume; duhét botuar, si dhame, dhè du-het hèqur verrèjtja atyré t'Amèrikes te pajtohén sa mê shpéjt se do te na marin me qafe, Sot duhét te jémi tok te gjithe; te shekohèmi njére te shpetuar nga vdékja, pa si te formo-hèmi Shtét, bejme opozicíè, nxjèrim dhè inatét, defrèjme dhé ligesin é nakarit, pa dhé syte, po sot nuku. Ay qe mban sot te fitonje inatne eshte tradhetor; édhe shoket é partise kuntre «*Vatres*» te shtrengojne Kryésin' é Shoqerise tyrè te benje shpéto pajtimne ndryshè jashts! jashte drun' é shtrem-ber qe prishi seren, prishi «*Vatren*», shprèsen é Shqiperise q'u qendronté ale ne sy anmiqvèt te kombit.»

Ç'fare pergjigjé te bukur! Ç'fare ze prèj qélli! Sot jam èdhè m'i djégur te therès per te miren é Shqiperise, thote Baroni Sonnino, po némeni dhè jy, o Shqipetare ndihme.

E, po ç'kerkojme mê mire, me léhte?!

O burra-ní, shpéjto zgjithni nje komitét mé téjshkrime ne Rome, ne Hèlvéti, te perfaqesonje shqipetaret dhè té hynje ne sere mè te tjérat kombé qe jane njetash gati per te vatur ne tryèsen te gjélber, ku pritèn te dréjtat é kombêvèt, atjé ku i pavdékuri bur' i Italise na kerkon ndihme per te miren é shpetimne tone me se pari, dhé per intérésat qe na lidhin mè atdhén é Ti.

Eshte or' é fundit, ora kaq è vjéfshmè sa dhè è veshtirmè. Mjère! mjére! ne mos ditçim te punojme tani. Dote kafshojme gishtrinjte, do te pèndohèmi, do te qajme ne mbèçim si Evgjitet kur te shekojme njeri-jatrin, Zoti mos é dhente! po do te jène gjithe kotte.

Thire, Zoti Dirèktor, thir' é gjemo dashurine midis Shqipetarevèt se u shurdhuan. Thire te mblidhèn tok mé nje vend, te mendohémi dhè te bejme ç'eshte per te bere sè do te humbasin trène.

Bota, qe kane njetash Shtétêt é tyré dhè punojne mé tere fuqite per te shtuar é madhuar ato, mé te dréjtj' é pa te dréjte, nèvè qe s'kémi faré gje s'levizim te trashegojme as ate q'eshte jyni.

Ndermès te kesaj épidèmié te tmèrte te *Grippes*, ndermès te nje brymè te dendur è te hérrete, plak 80 vjèt njéri Z. Pasiçi vjèn ketu ne Génève te hasét mè kréret é Jugo-Slavevèt dhè te marin nje shart per dobin é tyré; nèvé jèmi ketu ne nje Shtèt ospitaliér, te dlire, dhè perndare disa ore dhé minuta njèri nga tjatri dhé s'munt te mblidhémi dot!

*Zot lirona sot se kéqés.*

NAIDDO

## NJE LÊTER NGA SOTIR GJIKA

«KUVENDI»
POLITICO SETTIMANALE ALBANESE
ROMA
Via Ripetta, 210 P. 2 Telef. 40-44

*24 Tetor 1918*

*I perndritshem atdhétar,*

Epmeni léje te thèm détyrisht sè ne lètren bujarè te Zotrísendé une çquanj paragjithash ndjènjen è kulluar te nje te vertèti atdhêtar zèmerdjègur, qe shume ka pare dhè aqe me shume degjuar ne ngrysjèn é vjètèvét permés nje puné te paréshtur è cila per zhvillimin é saja tjater rrenje s'ka patur sé ku te mbahèt pervèç bèsimit te patundur te njèriut véte ne triumfin e pamunguarshem te nje filli te shénjte, préj ku ay gjithnje kerrèu mesim é frymesim per t'écur, è force per te qendruar kunder te gjitha duhievét.

«Kuvendi» mburrét mé t'vertét per pranimin é udhes se tija politikè q'i vjèn nga ana é Zotrisendé, sépsé Zotroté jè njeni nder ata burrat mendjèholle dhé shpirtmbedhènj q'i dhane jéte çeshtjés s'one kombetaré.

Artikullin é botova ne numurin 16.

Une jam nga Shtika é Kolonjes, i bir' i Spiro Gjikes. N'Italie me benèn pothuaj pése vjèt. Ne qytétin Bari me 4 Gusht 1914 nxora numurin è pare te nje faqèjè shqip te «Corriere della Puglie», botimin é se ciles è pushova simvjèt ne Mars, kur véndosa te vinj ne Rome per te nisur botimin è «Kuvendit». Hollesira te tjéra kur te piqèmi shendoshe. Sa per versten t'imé, ja ku mbyll ketu nje fotografie t'imèn.

Ngjarjèt nderkombetare po vertitèn mé shpéjtim vètetimé. Punrat t'ona tere kohen è luftes i lame te véne me kemb' é me duar; por tani ka vatur thika n'ashtet. Ketu keto dite do te ngjasin gjera politiké mé rendesie te posaçmè é qe, padyshim, kane mé pase *carattere decisivo* per pritmin è Shqiperies. Pa dale ky muaj do te mblidhén ne Rome shqipetare te she-



SOTIR GJIKA

**Eshte nje shqípetar nga Kolonja ; ka mbaruar shkollen líçéalè nde Rome. Nje kombetar í ndezur dhè mè mèndímè te nalta. Shkruantè neper zhurnalèt Italíanè dhè mprontè te drèjtat è kombít shqípetar dhè me 1918 dirízhontè nje gazète nde Rome te èmeruar „Kuvendí".**

BKSH

BKSH

nuar te politikes s'one Asht è mira, madjé pas mendjés s'imè, duhèt doèmos, te ndodhésh dhè Zotrotè q'jè m'i vjétri è m'i njohuri ne fushen kombetaré è qe kè te dréjte te gezonèsh me pare nga kushdo. Nde te mbushèt mendja te vish per çdo névoje prèj natyrè praktikè faqè pasaportes é hyrjés n'Italie, shkruaji Zotit *Colonnello Castoldi Ministero Affari Esteri*, i cili mè anen t'imè i dergon Zotrisendé shume te fala.

Pritni, Zoti Dodani, bashke mè falendérjét pershendètjèt è mia me te perzèmertat è miradijèn t'imé per keshillat è urta.

Mè ndèr è bése
*Sotir Gjika*

NJE PERGJIGJIÈ SOTIR GJIKES

**Kjo pergjigjié, bashke mé koméntarét qe é pasojne, u botua ne shtyllat é «Kuvendit», ne nje numur te Nentorit 1918.**

*Gjénéve, Nentor 1918*

*I dashur Z. Sotir Gjika*

Dié mora létren te Z-tuaj, shkruar me 24 Tètor èdhè mbétém nene barre per fjalet te bukura qe m'i numeroni.

Nuku paska gje ne jète me te pelqyèr sè kur rron njèriu dh'arrin te shohe dal-nga-dal disa deshira te shénteta dhè te zjarta te djalerise, nisur mé aqe gaz é shprése sa dhé mé rendesirra, te vertétohén ne pléqeri Kur nisa létekembimne mé shpirtndriturit Gerolamo de Rada dhè Najim-béj Frashèrin, ne Siçèli dhé Kostandinopoje, i truar nga Efthim Mitkua nga Misiri, kishnja vétem dyze shoke ne Bukurésht; njéri qè i ndjéri Gjérgj Gèçoja dhè tjètri Zoti Eftim Markoja, qe rron dhè sot ne Korçe. Po deshira shénterakė, mun-

dim' i paqme, udh' è drèjte dh'è naturçmé na ndihu kaqé shume, sa qe me 1881 gjèr me 1884 deshira u perhap mè t'atille vrap sa ne Bukuréskt beme nje shoqeri pé 450-600 shoke dhè grékomanizmen é shojtme farè; pastaj derguam njéri dhé ne Misir dhé beme dh'atjè nje dège shoqerijé kombjarè, ndonesé ca m'é vogele nga shkakét è névojes se ca shqipetarevét qe doshin te jéne ndene krah te konsollozevét Grèker.

Ahéré fytyr' è deshires se Shqiptarevèt ishté perlindja é létratures shqipé; po qellimi qe mfshinin deshirat ish *liria kombiaré,* qé kejo èpoke q'arime. E, po ka m'i math ç'perblim ne jète?!

Hyra ne létrekembim pastaj mé te çkelqyérin vjèrshetor Zotin prof. Zéf Sqiro, Gabril-Dara, Ansèlmo Lorèchio, Anton Krispin; ky i pastajmi me dergoj disa *Te thena* qi ka shtypur ne biblen «*Mjalt' é mblêtes*» édhè ne te perkoheshmèn fléten t'imé «*Shqiperia*» qe dèlté ne Bukurésht (1887-89) dhé puna lètrarishté u nkethyé ne politiket per nje pjése shqipètaresh qe s'kishin me frike nga Guvèrn' è Turqisé, mé qene *sujéts* Romene. «*Shqiperia*» si dhè vivllat shqipé, mé krah te nenepunesét shqipetare, hyne brenda ne Shqiperi po si lumenjt è rrépta; propaganda perparoj sé qè è dréjte natyrisht, kaqé shpéjt sa mè tere kallesimét, dhèlperite pe perdore armiket è kombit tene, Shqèh é Gréker, mè Tiranij' é Haldupevét, Shqiperia u vellazerua midis saj dh'u bene kryéngritjét q'i dime dh'u be dhe me ne fund ajo cope mbrèteri shtataniké, è cila per shkaké te ditura, pamet u shua, dhé shqipetaret afro te shtihéne ne zi! Po, ja nje ze nga qèlli, per kundre lakmimit t'armikevét shékullore, gjemon mè gojen te **Baron Sonninos:** *Nuku! «Shqiperia duhêt te rronje indèpéndénté dh'é bashkuar é tere; Shqiperia do te jét' é mprojtur nga ç'do léqi q'i ngréhin te huajte.*

Pyèsim: a gjéndéte, valle, po shqiptar mé ment, mè zèmer te qeruar qe te degjonje kete ze, *divin,* kaqé te dréjte, qe te mes gezohèt dhè te mos vikase, sa mèr zeri: Rroft Italia?

Tani opozicia perseri ka nisur n'udhe kundre guvèrnes se perheshme, q'é ka zgjèdhur Shqiperia véhte pa mènduar sè ben nje joko te nje guvérnè tjater te cilen njetash è ka njohur Grèqia dhè Serbia, dy shtétè te veshtira per na, po te perkedhélur shume nga Franca dh'Inglitera, te cilate jane gati t'é njohen dh'ato per dobin è Béniaminevét t'atyré, mé fjalen é dréjte, kur shohen sé shqipetaret te nje guvérné qenkerkan te ndare midis tyré. Dhé ahéré, qé, nje copke Shqiperi Muslmanè t'Esad-Pashes! Po nuku eshte me mire, qe perpara sé te prishèmi mè nje mik, q'i ka intèrésat te njeshmé mè tonat, te kupetohèmi dréq per drèq ku eshte plaga qe na dhêmb dhé sa dem na ben ajo plage? Per sé te bejme nje akcion, nje proçès prématur tjatrit dhè te behèmi armiq?

Po ajo qe habiti mendjén é kulluar me shume nga te gjitha eshte: Persè kejo *opozicie* nuku lébétit per Korçen q'è shkéle njetash bashke mê fjamur' è saj gréket dhé qe kerkojne dhé Gjinokastren, po paskan frike nga Italia sé do te mbanje Vloren?

Po ç'è duam Vloren (fjala vjén) kur te humbasim dy krahina te medha si Korçen è Gjinokastren? Me keto dy krahina te mbedha Shqiperia ka fuqi, ka ze me te forte te qahét ne *Societe des Nations* kundre Italise qe na mbajtka Vloren perfaré.

Po qe ku é nxjérin dipllomatet tane qe Vloren é kerkon Italia perfarè? Italia na è tha kete gje. apo é marin mé ment nga qe Italia s'ka portura mjaft? Ate qe tha Italia eshte kejo é vertètat Vloren è dua t'a mbanj sé Shqiperia s'esht' è zonja t'è ruanje; Shqiperia

sot eshte é dobet kundr' atyrè q'ja kane shtire syte Vlores. Shqipeiia genjéhét dhè munt te shitèt sé eshte foshnje dhè munt te hèqe siç ka kokenj po une Italia kam jéten dhè dua t'è ruanj jèten, s'dua te vuanj. Ashtu qe ka intérèsa dhé ka te drejte te mos kète bése ne Shqiperine é sotmè q'è deftyém me 1914.

Mbèsonj sé kejo esht' è vertéta dhé kejo gje vjèn t'é njohem dhè névè sé sjèmi te zotrit t'è ruajme dhé te mos prishèmi mè nje fuqi te madhé si Italine: mè nje fuqi qe duhéshé kerkuar ne Qéll dhè é gjètme anes Adriatikut, ku dha Zoti te ndodhemi. Vlora do te jète vétem forcuar ushtaresisht nga Italia po qèvéria do te jète shqipetaré si dhé ne tere Shqiperine.

Nje njèri qe ka punuar dy te tréla te jètes se tij eshte rende dhé mekat te lajthitnje tepke ne fund kur ardhi dit' è deshiravèt, po per ata, qe pa ndonje prove kerkojne prishjén è miqesise mè nje fuqi qe na duhèshé si drit' è syvét, s'eshte mekat i rende sa malét? Une jam pé ata qe mbésojne sè Shqiperia si gjèndét sot s'munt te véje perpara dhé mè ata flas è bisèdonj. Nuku dua te flas mé ata qe thone, sè s'na duhén nèvé shoke dhè mbrojtes, jèmi te zot te qèvérisèmi véhte..., i vrasim ata qe ngréne koke.... Atyrévè ju deftènj 1914 ten. Atyrèvé ju thom: Po... Te ishim tere krishtiane, a tere musulmane, a te ishim te paken te qytèteruar, tè dinim sa vlén atdhéteria; po kur névé fatkèqerisht s'kémi as nje nga keto, na duhét nje krah; na véte do t'i prèsim kemkate perpara sé te na i présin te tjéret.

Vijme tani ne nje tjèter bar shpetimtar, qe na rékomandon nje mjék i mire, dhè ky bar ka nje ngjyre te mire ne te pamet dhè pelqèhèt nga kushdo, po qenkerka shum' i shtrènte dhé s'è markèmi dot névé kurre. Mjèku opozicionist na thote: vertèt Shqiperia duhét te kéte njonje ndihmonjes (mjaft qe thote), po persé Italine dhé nuku Amèriken? (mire qe s'thote Gréqin' a Sêrbine) dhè shoket è ti as lén as marin, po gati, poshte, poshte Italia.

E, mire po s'eshte ashtu, névé s'kémi intèrés te therésim poshte Italia. Névè i thomi Mjèkut népè bare qe na taksè, ku é kè Amèriken? Kete gje è kerkon dh'Italia, te mos kéte kokeçarjé mè shqipetaret po te kupetohèt mè Amèriken èdhé te kète siguri nga nje Amérike. Po mjéku thote, po ja... Erriksoni, Hèroni, Eberi, aksèkusb, Misakcila jane filalbanéze dhè kane folur mire per né... Faré miré, Zot, kane folur, i dimè, jan' Amérikane, i di dhé Fan Noli dhè Aksècilka, po s'na sheron kejo Zoti Mjék. Pune, pune duhèt, Zotèrinj, nuku prapesire dhè mbushni atmosfèren mé grindja kundre Italise. Puno mé Amèriken dhé mbaro punen urt' é bute, mos lére te tjére te shajne dhè te bejne armiq te harijne qellimn' é tyré jo te kombit, sé kini rèsponsabilité perpara jétavé. Mos é beni si ajo gruaja qe porositi burren é saj t'i sjèlle nga pazari nje kémishe, dhé pa pare mire sé i shoqi mban nje pate te bardhe nene sjétull, gruaja é hodhi kemishen ne zjar. Amèrika munt te benje nje drèjtesi per mbi lakmimèt é grékervét dhé serbevét qe na kane nxjére fasha nga Shqiperia dhè qe duan èndé me, nuku munt te prishèt mé aliatet n'i kane dhene doren te lite Italise te perkujdését per Ballkane.

Détyra tone eshte te bejme si beme dhè tjatre hére, t'i lutèmi Italise te véje te zere mè ushteri visét te Shqiperise qe po i thérin serbet. Gjakova, Ippeku lébétitin dhé te tjéra visè qe po shuhén faré, dhè nè po zihèmi si Bizantinete duhen konismat apo s'duhèn. Duhét te dy partiat te pajtohèn dhè te hunjèn njéri tjatrit per te miren te Shqiperise q'i ka derguar, nuk te fitojne inatne ne kuris te kombit.

Keto jane te ngjarat ne Paris, keto jane idéat tona, Zoti Erébara, dhè Zoti é befte mire dhé ay te na gjykonje!

Une thom, si thoshtè shpirt-ndrituri Efthim Mitkua:

*Per te miren te Atdhéut*
*Per dobi te véhtés tuaj*

*Edh' Evgjitit édhé Béut*
*Thoni: jam vella, me duaj.*

Keto fjale jane prè njériu qe s'ka tym ne koke; po te aplikohèn keto humbét égoisma dhè mirevajtja vjèn vètiu, problémét zgjidhèn mè urtesi, sè ku eshte urtesia eshte Pérendia.

Pergjigju, te lutém ku jam gabuar dhè te jap bèsen qe mbétèm nga héra mik i dashur.

*V. A. Dodani*

NJE KOMÈNTE SHTYPI

**Koméntat é flétorés «Albania» qe botohéshè ne Worcester per mbi létrat é hapura te botuara ne «Kuvendi» i Romes.**

Dy lètra te hapura u botuan njèra pas jatres ne «Kuvendin» é Romes préj Z. Viske Dodani, nje é drèjtuar Z. Jashar Erébara dhè tjatra atdhètarit tone dhè Dèlègatit ne Paris Z. Pandèli Evangjèli.

Njéren prèj ketyrè létravè é botojme ne kete numur te «Albanise» dyké é ruajtur tjateren t'a botojme ne numurin qe vjén.

Z. Dodani perpiqèt mè anen è létravé tij t'u provonje shqipetarevé sè Shqiperia nuk esht' é zonja te véteqévèrisèt dhé nga ana tjater sé Italia esht' i vètemi shtèt qe munt dhé ka intèrésa per t'a udhehèqur Shqiperine ne çapèt è para te çvillimit saj kombetar, po shton, sè per kete duhèt te leshohémi ne préhrin è Italise vérberisht.

Ne te dy pikat, po thuaj sé ata shqipetare qe nuke bashkohén jane te pake, po as nje prèj shqipetarevè nuku munt te bashkohèt mè idène é Z. Dodani qe te leshohémi vérberisht ne prèhrin é Italise.

Z-tij ne lètrat qe shenuam me siper thote sé Italia è rezoj tratatin è mfshèhte mè prokllamaten qe beri Général-i Ferrero ne Gjinokastre me 1917, po sikundre dukét nuke

do te shohe osé s'é ka pare ngulmin é Qévérise Italianè qe ka vene per te zgjidhur çéshtjèt é saj si pas atij tratati fatal.

Qe te tere é dime sè miqesi mé serbo-gréket nuku duhèt, qe te tere é dime qe kémi nèvojen é perkrahjèn te nje Qèvèrijè te madhè per t'u mekempur, po si munt te bèsojme ne miqesine Italiané kur sè sillét ne mos barabar mè serbo-gréket po si do mos si nje ngadhenonjes ne Shqiperi?

Ku eshte Qévèria per te cilen ben fjale Z. Dodani, ku jane shkollat shqipè pa ku jane shenjat é tjèra te miqesise Italiané?

Z. tij di te kerkonje sigurimé per mandatorine Amérikané pa é kerkuar ate, po qe te kerkonje sigurime nga Italia é cila sot ndodhét ne Shqiperi dhé véperon si kur é ka çifligun é saj nuke kuxon.

Eshte deshira é Italise qe t'i jape Shqiperise ate ndihme dhè perkrahjè qe u dhane franko ènglèzet Gréqise dhé Ruset Bullgarise? Lé te benje nje dèkllarate.

Nuku ka qellim Italia qe t'a kollonizonje Shqiperine dhè qe te vèndosét ne Ballkan per te mos u çkulur s'andèjmi? Lé t'a çfaqnje shèshit sé édhé névé do te bindèmi.

E do t'a mbanje Vloren nga shkaku sè si kundre thote Z. Dodani nèvè shqipetaret s'jémi te zote sot per sot t'a mbajme?

Lé t'u jape nje te shkrojtur Délégatevè tane sé s'ka qellim t'a mbanje per gjithe jète dhé sé posa te harihèmi do na è lére perseri nèvè qe jémi te zote te atij vendi.

Ndofta Z. Dodani te na thote, sè Italia s'ka nèvoje as dèkllarate te beje, as sèaètè te lithnje mé nèvé, mé qe si mbréteri è madhè qe eshte, nuke na pèshon faré. Po kur ajo nuke na péshon èdhè do te benje si i do qéjfi asaj, atehèré per sé t'a duam dhè per sè te mos t'a luftojme mé ate fuqin è pake qe kémi? Névè sido, kèmi te dréjten me véhté, dhé s'kémi per sé te trembèmi. Po te ishtè puna ne duar te Grékevé, te Serbevé dhé te Italianevé vétem, atehèré ata benin si t'u dontè qèjfi atyrè dhè nèvé nuke na pyésnin farè.

Levdohét mé punen qe ka bere se bashku mé shoket

é tjère Z-tij ne Gènéve po nuk shikon farè se sä dem na solli ajo pune, ku per pak dykè na pandèhur si végla te vérbera te Italise, Gjinokastra, Dèlvina, Himare, po afero dhé Korça, Léskoviku è Perméti na shkuan.

Gabohét téper Z. Dodani knr thote sé s'kane folur shqipetare per Korçen è Gjinokastren mé qe per ato fole me pare sèç te flisnin per Vloren po èdhé sot akoma nuke réshtin se foluri.

Névé munt te thèmi kete, sè, per ata shqipetare qe kupetojne dhè qe nuke jane lyér nga nonje ane as njejt s'i jèpèt dot bèse nga te huajte qe kane intérèsa ne Shqiperi, pa è kthjèlluar qéllimin è tyrè kundréjt saj.

Z. Dodani pra, me pare sé t'i keshillonje bashkatdhè-taret t'ane qe te ngjitèn pas Italise dhè te leshohèn vérbe-risht ne prèhrin é saj, dote benjé mire qe te keshillonjé Qé-vèrine Italianè te na jape ajo véhte te kupetojme sé s'ka no nje qellim te lig kundra Shqiperise dhè sé desheron te na jape ate perkrahjé dhè ndihme per te cilin Z. Dodani ben fjale.

## NJE KOMÉNTE É GAZÉTES POPULLI

### Shkél é shko

Ne numrat é vèt me 25 è 30 Qérshuér «Kuvendi» boton dye létra te hapeta qi i mèr prèj V. A. Dodanit ne Génève, te paren per Jashar Erébaren ne Viène è te dyten per Pandéli Evangjélin ne Paris. Létrat jan, te dya, te nji kallepi vèç sé te botuémé dye hère, é kio ndofta per rendesien è mèndimit politik qi permbain. Nenshkruesi i létravé harxhon aty gjith dijen è takatin per t'i binde te dy miqt' è vellaçkot é vet ne menyrat qi ai mèndon é rréshton per peshtimin é Shqipnies. Tuè raportué ketu poshte disa pasagjè te idées se piékur te keti atdhétari, dèshem t'i a baim mundimin é 'ti èdhè nji hère te pa vdèkshem psé, mé te vertète, Shqipnia, per fat te kèq te Zotit Dodani, édhè nuk è ka at' baft qi te kèt piélle shum fatosa te ati mèndimi.

Dodani kuiton sè gjith Shtétèvé te botes parét, topat é municionèt u-a falin miqt è sè ligjèt vine è u a dertoin te huéjt è, i pajuém mé ket' idèe, shkruan:

«Pas mendjès timé, mè keto te méta qe paskémi né, Shqiperia nuku do te vèje perpara si mbréteri po te mos kémi nje krah te shendoshe qe te na mpronje, te na msonje te na ndihe mé para, te na paragatuanje ushterite, te na jape topa, municione, te na vere ligjè te forta dhé te dréjta».

Ma poshte kerkon te mbushe méndjén è vellaçkové sé munt te kèt indépéndènce nen protékcion é sé Shqiperia ka per te hype déri ne qiéll ékonomisht mè kapitalat é huaj qi do te dèrdhén nder nè per te na ndertué udhe «dh'udhe te hékurta» è sé vétem keto udhe nen' règim te huèj do t'i mbushin barkun mé buke Dodanit.

«Dykè patur nje Itali mprojtesé mbi Shtétin è Shqipetise indépèndant apo dh'aliaté, nuku dote kuxonje Esati dhé shoqt' è tij apo propadandat t'huaja te na turbullojne Qévèrine tone shqipetarè, sè è dine qe s'jèmi te shkrète. Miqesia è nje fuqis se madhé nè na duhèt do é mos dh'ajo fuqi s'eshte tjatre pervèç Italise è cila ka intèrés te ronje Shqiperia qe te rronje dh'ajo vèhte, Italia é cila ka armiq Gréket dhè jugoslavet, te cilet jane dhè armiqte tane; Italia è cila ka dh'intérèsa ékonomiké shume te medha, per te cilat pro se pari duhét te ngulnjé qindra miliona te benje udhe dh'udhe te hékurta qe te lidhét mè ter' Oriéntin, qe te mbushe Shqiperine mè te ketilla, te cilat do te sjéllin buken ne goj' é Shqipetarevèt».

Zemre-perveluari é mendjéthèlli koréspondént qi ndriton faqét è Kuvendit, filosofien ma te çkelqyèshmé é trègon ne zberthimin é çéshtiés se Vlones tuè porosite qi gjith véndèt qi nuk asht i zoti shqipetari t'i ruèje, duhét t'u a jape te tjèrevè per mos mé u prishe mé 'ta sè ndyshè è hangri uiku. Vlona do jèt è shkèlmé vétem ushtarisht è dipllomati Dodan do te rrije te kumandoje nder zyra civilé indèpèndéntè:

«Po ç'é duam Vloren (vjèn fjala) kur te humbasin dy krahina te medha si Korçen é Gjinokastren? Mé keto dy krahina te medha Shqiperia ka fuqi, ka ze me te forte te

qahét ne Sociètè dès Nations kundre Italise qe na mbajtka Vloren perfaré.

Po qe ku é nxjèrin dipllomatet tane qe Vloren é kerkon Italia perfaré? Italia na é tha kete gje apo é marin mé ment nga qe Italia s'ka portura mjaft ? Ate qe tha Italia eshte kejo è vertèta: Vloren é dua t'a mbanj sé Shqiperia s'eshte è zonja t'a ruanje, Shqiperia sot esht' é dobet kuntr' atyré q'ja kane shtene syte Vlores. Shqiperia genjéhét dhè munt te shitèt sé eshte foshnje dhé munt te hèqe siç ka koken, po une Italia kam jéten dhé dua t'è ruanj jéten, s'dua te vuanj. Ashtu qe ka intérésa dhé ka te drèjte te mos kéte bèse ne Shqiperin é sotmè q'è deftyén me 1914.

Mbèsonj sè kejo esht' è vertèta dhé kejo gje vjén t'é njohem dhè névé sè s'jèmi te zotrit t'é ruajme dhè te mos prishèmi mé nje fuqi te madhé si Italine, mé nje fuqi qe duhéshé kerkuar ne Qéll dhé é gjétme anes Adriatikut, ku dha Zoti te ndodhémi. Vlora do te jéte vétem forcuar ushtarisht nga Italia po qèvéria do te jéte shqipetaré si dhè ne tere Shqiperine».

Ky shpirt njériu, pazarllèkut qi parashtron i nèp nji shkas pak me te ndritshem ne lètren é dyte psé aty difton èdhé nji qiramèt tièter tué paralaimuè sè sot è tutjè konfliktèt nderkombtare kan per t'u daa mu ashtu si dukèn punet è kuseries nder né kur vidhét, mè ndèr zotit Dodani, ndonji kéc a ndonji dhie é asht domosdo, «Shoqeri è Gjindjavét» qi i-a shtiè ket inspiration:

«Po s'eshte me mire te humbasim (fjala vjén) nje Vlore sé dy krahina te mèdha? .. Shqiperia mé ndihmen é popullit qe kane keto dy krahina, si nga shumica, si nga ndjènjat, munt te benje nje hov kryéngritjé, nje ze gjemimtarè, qe te hynje ne vésh t'Europes té shoqeri é Gjindjavèt, é cila te na therèse perpara gjyqit dhé te kerkojme Vloren ngaj Italia, n'eshte sé na genjéhu dh'é mban per faré dhé na ben demè».

Kaq i dréjte è kaq i thélle ne dipllomatien è 'ti, i kulluari é i palodhuri per ket «atdhèje» ka arsyè qi te hélmonét a ma mire te pèrmblidhét me ndonji pus mé koke poshte nga inati qi nuk po i gjén shqipetaret te bashkuém ne méndimin é vét:

«Po nèvé s'dime ç'eshte patriotisme, névè è shitme Shkodren dy hère, nèvé s'mérémi vésh njèri mè tjatrin, sé patriotismen è kémi ne dore te 3 te, pas ambicies, pas nakarit dhè pas íntèrèsavét. Névè jémi zèro, per véhtèn tone dhè te mire per te huajte.

Prudénce, vellaçko Pandéli. Urtesi, sè kémi punuar per kete te dashur atdhéje. Mos u lère perpara fjalevèt qe thone sofistet: demnitée dhè suveranite étj. qe te héqin shumice me vêhté per te prishur pune. Jane shqipetare te tanishme dhè disa bere nga ambicia, dhé sot gjithe per ambicie punojne kundzèjt: te tjére vène si dhènjte, te tjére kane, ndofta, nje misiont te prishémi vètem mè Italine».

Gjynah, pra, qi te mos zgjidhèt vellaçko Dodani Président i Keshillit ne Durers mbasi èdhè ai Keshill, si thote vellaçkua, qènka vèpra é dièrses sè 'ti.

*Gazéta shkodrané „Populli» 19 Korrik 1919*

## NJE PERGJIGJIÉ KOLÉAS
## *Bukurésht 30 Vjéshte 1919*

*E ndérshem gazéte «Populli»*
*nde Shkodre*

Tani kur vinj nde Bukurésht nga Gjénéva, gjéta ne shtepi gazéten «Popullí», è cila mbanté nje artikull mè titllin «Shkèl è shko» qe kallezonté dy létra te hapura t'imét botuar ne ditarén «Kuvendi» qe dilté nde Rome. Keto dy lètra; autori i perment, i shpiè- gon plot mé qésendi, sikunder dukèn ne kopjèn te gazétes qe mban artikullin qésendimadh.

Qèsendimadhi auktor nuku neneshkruét; dirèktor' i «Popullit» pamèt nuku dihèt, esht' i posaçmé; vétem géranti zoti Salih Nivica neneshkruhét çiltas.

Lètra t te hapura qèsendisèn sè ndjèkin nje politike italo-donjesè. dhè z. gérant Sali Nivica dihèt qe s'eshte kuntre Italise dhé s'ka persè te zémerohét kondre Dodanit qe mban politike te çilte mé argumèntè Italo- donjesé.

Nívica nxjér círonka te míra, po rron ne Lausane nje círonke, qe ngjèt kaqé fort mè artikullin «*Shkél é shkoléas*» sa munt te thuhèt: Evríka! Ay ze, ay zakon, ay grinJavèc. maniak, nakarar, névropath, mísanthrop, égoist, étj

Kejo círonk' è Lausane-s qe u loth te kritikonje lètrat è hapura te «Kuvendit», do te bentè me mire te ndrèqtè lajthitjét polítiké te Dodanít dhè te thoshtè çíltash qe Italía nuku mban fjalen, po u mjaftua vétem te perqéshe mè polítiken é Dodanít? Nuku kuxoj te hape gojén, ay qe dhé ka arguméntè te qahét ngaj Italía, sè í prémtoj t'í shtypnje nje vèpre te madhé qe po punon mé aqe vjètè dhè taní ja kthèu fjalen.

Po psé s'na paska thene, qe taní Austria do te ja shtypnje dhè Wiédin duhèt t'e sjéllím perserí dh'ahérè une mbétésha í paqèsendísur dhé círonka í Lausane-s hídhéshé ne líqén ku munt te rrojne shume, sé me te thate ngordhin círonkat.

*Dodani*

## NJE PERGJIGJIÉ TJÉTER

*Bukurésht, 25 Vjésht' é tréte 1919*

*Zoti Dréjtor i Gazétes «Kuvendi»,*

*U lutém bejini vend kesaj pergjigjié ne te vyéren gazéte qe dréjtoni burrerisht, édhé pritni qe se pari falendérimét.*

Larg nga mua te nis polémike mé nje tog shoke qe réthojne te ndèrçmèn gazéte kombetarè é cila çpallèt ne kryèqytétn' è Rumaníse, dh'é cíla shprésojme qe do te sjélle dobi shume ne perlindjén è atdhèjes tone.

Ajo qe me ben te pergjigjém sot, dhè ndofta, nje hére per ngahéra, eshte hidherimi qe ndjénj ne

shpirtin sè ne kryèqytétn' è Rumanise, ketu ku u shoshitne, perpara shume vjètésh, atdhétaret t'urte dhé te matur, shpetokerkan dhè disa véta mè qellimè te mfshéhta dhé te nenedhéshme.

Ne numurin 8 te Gazètes «*Shqiperi' é Ré*», ne nje artikull mé titullen «*Ku te mbeshtétémi*» Zoti M, Kardo gjykon dhé denon V. Dodane per tradhetor. Kète gjykim dhé kete denim Z Kardo è nxjér pas nje lètrè te hapur qe Dodani paska botuar ne Gazêten te Romes «*Kuvendi*» per Zotne Pandéli Evangjèle. Kundreshtari mjaftohét qe te quanje Dodane «tradhetor» dhè te nxjère vrère te tij, pa kuxuar se pari qe te botonje ate «létre te hapur» qe te mos gjykohét nga kendonjesit é gazètes te cilet mund te mos jéne mé idén' è ketij shqipetarit te thjéshte; dhè ketu mfshihèt ligesia.

Zoti Kardo shqiptar i thjéshte?-.. V. Dodani tradhetor!!

Fjala *tradhetor* eshte fjal' é rende shume, dhé kur dél nga goja pa ndo-nje arguméntte vertéte, deftén ja sè kallomniatori, énkas, do qé te rrezonje ndér' é tjatrit per ndo-nje pike te rèe a te vjètre, ja sé nuk ja nxe koka te kupetonje rendesiren é tradhetise, ja sé ka brenda dhèlperi.

V. Dodani eshte nje nga te vjétrit dhè nga te paret luftetare ne perlindjèn é Shqiperise, qe é njohen gjithe shqipetaret kudo qe ndodhèn, dhè nuku munt te jète ay qe dashkerka te kembénje Turqine dhé te sjélle Italine mbi kurris te Shqiperise, apo ndonje tjetre sundim te huai.

Eshte vertèt sé Z. Dodani ka kerkuar miqesin t'Italise pertéj dètit, dhé ndihmen è saj per te dhiorganizuar nje shtèt lurég, si eshte Shqiperia tone, si beri Bullgaria, Gréqia, Romania dhé te tjèra shtètè qe posa ngjizèshin èdhè qe posa ngjizén; po kurre ndojnère roberine, si duan te thone te liqte, te lèhtete apo armiqte,

Gjithe kush esht' i dlire te defténje principèt é tija per te miren è atdhéjes se tij. Zoti Dodani, dhé shume te tjére, mbèsojne sé Shqiperia duhét te kéte nje

mik ê nje krah te forte qe te mundnje te ronje dot dhé te ndritohét. Te tjére, gjithe per te miren è atdhèjes s'duan as nje mik, as nje krah; te tjére duan te kène krah Gréqin' a Sèrbine. Keto jane principét te gjithecilit, ne qofte sè principé munt te quhén; po per principét qe jane per te miren é atdhèjes dhé mè arguménta nuku duhét te zemerohèmi dhé te deftèjme njéri tjatrin mè léhtesire si tradhetor.

Nèvé te Rumanise nuku duam te kendojme ne gazètat tona fjale qe na ndajne midis vellézerise, po fjale qe na pajtojne. Keto jane virtutat qe kane levduar kollonine shqiptaré ne Rumani, ku ka qene furiq' i perlindjès se Shqiperise.

Ne artikullat qe ka botuar Dodani ne Gazèten kombetarè te Romes, «Kuvendi», gjekundi nuku dukèt te thote sè duhèt te hidhémi vèrberisht nene zgjèdhe te Italise, Qe nga pra na kallezon Z. Kardo kete zgjèdhe? Dodani thote te mos shajme Italine. te vètemén miqèshe qe na ngjati doren è miqesise, dhè qe névè duhèshé kete gje t'è kerkojme ne qell, sé jémi te végjel, te varfer, te paditur, mè fare-faresh brènga te féevèt qe kémi mbi koke. Zoti Kardoja thote sè jane tradhetore ata qe mbésojne sé Shqiperia eshte çunè dhè tradhetore ata qe s'kerkojne kondicionè.

Edhé ne çèshtjèn è kondicionevét Z. Kardo harron sè Shqiperia ka sot nje Qévéri ne Durres (te formuar mè ndihmen dhé mé miredashjén t'Italise) dhè nje dergate ne Paris prane Konférènces sé paqes. E cila Qévéri vétem ka pushtét dhé te drèjte te shtjére thémélét è shendosha te miqesise sone mé popullin italian. Dodani pra s'mpronte n'ate léter véç névojen é kesaj miqesié dhé nèvojen è ndihmes sa te nise popullì yne t'écenj vète. Nga ana tjater, édhé Kardoja véte é njéh forra kete névoje kur thote:

«Shqiperia, kombi shqipetar dote kéte nèvoje, doèmos, per miqesi édhè per ndihme, mire po qysh? Zotnia Dodani é numeron Shqiperine si nje çun te cilit i lipsèt nje tutélle, dhé me te miren tutèlle nuk' è

gjén pervèç sé nde Italia. Shume mire. Sdo as thene, sè as njéri s'munt te kontéstonjé, qe Italia, mè forcen é saj, mè qytéterimin è saj, mé kamjèn te saj, posa qe dote kéte miresine t'i ndihnje kombit shqipetar nde nisjè te jétes se rè, mè intèligjéncen édhè mè virtytat q'e ka pejuar natura, do te lulezonje édhè ka per te perparuar nde gjithe dèget é aktivitètit».

Zoti Kardo çudítèt qysh mundi t'é kthènje Dodane klim' é Lozanes qe te hidhèt ne radhe te tradhétorevé? Çpifaraku nde mbéson sé klim' è Lozanes mundeka te benje shqipetaret tradhétore, lè te dije qe Dodani nuku ndènji ne Lozane po ndenji ne Gjénéve, dhè ishtè kundre komitétit te Lozanes. Edhé kundre nuku per klimen veshtirové, po per princípét te pa perbashketa,

Ata te Gjènèves me pare sé hyri Italia ne Vlorè ne Gjinokastre, ne Shkodre dhè gjètke, mbètne mé princípne te urtesise dhé thone: na duhèt mé doèmos miqesia é Italise. Sè kurre nuku duhan te jète nje Shqiperi si ajo é 914-tes; édhè kurren è kurres nje lidhjé mé Grèqine a mé Serbine kundr' Italise.

Ay Shqipetar qe mbèson sè Shqiperia mund te rronje pa miqesin' é nje pushtèté te madhè, qoft'ajo Amèrika, Anglia, Franca, Qina, Zhaponia, névé mbèsojme sé esht' i genjyén. Dhè qe te kémi miqèsin' è pushtétèvèt qe numuruam sipre, te cilat s'kane as nje intèrés, duhét te mbésojme sè rrojme mè endera, apo mé perallat è Abbu-Bèqirit te Halimase.

Pamét, ay qe mbèson sè shpetimi tone eshte lidhja mè Gréqine apo mé Sèrbine, ay dukét sè nuku ka idé kombetarè, po me shume fétaré. Mè t'atijte kombi tone humbèt farè, sikundre shohem qe po humbasin per dita.

*S. D. M.*

*Spiridon Miçiaçio*

*(Kendonjes i «Shqiperise Ré»)*

BKSH

## KAPTINA XV

### LÊTREKEMBIM MÉ Z. DR. ADAMIDI

*Bukurésht 23 Oktober 1920*

*Zotit Doktor G. Adamidit*

*nde Gjénéve*

*Shum i dashur mik é vella Z. Dr. Adamidi*

Zoti Kristaq Terpua me dha lètren te Z tuaj shkruar qe me 20 te Gushtit, létre shume te vonuar, édhé msova te gjitha sa me shkruani. Habitém qysh me shkruan sé s'paskerké mare pergjigjién t'imé ne létren te z satè, kur un é kam zakon te pergjigjèm ne çast kujdo, pa dhè shenonj persipre létravè qe mar, fjalen «ju pergjigja», keshtu si kam shenuar dhé mbi létren te Z-tuaj. Po, ndofta, ka humbur dhé me lè dyshim te mos ngjase gjith' ashtu dhé tani.

Per punerat kombjaré dhé politiké s'kam réshtur dyké shkruar ne per miqte qe njoh ne Shqiperi, dhé mé te cilet jèmi nde nje mendjé. Po, sa per ato çéshtjat

BKSH

te lartra, qe trazohèsha dhé une kur isha ne Gjènève, mè kurajon te z-saté dhè miqvét te medhènj te z-satè, mua ketu me dukét sè rrolli im u mbarua. Atjè sa dinim dhé muntme punuamj dhè ç'punuam dalin sot ne mèjdan é na nxuar faqé bardhe, Une jam i çperblyèr dh'i gezuar gracié z-satè, qe u vinja pas bashke mè shoket te tjère. Sot flèt kombi véhte mé fytyrat q'i zgjodhi t'è perfaqesonje. Si kushdo, si dote shtronje do te flére.

Shikonj dhè une lajthitjè te medha qe po behèn po nuku me habitin faré keto gjerera dh'as me deshperojne, sé jémi ne nisjèt; sé jémi komb i pamesuar; sè jémi kacambitur posi lésh arabi ne simpathite ne féte; sé jémi disa te mesuar ne ryshfèté è disa te kaptisur préj nakari. Duhét pra, te rjédhe ca kohe me shume nga te tjèrat shtètè te réja, qe ngjizèn é te shkojme ne purgatorin pa te pakesohèn te mètat qe kèmi.

E kéqè pune eshte te humbase dhé te fale njèriu plengun è ti, po, eshte m'è kèqè te humbase njèriu jéten gjallimne, shpirtin.

Ne me shtrin doren njéri te me shpetoje jèten si mik èdhé m'a shpetoj mé te vertét, po nuku farè si mik, po per intérés, qe te me mare gjeagje, une gjithe do t'ja di per te mire sè me shpetoj jéten. Sè po qe te ronj kam shprése te forcohém dhè te kerkonj llogarite; po, Zoti na shpetofte, ne humbça jèten ne duart é grèkevèt é te serbevèt mé mèsudhat é sistémat qe kane dale sot. Adio Finiqéne! As nam, as nishan!!

Na gllaberoj Turku, tirani dhé budallaj, po Shqiperia rron. Bobo! ne rençim ne duart te grèkevèt è te serbevèt! Humbme!!

Thoni: «Duhét te hyjme ne Ligjen è Kombévé. Sa fjal' é urte, sa fjale pèrendishté; po, te mos hèqim dore ngaj Italia, qe na shtriu doren te na shpetonje gjallimne si miqéshe é vertète, apo makar (pas te tjère) si miqéshe mè intérésa. Jémi luraçka, foshnja, gollomèsh ne kohe te ciknes; na duhén pélénka, lècka te vjétra

te na mbajne ngrohte, te perkembèmi te rojme, pastaj ka Pérendia. Romenia, Grèqia, ajo Italia sa hoqne, sa vojtne, sa loté, sa pshéretima, sa lufta, sa durimé, po sot? Rumeni é Madhè! Gréqia shendrit è madhohèt, Italia la é me la; nje nga te gjashte fuqit é Medha! .. Sè nenate ronin dhé femia ju mblodhe nenavèt rotull.

Te hyjme ne Ligjen ê Kombévé. Te hyjme, te hyjme. Po, lé te pyésim ditet é sotmè; ç'fare drèjtesi è zéze mbrèteron?!

Te hyjme ne Lidhjé te Kombévè, po miq te lidhur mé Italine (pertèj détit) ne daçim te gjèjme dobi n'ate Ligue des Nations.

Sa per Amériken, èdhè né, èdhè guvèrnantet è sotme gjithemone é kèmi dashur édhé do te mos ja harojme kure miredashjèn, qe ka deftyér me ç'do rast per Shqiperine.

Te rronje Amèrika q'i tha: «kato tas hiras» Dangliut; nuku ja haron, nuku ja mohon miredashjèn è saj kombi shqipetar.

Te ronje Lord Cècili dhè i ndérçmi sèkrétar Z. D. Pavoli! Rofte dhè Italia miqésha ton' é vyére shume!

Te perqafonj vellazerisht

*Vissar A. Dodani*

## NJE LÊTR' Ê HAPUR

*Shum' i dashurî im mik Z. Dr. Adamidi*
*ne Génévе*

Dy létra me kini derguar qe kur jam ketu dhé ne te dya ju jam pergjigjur. Nuku di sé ç'ngjét qe gjér tani s'me kini vertètuar ne i mérni pergjigjét timè. Létrat te Z-tuaj i kam mare nga Kristaqi dhè une ju dergova adrèsen timé è cila eshte strada Brutus No. 2 édhé desheronja qe te me shkruanit dréq per dréq né

mua, po nuk di ç'te mbésonj qe tani s'me shkruani aré. Valle s'kini mare faré létrat timè apo s'na bién pizgat njefaresh ne politike te Shqiperise èdhè t'u merzita, pune qe nuku te ka hié z-saté sikuudre qe do te mos me kish hié as mua ne i shikonj idèat è z sate tjatersoj dhé te largohèm. Nje hére qe te di sè jé ay m'i miri luftetar ushtar per te miren vétem te atdhèut tone s'kam te dréjte te ju merzit dashurine sè z-tuaj kini tjatre mésudhe, po kur é di mire qe névè qe te dy kémi nje dh'ate udhe è cila duhèt mare?...

Une jam ne idéjen qe Shqiperise i duhèt krah, z-tuaj gjithe n'ate idéje jini, pra qè se thémélia eshte nje dh'ètilla.

Une dua krah Italine pa fjale, z-tuaj nuku doni as Gréqi as Shqéte, po nonje tjatre sé kini frike nga Italia per te miren tone, pra pamèt nje jèmi.

Une si dhé z-rotè do te ishim farè te paqtuar, po kur s'kémi tjatre fuqi prane krah persè te humbasim kote kohen? persè te pikasèmi sé jèmi te ftohte né Italia kur s'kémi tjatre-ku?. Do te kèmi disa demé dhé brènga, vertét po kur jémi èndé minore, foshnja luraçka, èvidént qe mé brènga shume perkembèt foshnja.

Sa popuj si névé me te medhènj kane vojtur è duruar gjér u ardhi dita te hyjne ne te drèjtat è tyré? Ç'ishtè Gréqia, Bulgaria, Jugosllavia, Polonia, Rumania dh'ajo Italia? Sa uj' u dèrth sa te vojtura hoqne ?!

Po névè mè aqe zgjèdhe te rende é cila na ndau é na hutoj ne mést sa s'njohim vellaj vellane dasheké, o zoti mjék, o vellaçko i dashurè qe te shpetojme pa u cémbisur faré nga tjatri, kur s'jémi te zote te qèvérisèmi vète vétiu mé ç'bréngа kèmi ne shtepi brenda dhé mè ç'kuçèdra jémi réthuar?

Kur puna qéndron keshtu, nuku eshte mire te thomi si gruaja shqipetarè qe thote per djalen te saj : «or i mbare, or nene dhé». Sè ne hyfte nene dhè djal' i saj, Shqiperise i mbétén djém te tjére; po ne thençim édhè nèvé. «Qr Shqiperi te madhé pa te mèta, or hiç fàré». Atehèré?... Ç'mbétémi... Bobo! Zoti mos è dhente.

Andaj thom, mos mè zemerim, mos mé nxitim. Duhét te méndohemi, te kupetojme ç'jèmi, ç'luqi kèmi, te masim pa te łlasim; te mos shajme lèhte as njeri. Mjaft jémi denuar nga shorta, mjaft jèmi armiq njèri mé jatrin ne shtepi brenda. Armiqte duan te na shikojne me kèq pa bashkim pa krah pa miqesi.

Pra nje udhe kémi te shpetimit: miqesin è Italise pertéj détit.

*V. Dodani*

*Bukurésht 1 Dhjétor 1920*

BKSH

## KAPTINA XVI

### NJE LÉTRE KRYÉMINISTRIT FAN NOLI

*Karlsbad 27 Gusht 1924*

*Zoti Pareministre, At Fan-Noli*
*nde Tirane*

Jam nje nga te tri vètat qe ngjize Shoqerine per létraturen shqipè nde Bukurésht per te paren hére me 1881.

Ne me lente Zoti te shkruanj mèmoriat é mia sé qysh u fillua çéshtja è perlindjès se Shqiperise do te kupetoni qe jam nje bésnik, sherbetor i çéshtjès kombetarê, fatmirosh dh'i çperblyèr édhè si i tille ushtar desheronj t'è mbyll jèten.

Shtèti jyne, si Shtèt i ri, qe dél ne drite pas aqè qindra vjètèsh roberié, nuku me trémb, as me deshperon qe do te mos vèje perpara mé gjithe te métat qe çfaqén dore per dore. Te ardhurit Tuaj ne kryè te punevét midis çakanjvét, qe mbanin pushtétat é te ngratit tone atdhéth, me jèp shprèsa te gjalla, sé Shqiperia do te benje perparimé xhigandiké. Pakeze durim gjér sa te hynje dituria, dhé gjer sa te shuhèn disa krère te hélmosur nga farmaq i tyrqvét tiranvèt; kombi tone do

te ndrèqét me shpét sé sa pandéhim nè. Po duhét perdorur urtesi dhé dipllomati.

Ronj ne Bukurésht pé 40 vjèt, édhè kam ndjékur politiken è ati vendi, qe me pare qendronté ne duart è bojarevèt po si nje hère Shqiperia prè féudalet. Po, vjèn pastaj nje Brătianu (plaku) ngaj dor' é popullit dhè ja u théu turinjte dh'èshtrat é çokonjvèt mé vullnese, kurajo, urtesi dhè dipllomati. Shpirt ndrituri i dha Qèsarit ç'ish é tija, pa fjale; zgjodhi gruren nga genkoli èdhé beri me vétè trimat po dhé te drèjtit. Nuku mbajti melle, sé kush ishtè me pare kundrèshtar i 'ti. «Trimn' è mire è vraj è mos é saj». Me kete menyre Brătianu pareministr' i Romanise é fitoj Romanine, é cila sot shendrit ne Ballkan.

Ndjéme tani te ju thom sè ku è kam fjalen.

Une, mè aqè sa ma prèt mendja, kam patur nje méndim te mire per Zotne Ahmèd Zogun, èdhè kéq me vjén sé ishté dhè ndofta eshte i rréthuar mé shokè te liq. A do te muntni valle mé nje fare diplomati t'è hiqni me vèhtè? Une, pas punet qe ka punuar é mbèsonj atdhétar te vertète, trim, kuximtar èdhè mé ment.

Barra esht' è rende, po kur esht' i atilli si kam degjuar dhé kam vene bése ne fjalet é ati qe ka rendesire, véri nje gur zèmres (beju diplomat) édhé thiré ne vathe tuaj Mèndoju mé Z. L. Gurakuqin dhè beni nje thèroresi per te miren è atdhèut. Po è hoqte ate me vèhté ja u thyét kockat fandasismes te bèlèrevè, bagetivét te kombit dhé Shqiperia do hynje ne dashuri é do te forcohét ne démokrati.

Une Ahmèd Zogun nuk é njoh as é kam pare, vètem faktét qe kam degjuar qe ka bere gjèr tani, édhè kesish si mua jane shume vèta q'é duan é qe gjykojne si mua.

Rasti, a fati, é solli te harini ne shkalle te larter te ju çperbléhèt mundim' i djalerise suaj vellaçko, »Elinikotaté Gjimnasiarqé» i gazétes «Drita» i Sofjés. Beni kete gjést te dobishme dhé te bukur.

Kallezohé, ku duhèt, qe kini kete deshire, qe te

zbutét dhé te vinje ne vathe. Te mos isha plak èdhè mullavèc (semundemath) do te vinja véṭe per kete pune, sé me vjén shume kèq t'é humbasim kete djale.

Pèrendia ju pajosi mè ment, mè fjale, mè vullnèse; esht' é téper t'u levdonj é t'u thom sa jam gezuar te degjonj sé harivè atjé ku jè. Nuku kam nèvoje nga Z-tuaj qe t'u levdonj kote, po desheronj te degjonj é te mbyll syte mè shprésa é mè mbèsim sè mundimi u çperblyéka.

Ju puth dor' è kembe dhé mbètèm sherbetor i kombit.

*Naiddo*

P, Sh.—Ne paça ndère te kém pergjigjié ketu, jam ne «Insél Malta» édhè nje muaj, ne mos, do te kthéhèm ne Bukurésht, strada Isvor No. 6 bis M-dam Şika per Naiddo.

Mbi lètren é gjate q'i dergova Zotit Kryéminister At Fan-Nolit, si dukét, me 27 Gusht 1924 qe nga Karlrbad, pata ndére te mar pergjigjièn ne Bukurésht lètren qe pason:

ZYRA E KRYEMINISTRIT

*Tirane 22 Nentor 1924*

*I ndéruar Zot,*

Kryèministri me porositi t'ju dergoj falendèrjat è tij te perzémerta per lètren qe i derguat dhé t'ju bej te njohur qe do t'i kéte nderment keshillat tuaja miqesoré.

Mé ndèrimè

*Anton Frasheri*

Sèkr. i Kryéministrit

Nuku dinja sé n'ate kohe Fanoli é kish njètash denuar ne vdékjé ate qe ja truanja une mé aqè zèll; sè ate hèré pergjigja è ti shqip do te thote: *ç'na çan koken.*

BKSH

## NJE LÉTRE NGA Z. JORGO MÉKSI

*Gjinokastre 29 Maj 1929*

*I dashur V. Dodani*

Ju kam derguar dy lètra mé disa dokuménta qe mundin t'i sherbèjne historise se rilindjés kombetaré shqipetaré. Vèpra se ciles po i pervishi, eshte nje vépre é madhè, é shenuar dh'é vlèfshmé, dhé per rèalizimin é saj, vètem Z-juaj jini i denje, sèpsé Z-juaj perndorni penden, Z-juaj kini luftuar, Z-juaj kini vojtur, Z juaj jini ne pozite t'i dini gjithe hollesirat è èvollucionit. Mèritoni ç'do levdate. Duké é njohur karaktérin é Z suaj fisnik dhè te xhvéshur prèj pasionésh, jam i bindur sè do te thoni te vertéten *Sine ira et Studio*. Jini pra i kalifikuar te jini historigrafi i Shqiperise kontimporané, trèguesi i nje levizjèjè mi te cilen dihèn pak gjera dh'è cila eshte po thua é panjohur. Z juaj do t'i sherbéni édhé Atdhéut èdhè se vertètes. Kisha disa lètra te Mavrokordatos, te Picciotí Garibaldi-t dhè te anturazhit te Sarafof-it; por i pata humbur. Pat shpetuar vétem nje, é flétorarit te math ingliz Bourchier, koréspondènt i flétorès «Timès» ne Ballkan. Do te desheronja qe kete lêtre t'a dépozonja ne Muzèn' é Shqiperise, por mé qene sé atjé askush s'intérésohèt per séndé te tilla, dua te ja u dergonj juvé é pastaj i-a çoni Bibliotèkés se Korçes.

Ju dergova nje lètre te z. Pandéli Evangjèli, ne te cilen i çquari yne mik njéh te dréjten é te krishtérevè per te patur disa garancira dhé nje fare auto-qévérimi. Por bashkepunetori yne i vlèfshem dhé miku yne i perbashket humbi ne èvolluten è kohes kujtimin è kesilloji prémtimésh.

Vépra é jone zhurnalistiké édhè patriotikè ne Rumani, ka qene lidhur ngushtazi mé shqipetaret è Italise, per te formuar nje kundershtim kundra politikes se Austrise atehérè nerhyresé èdhé shume é perhapur.

Ajo ka patur gjithashtu qellim te grupoje' te gjithe shqipetaret kudo qe ndodhèshin, per nje lufte te perbashket èdhé te organizuar. Mundimét tona deri me nje pike u kurorezuan prèj sukçèsi édhé méndimét tona réllativisht ne èstimacionin é politikes italiané dhé austriakè ne punet shqipetarè, ndonsé Italia me von shviŀloj nje aktivitét te papéshuar.

Me pelqén te bésonj sè keto konsidèracionè nuk ndryshojne nga gjykimèt t'uaja dhé dukè ju uruar sukçès te méritueshem ne studimét t'uaja.

Mbètém juaji bèsnik dhé i vjèter bashkepunetor.

*Jorgji Méksi*

BKSH

NJE LAJMÉ

Monsieur V. Dodani, annonce dans le dernier numéro de la «Shqiperia» que, faute de ressources, il cesse de faire paraître son journal. Tous les Albanais regretteront vivement cette disparition. La «Shqiperia» était un journal fort bien rédigé, et les albanologues, notamment M. le Dr. Holger Pedersen, le tenaient en estime.

Monsieur Dodani avait été violemment attaqué en ces derniers temps par un éspion grec de Bucarest, qui, scrofuleux et rachitique, publie une feuille dont les articles se ressentent de ces deux maladies.

Sans admirer outre mesure le caractère de M. Dodani, nous lui avons toujours conservé une vive estime pour la part qu'il a prise à notre propagande nationale; nous le croyons audessus de telles attaques, venant d'une telle feuille; nous déplorons si, outre le défaut de ressources, c'est aussi un peu le découragement qui a déterminé sa décision; et nous faisons des voeux ardents pour qu'il reprenne au plus tôt la publication de son journal.

«ALBANIA»
*Trank Spiro-bég*

* * *

Keto jane gjithe sa permenda t'i shkruanj ne «Mèmorjat é mija», nga shvillimèt é para te rilindjès se kombit shqipetar nde Bukurèsht, bashke mé létrekembimét qe pata mé fare-faresh vellézer atdhètare kombetare dhé miq te vyèr dashamires te kombit tone, mé sa munda qe t'i ruanj origjinalè dhè qe t'i lè ne arqive te Shtétit shqipetar per te kujtuar mè lavdi dhè békim mundimèt dhé deshirat qe yshqènin per shpetimin é Atdhéjes se dashur.

Mé kete ngaje do te defténj sè dhé kronikari qe shkruan kete istori ketéj dykè perkedhèlur dhè gjétke dykè shperkedhélur ka folur te dréjten mè deshmimé.

Kerkonj ndjése nga shume atdhétare qè me kane shkruar dhé ju jam pergjigjur, po mè qe nuk i mbajta dot origjinalèt é atyré létravé s'benj dot fjale nde libre.

Jam i kenaqur qe arriva te 73 vjètét dhè munda te kallezonj si dhè qysh u nis ketu nde Bukurésht shvillimi shpetimtar i Kombit tone, qe renjet é burbuqèt i kishin nde Stamboll dhè u mbajtne ketu nde dhéth te Rumanise, qe ku muar jète dhè tê tjèra kombé.

Jam i kenaqur plotesisht sé ketu nde Rumani gjithe atdhétaret shqipetare Musulman' è Kristiane, qe te gjithe u deftyén kombétare mè zèmer. Te gjitha shoqerite: «Dég' è Stambollit», «Drita», «Diturìa», «Shprésa», «Bashkimi», as ndonje nga keto nde statutét è tyré nuku kerkonin haroma per ndihma pérsonalè, per semundja, vobéke a ndihma te tjéra çperblimè, po vètem épnin, èpnin per driten è kombit dhé lirine é ti! Sé si thame nde nisjè te biblles: *Dés h Zoti* dhè qèllimèt è shènteta u permbushne pas deshirat è patriotevèt.

Sot kémi Shqiperi te dlire, litérature kombjarè, ligjè èuropjanè, Ushteri kombetaré, Mbréteri!

Rofte Shqiperia, Rofte Romania. Rofte miqésha Italia.

*TASHI LÊ TE VDÉS*

**VISKE DODANI**

Z. NIKOLLAQ ZOI

Zoti Nikollaq Zoi Korçar, qe me te rite è ti, qe kur punohéshé nde Bukurèsht çvillimi kombjar per rilindjén é Shpiperise ka qene nje nasionalist i flakt.

Ndonese studimèt è tij i bentè grèqisht ish i persyshur nga partija grékomanè si kombetar shqipetar i veshtire. Edhé ne kohen kur donté te martontè motren é tij mé te bire é te ndyérit Jovan Kosturit, nacionalist mé fame, Dhèspoti i Korçes grék, Foti, s'u tunt te benje paranomine kishtaré. nuk désh t'u vinté kurore, dhé u shtrenguan te vinin ketu nde Bukurésht te vijét kurora. Nikollaq Zoi qendroj bèsnik atdhétar mè gjithe shtergicat dhè demet q'i suall shtepise se tij révollucionaret grèker nde rrudhjat kur hyne nde Korçe. Ishtè shok i pa ndare mé Pandéli Calèn dhé Thémistokli Germenjin deshmoret,

Nikollaq Zoi ka qene dirèktor i financavè te Korçes ne tere kohen é vétqévèrimit te Korçes (okupasion frenk) d.m.th. qe ne Dhjétor 1916 gjér ne Maj 1920, si dhé shume muaj pas bashkimit te Korçes mè qèvérin' è Tîranes, gjèr sa u émerua prèfékt i Korçes.

BKSH

GJORGAQ A. RACI (Korça)

Nje ngaj atdhétaret te flakte per rilindjén te kombit shqiptar nde Korçe eshte dhé z. Gjorgaq Raci. Propagandist i urte dhé i duruar, mundi te fitonje dashurine dhé bésimin é luftetarevét korçare per fatmiresin é kombit. Gj. Raci ishtè Président i Keshilles Administrativé kur N. Zoi ishtè Dréjtor i Financavét ne kohen kur Korça véteqèvèriséshè. Me 1921 ishté Préfékt ne Korçe, se bashku mé Aqif Permétin.

Z. Raci i urte dhé mé taktike te ralle qendron dhé sot atdhétar bésnik i se dréjtese.

I ļevduar qofte émeri i 'ti.

BKSH

*Radhua i bashkatdhétarevét mé te cilet kam punuar ne çvillimin é çéshtjés kombjaré mé létrekembimé*

| | | |
|---|---|---|
| Sami Halit Frashëri | 1881 | Konstantinopoje |
| Naim Halit Frasheri | 1881 | » |
| Girolamo de Rada | 1887 | Demetrio Coroni, 1888 Machio 1898 |
| Giuseppe Schiro | 1887 | Piana de Greci, 1898 Piana |
| Anselmo Lorechio | 1889 | Kantanzaro |
| Prof. Girardo Conforti | 1898 | Neapole |
| Antoni Krispi | 1898 | Roma |
| Gabriel Dara Krispi | | Italia |
| Gennario Lusi | | « |
| Ahile Feriolo | 1897-1898 | Montevidio |
| Kristo Floqi | | Amerika |
| Sotir Peci & Leonida Naçi | | Athena |
| Kristo Luarasi | 1889 | Sofia |
| Dhîmitri Prifti | 1888 | » |
| Faik Konitza | 1898 | Bruxelles |
| Murat Toptani | 1888 | Italia, Anvers |
| Viska Babalasi | 1897 | Bruxelles |
| Emil Legrand | 1898 | Paris |
| Aladro Kastrioti | 1901 | « |
| Dhimitri Traian | | Monastir |
| Sotir Gjika Kolonja | 1918 | Roma |
| Lef Nosi | 1910 | Elbasan |
| Knoz & Gaspar Benusi | | Shkodra |
| Grigor A. Millona | 1897 | Podunavea |
| Dimitri Koli Molea | | Filipupoli |
| Nushet Vrioni | | Konstantinopoje |
| Mid'hat Frasheri | | |
| Louis Benloev | | Paris |
| I. Bagjeru | | Reka |
| Eftimie Cakos | | Tripolis |
| Eftim Mitko Korça | | Egjypt |
| Antonio Çakos | | » |
| Spiro Dine | | » |
| Ilie Avramusi | | » |
| Dr. M. Turtulis | | » |
| Themistokli I. Mano | | » |
| Dr. Gjergj Avramidhi | | » |
| Nikoll Bythkuqari | | » |

SKSH

*Radhua i bashkatdhétarevé qe kémi punuar ne çvillimn' é çéshtjés kombjaré nde Rumani per te pare réalizuar idéall' é shéntete qe me 1881 dhé pas.*

Visar Dodani
Anastas Lakçéa
Vangjo Gjéçua
Vasil Terpua
Thanas Haritua
Nikollaq Evangjéli
Sotir Terpua
Spiro V. Markua
Gjorgji Lazari Fuga
Gabril Pémma
Spiro Gorguzi
Llaska Kerpaçi
Gligoré Paliu
Vellazeria Koléci
Vangjélé Ançè
Périka Vellko
Vellazeria Çapari
Gligor Dodani
Naum Kaménica
Dhimitri Dada
Jorgji Tasi Jorgaqi
Hristo Gaja Dardha
Hristo Karagéa
Mihallaq Qirica
Stavré Karoli
Hristaq Naum
Jorgji Doka Théodoru
André Ion Mborja
Viska Emanoil
Avram Emanoil
Diamandi Terpo
Ziso Vasiliu
Eftimié Marinka
Vellazeria Çévia
Jorgji Ciko
Konstantin Eftimiu
Spiraq Jor. Eftimiu
Kostaq Guguci
Kostaq Duro
Théméli Duro
Spiro Vellko
Téodor Duro
Erakli Duro
Théohari Hristo
Vasil Kosma
Vellazeria Daja
Naum Tasi Maria
Dhjonis Mihail
Pandéli Evangjéli
Thoma Abrami
Ilié Vaske Hosturi
Sotir Nuçi Pllati
Aléksi Çikozi
Vellazeria Zografi
Diamandi Kardo
Ioan Kunesku
Eftim Emanoil
Pandél Durmishi
Aléksi Péléshi
Thanas Kantili
Thanas Vato
Leonidha Gunéska
Pandéli Guneska
Mihail Juro
Thémistokli Gjéçua
Sotir Mano
Anastas Raci
Gjéorgjè Lazar
Ioan Nija
Mihallaq Graméno

# NDRÊQJÉ GABIMÉSH

Nga shkaku sé botimi i kèsaj bibllé u be ne Konstance d. m. th. 230 qillomètra lark banimit te autorit (Bukurèshtit) mé gjithe mundimèt te derdhura prèj zoterise tij si dhè prèj drèjtorit te shtypeshkronjes zotit M. S Xoxé, ka qene è pa mundur qe kurékturat te behèn ne menyre normalè, keshtu qe shpetuan nje shumice gabimésh shtypi per te cilat u kerkojme ndjése kendonjesvé.

Ketu me poshte po shenojme lajthitjèt me mé rendesi te cilat jane te lutur t'i ndréqin vète kendonjesit.

| Faqé | Sere | Ne uend | Ndréqé |
|---|---|---|---|
| 12 | 19 | *«Ligea* | *«Lig' é* |
| 13 | 6 | *bijť é tij* | *béjet é tij* |
| 14 | 14 | *qendruar* | *te kenduar* |
| 16 | 1 | *ndron* | *nxori* |
| 32 | 25 | *lajmót* | *lajmét* |
| 36 | 10 | *shtéiit* | *shtétit* |
| 36 | 19 | *lartes* | *larter* |
| 37 | 14 | *Nuqes* | *Nukos* |
| 37 | 14 | *vdip* | *vdiq* |
| 37 | 24 | *kop* | *hop* |
| 38 | 14 | *bemje* | *bejme* |
| 40 | 26 | *kinini* | *kini* |
| 42 | 8 | *né* | *vé* |
| 43 | 11 | *1881* | *1887* |
| 43 | 28 | *1881* | *1887* |
| 45 | 5 | *1881* | *1887* |
| 48 | 30 | *mesuarit* | *menuarit* |
| 54 | 32 | *dieléktin* | *dialéktin* |
| 56 | 6 | *Manços* | *Manos* |
| 60 | 20 | *Frank Spiro Béy* | *Trank Spiro Bég* |
| 64 | 3 | *vejme* | *bejme* |
| 81 | 12 | *é ben* | *é ben gjithenje* |
| 82 | 8 | *nji hér* | *njehér* |
| 84 | 11 | *kupetové* | *kupetova* |
| 84 | 30 | *zdurnallé* | *xhurnalé* |
| 92 | 28 | *zena* | *réna* |
| 92 | 31 | *Lion* | *Léon* |
| 98 | 12 | *Frak* | *Trank* |
| 107 | 19 | *Çajupi* | *A. C. Zako* |
| 135 | 14 | *Tografos* | *Zografos* |
| 135 | 15 | *Tatru* | *Jatru* |
| 179 | 2 | *periasé* | *perfaré* |
| 181 | 6 | *keja* | *kejo* |
| 18[illegible] | 22 | *nke* | *nxé* |

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

3 FRANGA ARI (100 LEK)

BKSH